

HEJZA

Ridvan Dibra

***NJË VEPËR E DENJË LETRARE KA PËRHERË
PËRSIPËR NJË VELLO TË LEHTË MISTERI***

Nën thjerrë

KUR MADHËSHTIA LIND NË PËRJASHTIM



FERID MURATI

Jeta në Shqipëri dhe në trojet shqiptare nuk ka qenë asnjëherë e lehtë. Historia ka qenë e ashpër, e ngarkuar me luftë, varfëri, mbyllje, emigracion, përjashtim. Dhe pikërisht kjo i ka dhënë individit shqiptar një vetëdije të thellë për dhimbjen, për padrejtësinë, për pamundësinë, për absurditetin e ekzistencës. Nga kjo përvojë e thellë lind nevoja për të folur, për të krijuar, për të shpërthyer

Nga Avni HALIMI

Në kulturën shqiptare, shpesh kemi gjetur arsye për të kritikuar, me të drejtë, mbylljen estetike, mungesën e institucioneve përkrahëse, shpërfilljen e talentit në favor të klaneve, mungesën e kritikës së pavarur dhe atë prirje gati reflektive për të mos njohur kurrë vlerën për sa kohë është ende e jona. Dhe megjithatë, një paradoks i madh e i pamohueshëm qëndron përpara nesh: nga ky gjak (shqiptar), nga ky realitet shpesh shterpë për vlerën, kanë dalë figura që kanë mahnitur kulturën botërore. Gjeni që kanë çarë mes të pamundurës dhe janë bërë pjesë e pashmangshme e historisë së artit, muzikës, letërsisë, dijes. Si shpjegohet kjo?

Ndoshta përgjigjja nuk gjendet në sistemin që i rrethon këta njerëz, por pikërisht në mungesën e tij. Ndoshta mungesa e rrugës së shtruar, mungesa e shesheve të garantuara, mungesa e përkrahjes së thjeshtë ka krijuar një nevojë të thellë ekzistenciale për të shpërthyer përtej. Gjenitë shqiptarë nuk kanë ardhur si pasojë e një kulture të shëndetshme institucionale; ata janë lindur kundër rrymës, në kundërshtim me atë që ofronte ambienti përreth tyre. E kanë pasur gati të pamundur, dhe pikërisht aty ku është e pamundura, fillon rruga e një mendje të jashtëzakonshme. Le të marrim shembuj të gjallë! Në muzikë, Inva Mula dhe Ermonela Jaho janë bërë zëra të papërshkrueshëm në skenat më të mëdha të operës botërore. Nuk është vetëm zëri që i ka çuar atje, por një ndjeshmëri e tejskajshme, një kapërcim i shpirtit nga rrënjët e tyre shqiptare në universin e muzikës klasike. Ermonela Jaho, në veçanti, është përshkruar si një ndër soprano më dramatike të shekullit XXI, jo për teknikën, por për shpërthimin emocional që vetëm një shpirt i përplasur mes dhimbjes dhe dashurisë mund ta sjellë. Po aq monumental është edhe rasti i Tedi Papavramit, violinistit virtuoz që nga një Shqipëri e izoluar u katapultua drejt skenave më të mëdha të Evropës. Ai është dëshmi e një përkushtimi që lind jo në favor, por në sfidë. Mësimet e para në errësirën e diktaturës, përkushtimi obsesiv ndaj teknikës, ikja për të studiuar në Perëndim, dhe më në fund, suksesi i

tij në Francë, tregojnë një tjetër kapitull të gjenisë shqiptare që formësohet në kundërshtim me rrethanat. Papavrami është një ndër të paktët që bashkon perfeksionin teknik me një ndjeshmëri të thellë filozofike përmes tingullit. Ai nuk është vetëm interpretues, është dëshmitar i një shpirti të thellë ballkanik që kërkon dritë, i një identiteti që nuk mund të heshtë në heshtjen e vet.

Në artin figurativ, Ibrahim Kodra, nxënës i pasionuar i artit që u vendos në Milano dhe u bë mik me piktorët më të mëdhenj të kohës, solli një gjuhë që ndërthurte mitin, simbolin dhe gjeometrinë, një vizion nga periferia që u bë pjesë e qendrës. Ai nuk u përkrah nga vendi i vet, madje për dekada u mbajt jashtë kujtesës kolektive shqiptare, dhe vetëm në vitet e fundit po restaurohet kujtesa e tij në mënyrë më të denjë. Në kinematografi, ndriçon një emër që shënon jo vetëm një kulm artistik, por edhe një akt identitar të guximshëm: Bekim Fehmiu. I pari aktor shqiptar që arriti të depërtojë në kinematografinë ndërkombëtare, ai u bë simbol i artit që kapërcen kufijtë politikë dhe kulturorë. Në një epokë ku shqiptarët ishin të padukshëm në hartën e artit botëror, Fehmiu jo vetëm që u bë figurë ikonike në Jugosllavi, por u ftua të luajë në Hollywood, krah aktorëve të mëdhenj si Ava Gardner e John Huston. Ai solli me vete një intensitet të rrallë emocional dhe një krenari të heshtur etnike, duke treguar se një shqiptar mund të luajë me të njëjtin nivel ndjeshmërie si çdo aktor i madh botëror. Zgjedhja e tij për të braktisur skenën si protestë ndaj diskriminimit ndaj shqiptarëve ishte një akt tjetër madhështor, më shumë se artist, ai mbeti njeri me qëndrim, me një peshë që e tejkalonte rolin. Në letërsi, Ismail Kadare është shembulli më i plotë i këtij paradoksi. Ai nuk u shfaq thjesht si shkrimtar i talentuar; ai ndërtoi një mitologji moderne të një populli të vogël, një ndërgjegje kulturore përmes metaforeve, absurditetit dhe alegorisë. I lindur në një vend që censuronte fjalën dhe kontrollonte mendimin, Kadare arriti të krijojë një letërsi që bashkëjeton me veprat më të mëdha të shekullit XX. Ai nuk e arriti këtë sepse Shqipëria e krijo, ai e arriti pavarësisht Shqipërisë së vetërobëruar. Po ashtu, në fushën e letrave dhe mendimit kritik, kemi figura si

Arshi Pipa, Martin Camaj e Ernest Koliqi, që me veprën dhe jetën e tyre mishërojnë ndjeshmërinë e mërgimtarit, njeriun që e ndërtoi kulturën shqiptare larg atdheut, por pa e braktisur kurrë gjuhën, kujtesën dhe misionin shpirtëror. Arshi Pipa, i burgosur dhe i internuar nga regjimi komunist, u bë një nga intelektualët më të thellë shqiptarë në mërgim. Ai krijoi ese, studime, poezi e përkthime, duke mbetur një zë kritik ndaj totalitarizmit dhe një mbrojtës i denjë i lirisë së mendimit. Ndërkohë, Ernest Koliqi, përveçse krijues i prozës moderne shqipe, ka qenë arkitekt i një politike kulturore për afirmimin e identitetit shqiptar në shkollat e Kosovës gjatë Luftës II Botërore. Veprat e tyre, të shkruara jashtë kufijve, flasin për një shqiptarizëm që nuk kërkonte lavdi politike, por dinjitet kulturor. Në fushën e humanizmit dhe shkencës, dy emra janë universale: Nënë Tereza dhe Ferid Murati. Nënë Tereza, e lindur nga një familje shqiptare në Shkup, u bë simboli i dhembshurisë njerëzore, e pranishme në zemrën e të gjithë atyre që vuajnë, kudo në botë. Ajo nuk ndërtoi as teori, as sisteme, por i dha botës një etikë konkrete të dashurisë, një përlujë të rrallë që rrënjët i kishte te besimi, por degët i kishte në çdo cep të planetit. Nobeliste, e shenjtëruar, ajo mbetet dëshmia që shpirti shqiptar, në thelbin e tij, di edhe të japë pa kërkuar.

Ndërsa Ferid Murati, fitues i Çmimit Nobel për Mjekësi, bir emigrantësh shqiptarë, u bë një nga figurat më të nderuara të shkencës moderne, duke kontribuar në zbulimet që shpëtuan miliona jetë. Si simbol i dijes, ai tregoi se edhe kombet e vegjël mund të prodhojnë gjigantë të mendimit shkencor kur individi i tyre i jepet kërkimit dhe vlerës së jetës.

Këta njerëz, (dhe shumë të tjerë si ata), janë dëshmi e asaj që ndodh kur zjarri i brendshëm është më i fuqishëm se rrethanat. Ata nuk janë prodhime të një shoqërie që e nderon vlerën; përkundrazi, janë krijesa të një nevoje të brendshme për të shpëtuar përmes artit, për të kapërcyer kufijtë që jeta ua kishte imponuar me një padrejtësi të pamëshirshme.

Çfarë është ajo që bën që nga ky popull, shpesh i ndarë, i përçarë, i paorganizuar, të dalin individë që kapërcejnë kufijtë e zakonshëm të talentit?

Së pari, është një ndjeshmëri e thellë ndaj ekzistencës. Jeta në Shqipëri dhe në

trojet shqiptare nuk ka qenë asnjëherë e lehtë. Historia ka qenë e ashpër, e ngarkuar me luftë, varfëri, mbyllje, emigracion, përjashtim. Dhe pikërisht kjo i ka dhënë individit shqiptar një vetëdije të thellë për dhimbjen, për padrejtësinë, për pamundësinë, për absurditetin e ekzistencës. Nga kjo përvojë e thellë lind nevoja për të folur, për të krijuar, për të shpërthyer. Arti nuk është zbukurim; është mjet shpëtimi. Së dyti, është një trashëgimi kulturore intuitive. Edhe kur nuk përmendet, edhe kur nuk shkruhet, ekziston një kujtesë e thellë kulturore e cila bartet në mënyrë të heshtur. Në këngët e vjetra, në legjendat, në mënyrën si flasim, si shikojmë, si heshtim, ka një dimension poetik që shpesh nuk kuptohet, por ndjehet. Gjenialiteti shqiptare nuk lind në boshllëk; ajo lind mbi një tokë arketipore që rri pezull në ndërdijen kolektive. Dhe së fundmi, është forca e atij që nuk ka tjetër rrugë veçse të kapërcejë vetveten. Kur nuk ke përkrahje, kur nuk ke skenë, kur je përjashtuar ose injoruar, ose i heshtur, atëherë ose shuhet zëri yt, ose bëhet i patrembur. Gjenitë shqiptarë kanë zgjedhur këtë të dytën. Nuk duhet të harrojmë se shumë prej tyre janë njohur jashtë kufijve para se të njiheshin brenda tyre. Ne kemi pasur nevojë të na e vlerësojnë të huajt, që ta pranojmë të vërtetën tonë. Njësoj si ai fshatari që s’e vlerëson asgjë nga kopshti i vet derisa i huaji e quan të bukur. Por kjo nuk është veçse një fazë e mungesës sonë të vetëbesimit kulturor. Për sa kohë nuk do të mësojmë të njohim vlerën që lind ndër ne, do të vazhdojmë të çuditemi kur dikush nga ne arrin të ngjitet në majat e botës. Por ndoshta pikërisht këtu qëndron një përgjigje e fshehur: në përjashtimin tonë sistematik të vlerës, ne kemi krijuar pa dashur terrenin për ndriçime të rralla. Sepse aty ku nuk ka rrugë, gjenialiteti ndërton vetë udhën e tij. Dhe ajo rrugë është aq personale, aq e dhimbshme dhe aq e sinqertë, sa kthehet në një dëshmi që bota nuk mund ta injorojë. Për këtë arsye, çdo gjenialitet shqiptar që shfaqet në arenën botërore është jo vetëm një triumf i individit, por edhe një akt akuze ndaj nesh, sepse nuk ishte bota ajo që e pengoi atë të shkëlqejë, por ne. Dhe megjithatë, ai shkëlqeu.

Midis nesh

SHQIPËRIA, E GJITHA ART

Përse filmografia ka ngecur keq, me tema koti si: besa, burrneshat, gjakmarrja, komunizmi... asnjë film me temë sociale e probleme, me hallet e Shqipërisë së sotme dhe shqiptarëve...

Andi MEÇAJ

Artisti i vërtetë duhet të pasqyrojë kohën e tij, problemet, hallet, jetën e njerëzve të përditshmërisë sonë, atë që kërkon në kazanë plehrash, atë që lyp, atë që dehet, atë të papunin, atë që mëndja e ka lënë, atë që e rreh burri, atë që nuk ka çtu jap fëmijëve për të ngrënë... etj.

Ka aq shumë tema sot... Nuk kuptoj përse filmografia ka ngecur keq, me tema koti si: besa, burrneshat, gjakmarrja, komunizmi... asnjë film me temë sociale e probleme, me hallet e Shqipërisë së sotme dhe shqiptarëve... Shqipëria ku jetojmë është e gjitha art dhe dhimbje po ta shtrydhësh... nuk ka pse të livadhisësh në tema romantiko-ekzotike... këto janë për regjisorët e huaj që aq dinë për Shqipërinë e shqiptarët, kurse këtyre regjisorëve vendas nuk u falet... shkelin mbi tragjedi çdo ditë dhe merren me të shkuarën. E ardhmja është ai çasti nga

sekonda apo minuta ku frymëmarrim në atë grimcë kohe dhe kur ajo kalon bëhet e shkuar, grimca tjetër që frymëmarrim quhet përsëri e tashme, e ardhmja është e pasigurt, nuk dimë çfarë do të na sjellë e kështu që nuk mund të krijojmë për të, e shkuara është ajo që kaloi, që dimë, që mbajmë mend, por nëse kalon shumë kohë edhe harrohet e interpretohet sipas interesave tona, kjo quhet histori, ndërsa vetëm ajo grimca që frymëmarrim quhet e tashme, ajo është e sigurt që po e jetojmë, nuk e ndjejmë si e ardhme, as si të shkuar, por e jetojmë me gëzim ose dhimbje, me emocion ose me mërztitje, me ngjyra ose bardhë e zi...

Kjo është jeta jonë, ky është arti që duhet pasqyruar, qyteti me njerëzit e tij të mbathur, të zbatshur, të qeshur, të vrenjtur, të ngrënë, e barkthatë, me halle e pa to, me shëndet, e pa shëndet, të droguar, pijanecë, hajdutë, kriminelë, zotërinj, njerëz të punës, kollarexhinj, etj...



Letër nga diaspora

TA LARGOJMË PLUHURIN E HARRESËS...

Diaspora jonë në çdo shtet ku vepron, punon e jeton, ka edhe komunitetin e artistëve, të cilët jo vetëm që janë produktiv, por njëkohësisht po lënë gjurmë evidente në kulturën shqiptarë, përkatësisht në letërsi, pikturë, muzikë, film, teatër e kështu me radhë...

Neviana SHEHI

A i kemi harruar korifenjtë e kulturës, artit dhe letërsisë shqiptare? Është kjo një pyetje që ka një përgjigje, fatkeqësisht, të turpshëm. Ata janë pothuaj të harruar. Për shkak të rrethanave të njohura historike e politike, këta korifenj u detyruan të veprojnë, punojnë e jetojnë larg atdheut të tyre: në Itali, Francë, Gjermani, Amerikë e në shumë vende tjera të botës. Kishin një ideal të shenjtë: gjuhën dhe atdheun. Ernest Koliqi, Martin Camaj, Krist Maloku, Faik Konica, Fan Noli, Branko Merxhani, Aleksandër Mosiu, Ibrahim Kodra e shumë e shumë të tjerë ishin personalitete me kulturë evropiane, të cilët (kush më shumë e kush më pak) nuk kursyen asgjë për t’i realizuar aspiratat shekullore të shqiptarëve, sidomos në planin e rilindjes kulturore të shoqërisë shqiptare.

FAIK KONICA është një nga figurat më të shquara të Rilindjes Kombëtare shqiptare. Ai u arsimua në Francë dhe në SHBA, ku themeloi revistën “Albania”, që u bë një tribunë e rëndësishme për shpalljen e identitetit kulturor e kombëtar shqiptar. Përmes shkrimeve të tij, Konica promovoi gjuhën shqipe dhe kulturën kombëtare, duke e përfaqësuar Shqipërinë në qarqet intelektuale perëndimore. Veprimtaria e tij në emigracion u bë një nga shtyllat e formësimit të mendimit kombëtar modern. Një tjetër figurë madhore, FAN NOLI ishte shkrimtar, përkthyes, politikan, diplomat dhe themelues i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare në Amerikë. Përmes përkthimeve të autorëve klasikë si Shekspiri, Servantesi apo Ibseni, ai ngriti nivelin e letërsisë shqipe. Noli ishte gjithashtu një orator i madh dhe mbrojti çështjen shqiptare në forumet ndërkombëtare. Edhe pse për një periudhë të shkurtër shërbeu si kryeministër i Shqipërisë, pjesa më e madhe e jetës së tij kaloi në mërgim, ku



vazhdoi të kontribuonte për kulturën dhe identitetin kombëtar. ALEKSANDËR MOISIU ishte një nga aktorët më të mëdhenj të teatrit evropian në fillim të shekullit XX dhe figura shqiptare me famën më të madhe ndërkombëtare në artin skenik të asaj kohe. Ai mbetet një simbol i kulturës shqiptare në botë dhe një nga aktorët tragjikë më të vlerësuar të skenës gjermane dhe austriake. ERNEST KOLIQI është një ndër figurat më të rëndësishme të kulturës shqiptare në shekullin XX – shkrimtar, përkthyes, profesor, publicist dhe ministër arsimit – i cili la gjurmë të thella në letërsinë shqipe dhe në jetën kulturore të shqiptarëve, veçanërisht në diasporë. Koliqi studioi në Itali, në Universitetin e Padovës, ku u diplomua në letërsi. Kjo përvojë ndikoi shumë në formimin e tij kulturor, duke e lidhur ngushtë me letërsinë dhe kulturën italiane. Ai do të bëhet pjesë aktive e jetës letrare, duke përkthyer vepra të mëdha të letërsisë botërore në shqip. Koliqi është cilësuar si themeltari i tregimit modern shqiptar. MARTIN CAMAJ është një nga figurat më të rëndësishme të letërsisë dhe mendimit shqiptar të shekullit XX, shpesh i quajtur poeti më i madh modern i letërsisë shqiptare. Ai ishte poet, prozator, gjuhëtar dhe studiues i albanologjisë, dhe veprimtaria e tij u zhvillua kryesisht

jashtë Shqipërisë, në Itali dhe Gjermani. KRIST MALOKU është një personalitet i rëndësishëm i kulturës dhe mendimit shqiptar të gjysmës së parë të shekullit XX. Ai ishte filozof, sociolog, publicist dhe mendimtar politik, që jetoi dhe veproi kryesisht në diasporë. Studimet i ndoqi në Austri, ku u formua në filozofi, sociologji dhe shkencë shoqërore. Jetoi dhe veproi kryesisht në Austri dhe Gjermani, ku u njoh me mendimin e kohës dhe me filozofët e mëdhenj evropianë. IBRAHIM KODRA, një ndër piktorët më të mëdhenj shqiptarë të shekullit XX, i cili jetoi dhe krijoi kryesisht në Itali. I konsideruar si “piktori shqiptar i ngjyrave të Mesdheut”, Kodra zhvilloi një stil modernist ku ndërthurte elemente të traditës shqiptare me artin bashkëkohor evropian. Ekspozitat e tij u hapën në shumë vende të botës, duke i dhënë Shqipërisë një emër të nderuar në artet pamore. BRANKO MERXHANI ishte një nga intelektualët dhe publicistët më me ndikim të Shqipërisë së viteve ’30, i njohur si ideologu i “Neoshqiptarizmit”, një rrymë kulturore, politike e shoqërore që synonte modernizimin e kombit shqiptar dhe integrimin e tij në qytetërimin evropian. U arsimua në Gjermani, ku u njoh me filozofinë, sociologjinë dhe mendimin modern evropian. Në vitet ’20–

’30 u përfshi në jetën kulturore si publicist, kritik dhe ideolog, duke drejtuar revistën “Përpjekja shqiptare”, një organ ky shumë i rëndësishëm i atyre viteve. Diaspora shqiptare sot është e shtrirë pothuaj në të gjitha anët e botës, në veçanti në Evropë e në SHBA. Sot, fatmirësisht, kjo diasporë, në çdo shtet ku vepron, punon e jeton, ka edhe komunitetin e artistëve, të cilët jo vetëm që janë produktiv, por njëkohësisht po lënë gjurmë evidente në kulturën shqiptarë, përkatësisht në letërsi, pikturë, muzikë, film, teatër e kështu me radhë. Pikërisht këto komunitete duhet të bëhen veriga kryesore e aktiviteteve për t’i përkujtuar korifenjtë e kulturës, artit dhe letërsisë shqiptare. Komuniteti artistik shqiptar në Itali do të duhet të jetë i organizuar dhe mbi të gjitha i bashkuar për t’i përkujtuar një herë në vit Ernest Koliqin e Ibrahim Kodrën, sepse bëhet fjalë për dy figura që i dhanë shumë artit shqiptar. Pastaj komuniteti artistik shqiptar në Gjermani kurrësi nuk duhet të lejojë që ta harrohet Martin Camaj, një figura e shquar e letërsisë shqiptare, i cili, për shkak të rrethanave politike, për shumë dekada mbeti i përjashtuar nga arena e letërsisë shqiptare. Po kështu, mbetet në përgjegjësinë e komunitetit artistik shqiptar të SHBA që ta mbajnë gjallë veprën e dy figurave të shquar jo vetëm të historisë, por edhe të letërsisë shqiptare, Faik Konica e Fan Noli. Përkujtimi i këtyre figurave jashtë atdheut ka rëndësi të veçantë, sidomos për gjeneratat e reja, të lindura dhe të integruar në shtetet ku jetojnë. Aktivitetet e tilla kontribuojnë në përf forcimin e ndjenjave kombëtare dhe, sidomos, në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit. Duhet të tregojmë se kur bëhet fjalë për çështje të rëndësishme, jemi të gatshëm të bëhemi bashkë për ta larguar pluhurin e harresës...

Gusht, 2025, Itali

Në shiritin e kohës

FATOS BAXHAKU DHE FOTOJA “DORËZIMI I ARMËVE”

Vështirë se do kisha vazhduar më tej në këtë fushë, pas artikullit “Çarmatimi në një fotografi të Marubit”, nëse nuk do shikoja entuziazmin dhe nxitjen dashamirëse të Fatos Baxhakut

Qerim VRIONI

Kohë më parë (16 gusht) u mbushën gjashtë vjet prej ndarjes së parakohshme nga jeta e gazetarit dhe publicistit të njohur Fatos Baxhaku. Ai ishte i pranishëm në shtypin e shkruar dhe në kanale televizive si një kryeredaktor plot kulturë, vërtetësi dhe kandje. Ai do të botojë disa libra të veçantë dhe mjaft tërheqës për publikun shqiptar. Fatos Baxhaku kishte studiuar për histori në universitetin e Tiranës dhe pas përfundimit më 1986, ai u aktivizua si punonjës shkencor pranë Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave deri në vitin 1992. Gjatë viteve 1993-1998 ai kreu detyrën e kryeredaktorit tek “Gazeta Shqiptare”, mandej si kryeredaktor i televizionit “Klan”, më pas edhe i “Vizion Plus”. Në kohështirirjen 2006-2015, ai drejtoi me mjaft zotësi gazetën e njohur “Shqip”. Në të gjitha këto detyra, ai u shqua për aftësi e kulturë, por edhe për korrektesë me bashkëpunëtorët dhe lexuesit e këtyre organeve. Përgjatë këtyre viteve Baxhaku u dallua edhe për trajtimin me frymë origjinale dhe kulturë të reportazheve e serialeve televizive me tema mbresëlënëse. Veçojmë ndër to: serialin “Tunel” (të cilin e kam ndjekur me shumë kërshe dhe vëmendje) tek “Vizion Plus”, atë “Rrugëtim” tek “Top Chanel” dhe “Shtëpia e vjetër” në platformën “Digitallb”. Në këto emisione televizive shpërfaqej vëmendja e tij për probleme të natyrave të ndryshme, historike, shoqërore, kulturore dhe politike. Po ashtu, duhet shënuar se Baxhaku është autor edhe i disa skenarëve të filmave kinematografikë si: “Atentatet e mëdha”, “Sytë e Lumit”, “Shenjat” dhe “Vetmia”, çka flet për horizontin e gjerë kulturor të tij. Ndër botimet e Fatos Baxhakut shënojmë përmbledhjen me reportazhe “Gur” (2008), “Në Mirditë&rreth e rrotull” (2009), “Roje” (2010), “Çadra e kuqe: histori fatesh austro-shqiptare në shekujt XIX-XXI” (2013), në të cilat gëlon një publicistikë elegante. Tepër i veçantë mbetet botimi i tij (me bashkë-autore) socio-psikologjik me titull “Gra të përgjithshme” (2014) me vlera të shumta për jetën shoqërore në vend në disa kohështirirje. Për disa kohë Baxhaku falë personalitetit të tij, ishte zgjedhur edhe anëtar i “Komitetit Shqiptar të Helsinkit”, ku u dallua për qëndrime të guximshme dhe parimore. Pas vitit 2015, ai doli në profesion të lirë, por natyrisht pa u shkëputur nga krijimtaria letrare-artistike. Fatos Baxhaku u nda

nga jeta më 16 gusht 2019, duke pikëlluar thellësisht familjarët, por edhe miqtë e tij të shumtë. Shuarja e tij e parakohshme u pasqyrua gjerësisht nga të gjitha mediat në gjuhën shqipe, print apo elektronike, në Shqipëri, Republikën e Kosovës, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Një vit më vonë, në “Panairin e librit 2020” në Tiranë, Baxhaku u vlerësua si “Autori më i mirë” për librin e tij “Në emër të Nojes”. Pak më vonë, për të nderuar veprimtarinë e tij u emetua konkursi vjetor kombëtar për mediat “Çmimi Fatos Baxhaku”. Po ashtu, me një vendim të posaçëm të Këshillit bashkiak të Tiranës, një rrugë e kryeqytetit për kujtim të tij u emërtua “Rruga Fatos Baxhaku”. Duhet shtuar se të gjitha këto nuk mund të lejnë në hije natyrën dashamirëse dhe tërheqëse të Fatos Baxhakut, çka shpërfaqej edhe nga shoqëria e madhe dhe e zgjedhur e tij, madje jo vetëm në Tiranë. Veprat e botuara dhe emisionet televizive, i kanë siguruar Fatos Baxhakut kujtesë dhe përmendje të përhershme, jo vetëm nga miqtë e të afërm, por edhe nga të tjerë që e njohin dhe do ta njohin vetëm duke lexuar botimet dhe shikuar serialet e tij tërheqëse. Gjatë viteve kisha pirë disa herë kafe me Baxhakun, bisedat me të cilin ishin përherë mbresëlënëse dhe rridhnin këndshëm. Temat e trajtuara brenda tyre ishin shumë të larmishme; flisnim për letërsi, gazetari, fotografi, muzikë, madje edhe për politikë dhe çështje shoqërore. Ai shquhej gjatë bashkëbisedimeve për origjinalitet dhe largpamësi në debat. Kthehemi tek titulli i shkrimit dhe lidhja e Fatos Baxhakut me foton e njohur të Kel Marubit “Dorëzimi i armëve”. Në shkurt të vitit 2001, botova shkrimin tim të parë për fotografinë. Aso kohe bëheshin rreth dhjetë vjet që merresha me fotografi, kryesisht duke realizuar peizazhe, por edhe me “leximin” e fotove të vjetra. Në vitin 2000, shoku im i vjetër, Qemal Agaj, më kishte dërguar nga ShBA albumin fotografik “The Photo Book” (2000), të Shtëpisë botuese angleze “Phaidon”, me 500 foto të zgjedhura nga e gjithë bota dhe kohët. Aty përfshiheshin edhe dy foto të lidhura me Shqipërinë. E para ishte fotoja e njohur e Gjon Milit, “Picasso duke vizatuar me dritë” (1949), në album me titullin “Picasso”, tjetra shkrepja e Kel Marubit “Kapiteni Mark Raka dhe Bajraktari i Shalës” (1922). U përqendrova tek kjo e dyta. Teksti shoqërues i fotos nuk kthjellonte se çfarë po ndodhte me ata 11 burra përreth një pushke mbrapsht.



Aty, ndër të tjera, shkruhej se: “Sot është vështirë të përcaktohet natyra e ngjarjes të përjetësuar në këtë foto të Kel Marubit” (“Il Mondo della Foto”-Phaidon, London, 2003, f. 302, botimi italisht). Duke hulumtuar për subjektin, gjeta në Historinë e Shqipërisë se në vitin e fotos, 1922, në vend ishte zhvilluar nga shteti një fushatë e gjerë me bazë ligjore për çarmatimin e popullsisë civile. Krijova shpejt bindjen se fotoja pasqyronte pikërisht një skenë nga ky aksion i madh politik dhe shoqëror. Shkrova digja, rreth një faqe A4 dhe me ndihmën e shokut tim, Pandeli Koçi, u lidha me publicistin Fatos Baxhaku, i panjohur prej meje, atëherë kryeredaktor i revistës së përjavshme kulturore-shoqërore “XXL”, të cilit i dhashë shkrimin. Ai, pasi e lexoi, më telefonoi në shtëpi e më kërkoi që sa më shpejt t’i jepja edhe foton. Pas pak ditësh, ai e botoi artikullin me titullin tim “Çarmatimi në një fotografi të Kel Marubit”, dhe pas një jave më kërkoi të shkoja të bisedonim dhe të tërhiqja në zyrat e redaksisë (te Piramida) edhe një kopje të revistës. Në takimin e dytë Fatosi, me të folurën e tij të ngadalshme dhe të ngrohtë, më përgëzoi shumë për shkrimin, dhe më nxititi të hulumtoj më tej, jo vetëm për dy figurat historike të fotos, Kapitenin Mark Raka dhe Bajraktarin e Shalës, por edhe të personave të tjerë. Fjalët e tij kurajuese më shtytën që të vazhdojmë tej kërkimet

për foton. Ashtu veprova, dhe pas një viti e gjysmë e plotësova shkrimin me emrat e thuajse të gjithë personazheve dhe të dhëna të tjera historike për kohën dhe njerëzit, shumica figura të njohura të asaj periudhe. Mandej e botova tek dy faqoshi i brendshëm i “Gazeta Shqiptare” më 2 maj 2002. Titullin e ndryshova duke menduar se nuk po çarmatoseshin me forcë civilët (të paktën në foto), por po i dorëzonin vetë shtetit armët, të cilat ligjërisht nuk ju takonin. Pra, fotos i vendosa emërtimin e ri “Dorëzimi i armëve në një foto të Kel Marubit”. Tani më nga ky titull ka mbetur vetëm “Dorëzimi i armëve”, i cili e shoqëron rëndomë këtë foto në shtyp dhe në botime të ndryshme dhe jo emërtimi zanafillor “Kapiteni Mark Raka dhe Bajraktari i Shalës”, si ndodhet edhe në regjistrin e Fototekës “Marubi”. Prej atëherë nuk jam shkëputur nga studimi i fotografisë. Vështirë se do kisha vazhduar më tej në këtë fushë, pas artikullit “Çarmatimi në një fotografi të Marubit”, nëse nuk do shikoja entuziazmin dhe nxitjen dashamirëse të Fatos Baxhakut. Takimi im i fundit me të ishte në vjeshtën e vitit 2018 gjatë një ekspozite të fotografit dhe piktorit të njohur, Leon Çika. Aty folëm edhe për takimin e ardhshëm, që fatkeqësisht nuk u realizua. Gjithsesi, Fatos Baxhakut do t’i jem përgjithmonë mirënjohës. I pastë dritë shpirti...



Në shiritin e kohës

PSE BOTA NA QUAN ALBANIA?

Sikundër dihet, astronomi e gjeografi Klaud Ptolemeu i Aleksandrisë së Egjiptit, në shekullin e dytë të erës së re, në hartën e tij botërore shënon emrin e një fisi Albanói dhe qytetin Albanópolis në një trevë të Shqipërisë të mesme

Eqrem ÇABEJ

Shqiptari i thotë vetes shqiptar, vendit të vet Shqipëri, Shqipni, po populli njihet në botë, sikundër dihet, lashtërisht si Albanais, Albanese etj., dhe vendi i tij si Albanie, Albania. Ky emërtim i dyfishtë ka arsytet e veta. Ai ka lidhje me disa rrethana të karakterit etnografik, të cilat janë specifike për Shqipërinë e për të kaluarën historike të saj. Duke u nisur nga faktet, vihet re pikësëpari që vërtet në Shqipëri vetë si emër nacional i popullit zotëron sot gjithkund shqiptar, e si emër i vendit Shqipëri, Shqipni, po që m’anë tjetër në kolonitë shqiptare që gjinden n’Itali e në Greqi ky emër nuk njihet. Shqiptarët e Italisë jugore e të Siqelisë, pasardhës të shpërngulurish prej Shqipërie kryesisht gjatë luftërave të para me turqit nën flamurin e Gjergj Kastriotit (Skënderbeut) në shekullin e XV e të XVI, e quajnë veten e vet dhe përgjithësisht popullin e atdheut të tyre të vjetër arbëresh, dhe këtë atdhe Arbër, Arbëri. Këto emra përdorin gjer më sot dhe pasardhësit e atyre shqiptarëve që u shpërngulën pak më parë, në shekullin e XIV e të XV, prej Shqipërie për në Greqi, të cilët edhe ata nuk e kanë në përdorim emrin që zotëron sot në Shqipëri; edhe ata përdorin rregullisht arbëresh për “shqiptar”, arbërishte për “gjuhë shqipe”, arbërisht për “shqip, në gjuhën shqipe”. Këto të dhëna tregojnë qartë që emri i sotëm shqiptar, Shqipëri, Shqipni, në kohë të Skënderbeut ende nuk kishte dalë, ose të pakën nuk ish përgjithësuar, e që ky gjithsesi është më i ri se emri i parë. Kjo do të thotë që emri i vjetër nacional i vendit e i popullit ka qenë arbën, arbër, arbëresh, arbëresh. E meqë ky emër, sikundër shihet me vështrimin e parë, është identik me Albania, Albanese etj. që u përmendën më sipër, nga gjithë këto rezulton që shqiptarët në mesjetë e kanë quajtur veten e tyre ashtu si quhen edhe sot te popujt e tjerë. Kjo pamje etnografike gjen vërtetimin e plotësimin e saj më një anë me disa të dhëna – të vjetra e më të reja – prej Shqipërie, më anë tjetër me dëshminë e gjuhëve të popujve fqinj me shqiptarët, e m’anë tjetër me emrat e Shqipërisë e të shqiptarëve në burimet e ndryshme europiane të mesjetës. Sikundër është vënë re që nga gjysma e shekullit të kaluar, emri i vjetër i vendit, përveç se në kolonitë shqiptare, që sapo u zunë ngoje, është ruajtur edhe vetë në Shqipëri. Një trevë fushore e pjesës perëndimore të Shqipërisë së mesme ç’merr prej Kurbini e gjer poshtë në pllajat e Durrësit e të Tiranës, pra fusha midis lummenjve Mat dhe Erzen, quhet edhe sot Arbën, dhe mal e arbën përdoret atje për “male e fusha”. Një katund në perëndim të Liqenit të Shkodrës mban emrin Arbnesh, dhe Arbënesh quhet edhe ishulli gjuhësor shqiptar që gjindet afër qytetit të Zarës në Dalmaci, themeluar në gjysmën e parë të shekullit të XVIII, prej të shpërngulurish nga anët e katundit në fjalë. Arbanë është një katund afër Tiranës. Më anë tjetër, në pjesën jugore të vendit, Arbër e Arbëri quhen krahina të ndryshme të trevës malore të Labërisë midis qyteteve të Vlorës dhe të Gjirokastrës e të Delvinës dhe arbëreshë e arbërorë banorët e tyre. Në vise të tjera të Shqipërisë, po ky emër, me trajta të ndryshme (arbën arbër, arbënesh arbëresh, arbnuer arbëror), përdoret në popull me një kuptim etnik, për të shënuar shqiptarin në dallim nga aromuni ose nga anëtari i ndonjë tjetre popullsi ballkanike. Sikundër shihet, emri i lashtë, në rrjedhë të kohës erdhi e u mbulua nga emri i ri shqiptar, Shqipëri, po ka mbijetuar gjer sot nëpër krahina të ndryshme të vendit. Që ai ka qenë në përdorim me përmasa nacionale, në mbarë territorin gjuhësor të shqipes, këtë e vër-



tetojnë ndër të tjera edhe vargje popullore si Dalin zogat arbëneshe të anëve të Kosovës. M’anë tjetër burimet historike të vendit e plotësojnë këtë pamje edhe për të kaluarën. Në monumentet letrare të shqipes së vjetër, të cilat rrjedhin nga shekulli i XVI e i XVII, vendi del rregullisht me emrin Arbënë , populli me arbënesh, arbëruer, dhe gjuha e tij me arbënisht. Me këto të dhëna të brendshme në lidhje me emrin nacional të Shqipërisë e të popullit të saj, pajtojnë burimet e jashtme, dëshmia e gjuhëve të popujve të tjerë të Gadishullit Ballkanik. Edhe atje vrehet prania e këtij emri, i cili në rrymë të kohëve rrezatoi prej Shqipërie tek ata popuj. Në serbokroatishten popullore shqiptari quhet arbanas, në dokumentet mesjetare të asaj gjuhe arbanasin. Arbananu quhet ai dhe në bullgarishten popullore, arbanas në rumanishten e vjetër, dhe tek aromunët e Shqipërisë e të Maqedonisë arbines, arbinesi, të gjitha reflekse të shqipes arbënesh e të varianteve të saj. Duke u ngjitur te burimet historike të mesjetës, në dokumentet e shkruara latinisht të vendeve perëndimore të kohës para dinastisë së Anjouve, të cilët patën marrëdhënie politike me disa treva të Shqipërisë, shqiptarët quhen arbanenses, e më vonë albanenses, dhe vendi i tyre Albania, ashtu si edhe sot. Duke i shikuar këto dëshmi, të brendshme edhe të jashtme, me një vështrim përmbledhës, rezulton se emri nacional i hershëm i popullit shqiptar e i vendit të tij është arbën arbër me variacionet e tij, dhe se ky ka mbizotëruar në Shqipëri gjer në shekujt e parë të sundimit osman. Ky emër rrënjët ndërkaq i ka që në kohën antike. Sikundër dihet, astronomi e gjeografi Klaud Ptolemeu i Aleksandrisë së Egjiptit, në shekullin e dytë të erës së re, në hartën e tij botërore shënon emrin e një fisi Albanói dhe qytetin Albanópolis në një trevë të Shqipërisë të mesme, afërsisht midis Durrësit e Dibrës së sotme e në lindje të Leshit. Prej këtij emri rrjedh rregullisht Arbën Arbër i shqipes, një dëshmi, ndër të tjera, që shqiptarët janë anas. autoktonë në vendbanimet e sotme dhe që aty ka një vazhdimësi, një kontinuitet gjuhe të pakën që prej antikitetit. Nga Arbën, si u tha, ka dalë në analizë të fundit emri i Shqipërisë e i shqiptarëve te popujt e Gadishullit Ballkanik e të pjesëve të tjera të Europës. Historikisht ky emër, mbi dëshminë e përbashkët të Ptolemeut,

të burimeve mesjetare të vendeve të ndryshme dhe të përhapjes së sotme popullore në Shqipëri, në krye të herës pas gjithë gjasësh i ka përkitur një treve e një popullsie të Shqipërisë së mesme; ai u përgjithësua pastaj si emër nacional në mbarë vendin që në kohën para Skënderbeut. Përsa i përket emrit shqiptar, Shqipëri, Shqipni, ky si emër populli e vendi, si rezulton nga sa u shtjellua më sipër, zuri vend gjatë kohës së sundimit turk, pas shpërnguljes shqiptare për në Greqi e n’Itali. Përhapja e tij si emër nacional dhe zhdukja e emrit të vjetër si i tillë, ka lidhje pas gjase me lëvizjet etnike e sociale të popullit gjatë mesjetës dhe kohës së parë turke, me shtegtime të brendshme, me formime fisesh të reja në ato perioda historike, veçse shtysat konkrete për një zëvendësim të tillë nuk mund të ndiqen. Vetëm një gjë mund të thuhet me gjasë të madhe, që shqip në krye të herës ka qenë emri i gjuhës. Ky si i tillë ka qenë mbase me përdorim më të mocëm, mbase paralel me emrin arbën arbër si emër etnik, dhe pastaj do të ketë shtrirë fushën e përdorimit, duke përfshirë edhe popullin e vendin. Shihet kështu se më i vjetri shkrimtar shqiptar që njihet, Gjon Buzuku, i vitit 1555, krahas ndë Arbanit “në Shqipëri” ka shqip “në gjuhë shqipe”; ashtu dhe Pjetër Budi (1621) shqip të na e thotë, e Pjetër Bogdani (1683) një gramatikë latin e shqip. Përdorimi etnik i këtij emri rreth vitit 1700 kishte zënë rrënjë, sepse në Vendimet e Koncilit provincial të vitit 1706 krahas Arbëni “Shqipëria” dhe i Arbëneshi “shqiptari” del edhe gjuhë e Shqipëtarëvet. Mendimi që emri shqiptar të ketë ekzistuar në Shqipëri veriore që në shekullin e XIV, e të jetë identik me emrin familjar Schivipudar, Schepuder, Schapudar, Scapuder të një banori të qytetit të Drishtit afër Shkodrës që përmendet rreth vjetëve 1368-1402 në arkivat e Raguzës, mbetet një hipotezë që meriton të gjurmohet më tej. Në lidhje më në fund me burimin e dy emravev arbën edhe shqip, do pasur parasysh se shumë emra të popujve, të vjetra e më të reja, që njihen nga historia, mbeten me domethënie e burim të paditur. Një kusht paraprak i domosdoshëm në këtë fushë kërkimesh është konstatimi i formës së kryehershme të emrit përkatës. Në lidhje me këtë, për emrin e vjetër nacional të shqiptarëve mund të thuhet me siguri që nga dy format e tij, arb- dhe alb-, e para

është forma e mirëfilltë, sikundër del dhe nga dëshmitë vendëse së bashku me dëshmitë popullore ballkanike që u zunë ngoje më sipër. Prandaj kërkimi i një rrënje alb- me kuptimin e pretenduar “mal”, krahasimi me emrat topike Albantë Italisë e të viseve të tjera, me emrin e Alpeve etj., nuk kanë ndonjë bazë solide. Duke u nisur përkundrazi nga forma arb-, e nga kuptimi “fushë, rrafshinë”, i cili ruhet në mal e arbën të përmendur më lart, mund ta afrojmë këtë emër me latinishten arvum “arë, tokë e punuar, fushë”, greqishten e vjetër aroura “arë, tokë buke”, me fjalën kelte të irlandishtes së mesme arbor, shumë arbanna “drithë”. Me emrin e Arbënit mund të ketë një lidhje të mocme edhe emri i ishullit Arbe të Dalmacisë. Përsa i takon emrit shqip, shqiptar, Shqipëri Shqipni, prej nga ka dalë edhe folja shqipëroj, shqipëlloj “spiegoj, sqaroj” e gjuhës popullore, ky emër mbetet me gurrë të dyshimtë. Mendime që të ketë dalë nga emri i shqipes, duke e pasur pra shqiptarët emrin e tyre prej këtij shpendi, qysh në kohën e Skënderbeut, duke e vënë në lidhje m’anë tjetër këtë emërtim me fjalët e Plutarkut, që Pirroja pas fitores që korri mbi madeonët u kremtua me epitetin “shqiponjë”, nuk duket t’i rezistojë kritikës, po të nisemi nga trajtat e këtyre dy emrave. Në të vërtetë, tek autorët e vjetër shqiptarë, shqip, shkruar me këtë trajtë, dallohet dukshëm nga emri i shpendit, që shkruhet tek ata rregullisht shqype, gjë që tregon se kemi të bëjmë me dy fjalë të ndryshme. Jo bindëse paraqitet dhe afrimi me qipi “mullar bari”, me paravendim (presupozim) të një kuptimi të hershëm “grumbull, popull”. Të dyshimta mbeten dhe interpretimet e tjera të këtij emri, ai si “banor shkrepush, malesh” dhe ai si “pushkatar” prej greqishtes së re skippetto(n) “pushkë” (kjo prej italishtes schioppetto), një fjalë që dëshmohet për greqishten sëpari me shekullin e XVI-XVII. I pabesueshëm mbetet mënéfund edhe spiegimi i fjalës shqip nga latinishtja excipio; fjala latine nuk do të thotë: “kuptoj”, si kanë thënë, po “marr; vë më njanë; përjashtoj; pranoj”. Kështu, duke përfunduar, puna e burimit të fjalës shqip mbetet një çështje e hapët.

(Botuar në revistën “Shqipëria e re”, 1972)

Me Ridvan Dibrën, shkrimtar

NJË VEPËR E DENJË LETRARE KA PËRHERË PËRSIPËR NJË VELLO TË LEHTË MISTERI

Ai krijues që pret gjykimet e kritikës apo çmimet e vlerësimet për ta ditur nëse po ecën drejt, nuk besoj se ka për të mbërritur larg. Nëse nuk ka marrë “bukën” me vete – besimin, talentin e lindur, kulturën, guximin, ambicien – dhe e pret atë “bukë” nga të tjerët, më mirë të mos niset për udhë

Avni HALIMI

RIDVAN DIBRA u lind në Shkodër më 9 janar 1959. Është rritur e shkolluar në qytetin e lindjes, ku u diplomua për gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin “Luigj Gurakuqi”. Ka punuar arsimtar në Kukës (’82 - ’87) e gazetar në Shkodër (’88 - ’94). Ka qenë pedagog i Letërsisë Post-moderne në Universitetin e Shkodrës nga viti 1995 deri në vitin 2024, vit kur doli në pension.

Deri më tani ka botuar këto vepra: THJESHT, poezi, 1989. Sh. B. “NaimFrashëri”, Tiranë, PROSTITUTA E VIRGJËR,tregime,1994.Sh.B.“Idromeno”, Shkodër, EKLIPSI I SHPIRTIT, tregime, 1994. Sh. B. “Gjergj Fishta”, Shkodër, NUDO, roman, 1995. Sh. B. “MçM Çabej”, Tiranë, VETMIA E DIELLIT, parabola, 1995. Sh. B. “Rilindja”, Tiranë, MJERIMI I GJYSMËS, novela, 1996. Sh. B. “Fi&Ga”, Maqedoni, KURTHET E DRITËS, roman, 1997. Sh. B. “Onufri”, Tiranë, TRIUMFI I GJERGJ ELEZ ALISË, roman, 1999. Sh. B. “Onufri”, Tiranë, STINA E UJKUT, roman, 2000. Sh. B. “Camaj&Pipa”, Shkodër, TË LIRË DHE TË BURGOSUR, roman, 2000. Sh. B. “Buzuku”, Prishtinë, VËLLA ME CENTAURËT, parabola, 2002. Sh. B. “Buzuku”, Prishtinë, TRIUMFI I DYTË I GJERGJ ELEZ ALISË, roman, 2002. Sh. B. “Buzuku”, Prishtinë, EMAIL, roman, 2003. Sh. B. “Sejko”, Tiranë, KUMTE DASHURIE, roman 2004. Sh. B. “Dudaj”, Tiranë, LETRA NGA PROVINCA, tregime 2004. Sh. B. “Vatra”, Maqedoni,

RREFIM PËR PLAKUN E MIRË DHE VAJZËN E BUKUR (ItaloZvevo), përkthim nga origjinali në italisht 2004. Sh. B. “Buzuku”, Prishtinë, DEKALOGU I TURPIT, esse 2005. Sh. B. “Ombr GVG”, Tirane, SESILJA OSE SEXONIX, roman 2005. Sh. B. “Ombr GVG”, Tirane, STINA E MACEVE, roman 2006. Sh. B. “Buzuku”, Prishtinë, FRANC KAFKA I SHKRUAN TE BIRIT, roman, 2007. Sh. B. “Toena”, Tirane, NJE LOJE ME EMRIN POSTMODERNIZEM, studim, 2007. Sh. B. “Albas”,Tiranë, UNE, FRANC KAFKA DHE KARTA E BOLONJES, tregime, 2009. “Onufri”, Tiranë, NE KERKIM TE FEMIJES SE HUMBUR, prozë, 2010. “Onufri”, Tiranë, PLAGET E MOISIUT, poemë (shqip, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, rumanisht), 2010. “Camaj-Pipa”, Shkodër, KANUNI I LEKES SE VOGEL, roman, 2011. “Buzuku”, Prishtinë, NA, TE BIRTE E SHEKULLIT TE RI, dramë, 2011. (Vënë në skenë në Kosovë, Tiranë, Shkodër), LEGJENDA E VETMISE, roman, 2012. “Onufri”, Tiranë; 2013 “KOHA”, Prishtinë, GJUMI MBI BORE, roman, 2016. “Onufri”,Tiranë, TRENI I MUZGUT, roman, 2017, OM, Prishtinë, DASHURITE E VIRGJERESHES MADALENE, roman, 2018. “Onufri”, Tiranë, GRUAJA QE DESHE, roman, 2021. “Onufri”, Tiranë, PER ROMANIN DHE ROMANET, ese, 2021. “Bard Books”, Prishtinë, HISTORI TE THJESHTA, KREJT TE THJESHTA, prozë, 2022. “Onufri”, Tiranë. Pjesë nga kjo krijimtari janë përkthyer në gjuhët: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, rumanisht, maqedonisht,

serbisht, boshnjake, malaziasë etj. Është fitues i shumë çmimeve kombëtare. Kritiku ynë, Ali Aliu, veç tjerash për veprimtarinë e Dibrës ka thënë se “romanet dhe vëllimet me tregime, novela e parabola i kanë dhënë shkrimtarit Ridvan Dibra një vend të rëndësishëm në këtë zhanër letrar të shqipes... Lexuesi ka kënaqësinë që takon po atë prozator të talentuar, me mundësi të dallueshme epike, por njëherit edhe të ndryshëm, të përtërirë sidomos në rrafsh të idesë dhe teknikës narrative...”.

HEJZA: Nga përvoja e deritanishme krijuese, a mund të konstatojmë se ekziston një vetmi që të tret dhe një vetmi që të ndriçon. Shumë krijues të mëdhenj janë rritur në hijen e izolimit, jo si një burg, por si një laborator i fshehtë i mendimit dhe imagjinatës. Vetmia, atëherë, nuk është mungesë, por, prani! A është vetmia, për ju, një dhimbje që e mësuat të duroni, apo një privilegj që ju zgjodhi për të krijuar?

RIDVAN DIBRA: Ju bëni pyetje të bukura e poetike dhe të gjata. Druaj që edhe përgjigjet fshihen brenda tyre. Qëndron gjithçka që thoni. Por në rastin tim përgjigja do të ishte më e thjeshtë: një shkrimtar që gëzon vëmendjen e lexuesve, të miqve e kolegëve; një individ që rrethohet nga përkujdesja e familjarëve dhe lojnat e dy mbesave e nipit të vogël nuk mund të merret si model vetmie. Por, po: kur filloj e punoj, domethënë kur nis e shkruaj, atëherë

vetminë e kam të shenjtë dhe nuk lejoj askënd të ma cenojë.

HEJZA: Bota harrohet shpejt. Historia fshihet nën ritmin e lajmeve, dashuritë plaken në arkivole kujtese, dhe njeriu vetë rrezikon të bëhet një version i tretshëm i vetes. Vetëm letërsia ngul këmbë të kujtojë atë që duhet. Si e shihni misionin e shkrimtarit sot? A është ai një rojtar i kujtesës së botës, apo një rebel që shpik kujtesën e vet?

RIDVAN DIBRA: Misioni i shkrimtarit? Kaq shumë është folur e debatuar rreth këtij argumenti, që më bezdis paksa. Vetë termi “mision” ka diçka prej detyrimi, imponimi, rregulli... vargonj që një shkrimtar i vërtetë kërkon t’i shkëpusë. Një shkrimtar shkruan sepse i shkruhet; ashtu si një lule çel sepse i çelet. Shkrimtarët “me mision” nuk janë në shijen time. Do më pëlqente që fjalën “mision” ta kishit zëvendësuar me diçka tjetër, “qëllim” për shembull. Apo “detyrë”. Atëherë përgjigja ime mund të kishte kahe tjetër. Dhe detyra e një shkrimtari, sipas meje, është kaq e thjeshtë: të shkruaj mirë dhe bukur. Për plagë që i dhembin atij dhe shoqërisë.

HEJZA: Besoj që pajtoheni se fjala nuk është thjesht një mjet. Është një genie, një trup që merr frymë në mendjen dhe gojën e njeriut. Disa fjalë janë të ngrohta, të tjera therëse. Disa shërojnë. Disa janë thjesht heshtje që nuk gjetën dot zërin. Cilat fjalë janë për ju të shenjta, të



patundshme: ato të përshpirtshmet apo ato që nuk mund t’i përdorni asnjëherë?

RIDVAN DIBRA: Gjithçka e keni thënë kaq bukur në pyetjen tuaj, saqë përgjigja ime, me siguri, do të tingëllojë tepër prozaike. Për mua, si qëmtues i vëmendshëm i fjalëve që përdor në tekst, të gjitha janë të shenjta. Qoftë edhe fjala më e parëndësishme në dukje të parë. Kurse fjalët që s’u përdorën asnjëherë, ndoshta presin kohën e duhur.

HEJZA: Shkrimtari shpesh gënjen për të treguar të vërtetën. Krijon histori që nuk ndodhën, për të zbuluar atë që ndodh përherë. Aty ku hesht realiteti, shpërthen metafora. Kur e ndjeni se një gënjeshtër letrare ka zbuluar një të vërtetë më të thellë se faktet?

RIDVAN DIBRA: Jo shpesh, por gati gjithmonë. Shkrimtar - gënjeshtar mund të ishin edhe sinonime. Shkrimtari gënjen edhe atëherë kur synon të jetë sa më besnik ndaj një realiteti të caktuar. Sepse, mendoj unë, çdo përpjekje për t’i kthyer besnikërisht realitetet (të jashtëm e të brendshëm) në fjalë është një akt pamundësie; domethënë një gënjeshtër e bukur, një gënjeshtër estetike. “Kur e ndjej se një gënjeshtër letrare ka zbuluar një të vërtetë më të thellë se faktet”? Ma thotë Zonja Intuitë.

HEJZA: Koha e brendshme e një shkrimtari nuk është ora e murit. As kalendari. Është një kohë tjetër, shpesh e mbrapshtë, e ngadaltë ose e shpejtë si një rënie. A shkruani për kohën në të cilën jetoni, apo për atë që mungon dhe duhet shpikur?

RIDVAN DIBRA: Për të dyja dhe për asnjërën njëherësh. Shkruaj për “kohën time”, vetjake, dhe që ndodh të përkojë me të ndokujt tjetër, i cili kishte me qenë lexuesi i zemrës për mua.

HEJZA: Ka një vend ku arsyeja nuk guxon të hyjë, por letërsia futet me krahë të dridhshëm. Ëndrrat, ankthi, absurdi, misteri, janë territore ku vetëm shkrimtari është ambasador i besueshëm. Çfarë roli luan e panjohura në universin tuaj krijues? E ndieni si kërcënim apo si frymëzim?

RIDVAN DIBRA: Unë s’di vende ku arsyeja nuk guxon të hyjë... Por ju, ndoshta, e keni fjalën për arsyen e shëndoshë, që i druhet e i ruhet infektimit. Gjithë ato që përmendët ju - ëndrrat, ankthin, absurdin, misterin, të panjohurën - janë brumë special për shkrimtarin. Gjithmonë nëse përdorimi i këtij brumi bëhet në masën e duhur. Vetë misteri është në natyrën e krijimit. Një vepër e denjë letrare ka përherë përsipër një vello të lehtë misteri.


HEJZA: Ka rrëfime që nuk fliten. Ka dhimbje që nuk dalin në lajm. Por shkrimtari, si një sy i tretë i shoqërisë, dëgjon atë që të tjerët nuk e thonë, dhe e shkruan. Cilat janë zërat që keni ndjerë se i përfaqësoni në librat tuaj - ata që nuk kanë folur kurrë?

RIDVAN DIBRA: Së pari, zërat brenda meje. Mandej them për zërat që sot mund të jenë në fazën e heshtjes a të belbëzimit. Por që nesër, besoj, mund të jehojnë bindshëm.

HEJZA: Nganjëherë jeta duket si një roman pa autor, ku ngjarjet ndodhin pa kuptim, pa drejtim. Letërsia përpiqet ta riparojë këtë absurditet duke i dhënë kuptim, qoftë edhe përmes absurdit të vet. A ka letërsia ndonjë fuqi për të shpëtuar njeriun nga absurdi, apo, thjesht, për ta bërë atë më të bukur?

RIDVAN DIBRA: Deri dje kam besuar fort. Sot kam një mal me dyshime mbi zemër. Mjafton të shohim e të ndjejmë sesa pak njeri ka mbetur te njeriu. Dhe për këtë, gjykoj se ka fajet e përgjegjësitë e veta edhe letërsia. Them për letërsinë e cekët, jo humane dhe në shërbim të propagandës.

HEJZA: Popujt nuk janë veç gjeografi apo gjuhë: janë trashëgimi e pashkruar



fryme, memorie kolektive që endet përmes këngëve, legjendave, veprave që kujtohen e që flasin edhe pas shekujsh. Kur nuk kujtojmë dot veten nëpërmjet artit, rrezikojmë të harrohemi përgjithmonë. Në kohën kur globalizimi shpërndan identitetet në grimca të vogla, çfarë mbetet ende shqiptare në letërsinë e sotshme shqiptare?

RIDVAN DIBRA: Kam dëshirë të besoj se globalizmi, domethënë i ashtuquajturi “globalizëm liberal”, ka arritur majën dhe tani është në rënie... Ashtu siç kam dëshirë të besoj se “identitetet e grimcuara”, siç shpreheni ju, ndjejnë nevojën ulëritëse të ribashkohen. Mendoj se pikërisht ajo që i shërben këtij “ribashkimi”, në kushtet dhe kontekstin shqiptar, mund të përbëjë tharmin e letërsisë së sotshme shqiptare. Mos po dukem pak konservator?

HEJZA: Luftërat moderne nuk zhvillohen më vetëm me armë. Shpesh janë luftëra simbolesh, kujtese dhe përkatësie. Në këtë kontekst, krijuesi bëhet një nga mbrojtësit më të heshtur por më të fuqishëm të një kombi. E ndjeni krijimtarinë tuaj si një formë të mbrojtjes së identitetit shqiptar? Apo arti ka misionë më universale, përtej kufijve etnikë?

RIDVAN DIBRA: Po. Asnjëherë nuk e kam vënë në diskutim a dyshim identitetin dhe qenien si shkrimtar shqiptar. Si mund

t’i shërbej me veprën time këtij identiteti? Së pari, përmes vëmendjes e kujdesit deri në mani ndaj gjuhës së bekuar shqipe. Mandej, nëse arti yt ka cilësi dhe identitet, kufijtë etnikë bëhen të kapërcyeshëm.

HEJZA: Ka krijues që e ndjejnë atdheun si barrë, si mallkim, si liri, si detyrim të shenjtë. Të shkruash për një vend që shpesh i ka persekutuar mendimtarët e vet është akt i ndërlikuar dashurie. A ka shkrimtari shqiptar një obligim të pashkruar për ta përforcuar, mbrojtur apo përkufizuar identitetin kombëtar? Apo, në modë është të jeshë “shkrimtar i botës”, pa identitet?

RIDVAN DIBRA: Kjo pyetje duket si vazhdim a plotësim i pyetjes së mësipërme. Kësisoj, edhe përgjigja ime e tillë do të jetë. Në gjykimin tim, gjithmonë shkrimi, flas për shkrimin e vërtetë, është një akt dashurie. Edhe kur mund të nxitet prej ndjesish negative. Mandej, shkrimtari i vërtetë nuk shkruan për një vend, por për një njeri. Ju flisni edhe për modën. Po ç’lidhje ka një shkrimtar me modën, që është aq e përkohshme, kalimtare; teksa letërsia e vërtetë synon t’i bëjë sfidë kohës. Nuk e kuptoj dhe nuk e pranoj shkrimtarin pa identitet. Ti mund të bëhesh “shkrimtar i botës”, duke ruajtur identitetin tënd si shkrimtar shqiptar.

HEJZA: Disa nga veprat më të fuqishme

të shekullit XX kanë lindur nën shtypje, në burgje, në censurë. Regjimet totalitare, për ironi, shpesh nxjerrin në pah mendjet më të thella, pikërisht ngaqë i përndjekin. A mendoni se regjimi i djeshëm ishte një makineri që përkundër dhunës së tij, lindi mendje të mëdha... apo ishte thjesht një aparaturë që përpiqej t’i shfaroste?

RIDVAN DIBRA: Po, e kam trajtuar edhe njëherë tjetër këtë argument, duke arsyetuar se njëlloj dhune e shtypjeje sjell si reagim lindjen e veprave të mëdha; siç ndodh, për shembull, me perlat që lindin thellësive të rënda e të errëta. Por, nuk kam menduar vetëm për diktaturën dhe dhunën klasike të regjimeve totalitare. Më ka pëlqyer t’i shoh si shfaqje diktature edhe ndjesitë njerëzore, kur kalojnë në ekstrem. Një dashuri e madhe, në kufijtë e hyjnores, për shembull. Apo një urrejtje a plagosje e egos. Reagimet ndaj diktaturave të tilla kanë prodhuar jo pak kryevepra në letërsinë botërore. Kurse diktatura e dikurshme tek ne ishte e pashembullt. Të reagoje ndaj saj, do të thoshte të nënshkruaje humbjen, asgjësimin; siç edhe ndodhi në jo pak raste. Kadare, në një rrekje reagimi ndaj saj, shkroi edhe kryeveprën e tij, “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave”.

HEJZA: Pas rënies së diktaturës, liria nuk erdhi menjëherë me dritë të plotë. Në vend të censurës, ndoshta erdhi zbrazëti. Në

vend të kontrollit, tashmë shpërtheu një liri, por që nuk dinte se çfarë të bëjë me vetveten. Cila është drama e shkrimtarit shqiptar pas diktaturës: liria që e huton, apo harresa që e zëvendëson?

RIDVAN DIBRA: Më lejoni të mos jem në një mendje me ju. Qoftë edhe duke u nisur nga përvojat e mia. Pas rënies së diktaturës, kam qenë dëshmitar dhe pjesëmarrës modest i zhvillimeve interesante e të vrullshme në letrat shqipe. Disa emra të rinj u shfaqën bindshëm me veprat e tyre. Unë vetë, librat e parë, të shkruar pas rënies së diktaturës, vazhdoj t’i mbaj ndër veprat e mia më të mira. Mandej ju e dini: krijimi ka si parakusht kaosin. Dhe ja ku dolëm prapë te dhuna e diktatura, për të cilat folëm pak më sipër: edhe liria mund të perceptohet si e tillë; them në këndvështrimin e një shkrimtari. Janë kaq të ndërlikuara raportet e lirisë me krijimin...

HEJZA: Në çdo regjim, edhe në demokracitë e brishta, ekziston një tundim që shkrimtari të bëhet zëdhënës i një ideologjie, një programi, një partie. Por arti që rreshtohet nuk është më art: është propagandë. A mund të jetë një shkrimtar i madh një zë i pushtetit? Apo madhështia vjen vetëm kur qëndron përballë tij?

RIDVAN DIBRA: Po, keni të drejtë: arti që rreshtohet nuk është art. Kurse një shkrimtar i madh, në gjykimin tim, nuk përcaktohet nga raportet që ndërton me pushtetin: në krah, anash, apo përballë tij. Një shkrimtar të vërtetë, gjithnjë sipas gjykimit tim, e përcaktojnë raportet që ai ndërton me humanen, njerëzoren. Duke qenë i tillë, domethënë avokat i dinjitetit njerëzor, ai detyrimisht do t’u kundërvihet pushteteve dhe mekanizmave të tyre shtypës e kontrollues.

HEJZA: Të krijosh është si të hysh në një labirint ku rruga shpesh gjen shkrimtarin, jo anasjelltas. Ka një pjesë të procesit që ndodh pa logjikë, pa plan, si një frymë që i kundërvihet kontrollit. Sa hapësirë i lini rastësisë, nënvetëdijes, absurdit në procesin e të shkruarit?

RIDVAN DIBRA: E thoni kaq bukur “rruga gjen shkrimtarin”. Më ka ndodhur disa herë në veprat e mia një dukuri e tillë, kur frenat e krijimit i ka marrë në dorë nënvetëdija. Teksa unë, në ekstazë dhe i përhumbur, i jam dorëzuar vullnetit të saj. Nuk mund të them se një dukuri e tillë, domethënë nënshtrimi ndaj pavetëdijes, më ka ndodhur në vepra të plota, por në kapituj, paragrafë e situata të veçanta të



cilat, kur i rilexoj sot, më rezultojnë ndër faqet më të bukura e më të vërteta që kam shkruar. Një fenomen të tillë e ndesh, sidomos, në librat e mi të parë. Kujtoj pasazhe nga veprat “Prostituta e virgjër”, “Nudo”, “Mjerimi i gjysmës”, “Kurthet e dritës”, “Stina e ujkut” dhe ndonjë tjetër. Por të mos keqkuptohemi: produktet letrare të nënvetëdijes nuk janë lënë bruto, ato i janë nënshtruar më pas një rishikimi të esëllt e të vetëdijshëm, sidomos në rrafshin gjuhësor.

HEJZA: Fjala “frymëzim” tingëllon poetike, por në të vërtetë është shpesh një përzierje e çuditshme ndërmjet pasigurie, përgjumje shpirtërore dhe një thirrje që nuk mund ta shmangësh. A besoni ende në frymëzim si koncept “magjik”, apo e shihni atë si një disiplinë dhe ritual të përditshëm pune?

RIDVAN DIBRA: Ndër cilësitë që ju vishni fjalës frymëzim, më duket bindëse shprehja “një thirrje që nuk mund ta shmangësh”. Po, pikërisht i tillë kishte me qenë frymëzimi. Një gjendje kur të shkruarit të bëhet detyrim dhe kur gjithçka tjetër të duket bjerrje kohe. Mund t’ju duket çudi, por unë vazhdoj të besoj te frymëzimi dhe vetëm nën urdhrat e tij ia nis një pune të re. Mandej, për ta vazhduar dhe përfunduar një roman, kuptohet që nuk mjafton vetëm frymëzimi. Në lojë hyjnë leximet e studimet, puna e mundimshme me fjalët, vullneti e njëfarë disipline, për të cilën nuk shquhem dhe aq.

HEJZA: Lexuesi i sotëm kërkon shpejtësi, zbulim, tronditje të menjëhershme. Por letërsia e vërtetë kërkon ndalesë, përqendrim, përlulje. Është si një thirrje për meditimi në një botë që vrapon. A e

ndjeni se duhet të negocioni me lexuesin bashkëkohor? Apo vepra duhet të mbetet e papërkulur, e pavarur nga kërkesat e kohës?

RIDVAN DIBRA: Pyetje kaq e bukur e problematike, që e ther në palcë shkrimtarin bashkëkohor dhe që do të kërkonte një trajtim të veçantë, ndoshta eseistik. Por unë tani nuk kam as kohë e as nerva. Ndaj po përgjigjem shkurt. Në fillim, po përsëris të vërtetën e thjeshtë: librat i shkruajmë për t’u lexuar nga lexuesit. Shkrimtarët që mendojnë ndryshe, janë hipokritë e dështakë. Në këtë logjikë, duke ju referuar pyetjes suaj, unë jam për negocim me lexuesin. Shikoni, thashë negocim dhe jo dorëzim përballë shijes e kërkesave të tija. Një shkrimtar sot nuk mund t’i shkruaj e t’i flasë lexuesit nga Maja e Olimpiti dhe t’i thotë: hajde po munde në majë, këtu ku rri unë. Në logjikën time krijuese (zgjidhje post-moderne e quajnë studiuesit) shkrimtari le të zbresë pak poshtë, kurse lexuesi të rreket të ngjitet lart; që kontakti mes tyre, falë këtij kompromisi, të jetë i mundur. Gjithmonë pa cenuar vlerat estetike të veprës. Këtë jam rrekur ta realizoj në librat e mi, sidomos ato të fundit. Dhe them se ia ka vlejtur. Edhe për mua. Edhe për lexuesit.

HEJZA: Ka libra që kur shkruhen, u përkasin autorëve. Por në një pikë të caktuar, ata ikin prej tij, bëhen pjesë e lexuesve, interpretimeve, keqkuptimeve. Dhe autori nuk ka më kontroll mbi fatin e tyre. Cilin nga librat tuaj ndjeni se nuk ju përket më, se ka kaluar në një territor ku ju s’mund ta ndiqni më?

RIDVAN DIBRA: Po, keni të drejtë. Ndodh si me fëmijët. Vjen një moshë dhe ata i ikin kontrollit e autoritetit tuaj në kërkim të fatit dhe ardhmërisë se tyre. Nuk më pëlqejnë ata autorë që, përmes paraqitjesh të pafundme mediatike, kërkojnë t’i kontrollojnë vazhdimisht veprat e tyre, edhe pas vitesh e vitesh botimi. Me të dalë në dritë, me t’u botuar, vepra s’është më e jotja; ajo i përket lexuesit. Qoftë edhe kur keqkuptohet. Apo interpretohet jo drejt. Dikur, një mik-shkrimtar (aq sa mund të jenë miq dy shkrimtarë!) më thoshte pak a shumë se “ti i trajton librat e tu si fëmijë - kopilë: i braktis rrugëve”. Atëherë më bezdiste e më trishtonte batuta e tij. Sot i jap të drejtë. Unë kam tashmë një përvojë prej gati 40 vitesh krijimtari dhe ndjej jo pa krenari se disa prej veprave të mia kanë fituar pavarësi prej meje: janë të lexuesit.



HEJZA

i pakët e i përzgjedhur, që ende vazhdon ta lexojë veten në një vepër të denjë letrare. Le të jemi pak më optimistë. Qoftë dhe me pahiri.

HEJZA: Nga legjendat e Eposit të Kreshnikëve, te misteret e Kanunit, nga mitet e lashta të Ilirisë, te tragjeditë moderne si eksodi, diktatura, korrupsioni, Shqipëria është një oqean i pashembullt temash. E megjithatë, shpesh peshkojmë në lumenj të huaj, të cekët, me mjete të marra hua. Përse mendoni se letërsia shqiptare shpesh shmang thellësitë tematike që ka nën këmbë? A kemi frikë të përballemi me mitin dhe traumën, apo nuk kemi ende gjuhën për t’i rrëfyer?

RIDVAN DIBRA: E saktë ajo që pohoni ju: realiteti shqiptar vërtet është një minierë temash e fabulash për një shkrimtar. Por, unë nuk mendoj që letërsia shqiptare, si dje dhe sot, i shmang thellësitë tematike. Do të numëroja disa vepra letrare e autorë, të cilët u janë qasur e u qasen denjësisht atyre thellësive që përmendni ju. Unë vetë, në një pjesë të krijimtarisë sime, jam marrë me legjendat, Kanunin e mitet shqiptare. A mund të shfrytëzohet më mirë dhe më me dinjitet gjithë kjo pasuri tematike? Padyshim që po. Gjithnjë në optikën e një ndjeshmërie bashkëkohore. Kurse autorët që “peshkojnë në lumenj të huaj, të cekët, me mjete të marra hua”, pak kanë të bëjnë me letërsinë e vërtetë, serioze. Por gjuhën, për gjithë mangësitë e defektet tona si shkrimtarë, mos e fajësoni, ju lutem! Gjuha shqipe i ka të gjitha mjetet e pasuritë për të rrëfyer gjithçka. Si rrallë gjuhë tjetër.

HEJZA: Ekziston një tendencë e çuditshme në krijimtarinë bashkëkohore: të shkruash për çdo gjë, përveç se për atë që ka ndodhur vërtet. Një arratisje nga e vërteta, një estetizim i ikjes, një mohim i traumave tona kolektive. A është shmangia e temave shqiptare një nevojë për të shpëtuar nga realiteti, apo një mungesë e guximit për ta interpretuar atë?

RIDVAN DIBRA: E keni fjalën për mungesën e tendencave realiste në letërsinë shqiptare? Them se deri diku keni të drejtë. Një tendencë e tillë është vënë re edhe në letërsinë evropiane të para dy - tri dekadave. Kurse tash vihet re një lulëzim i një letërsie me kahe realiste, të cilën disa teoricienë e emërtojnë si post-realizëm. Por, mendoj unë, edhe te ne, këto kohët e fundit sidomos, vihet re një qasje realiste te disa vepra dhe autorë. Mandej mos harroni: ti, me veprën tënde letrare, mund të thuash të vërteta të mëdha, kombëtare e kolektive, edhe përmes eksplorimit të unit tënd të vockël.

HEJZA: Ka diçka të paemër në fund të çdo interviste me një shkrimtar! Kaplon një ndjesi se, sado të kemi pyetur, gjithmonë mbetet diçka që nuk thuhet dot, sepse jeton vetëm në vetminë e tij. Pas librave, pas metaforave, pas gjithçkaje që është ndarë me të tjerët, mbetet njeriu që hesht. Ai që nuk ka më nevojë të shkruajë, as të shpjegojë, as të bindë. Ai që sheh botën jo më për ta rrëfyer, por thjesht për ta përjetuar. Kur nuk jeni Ridvan Dibra shkrimtari — kush jeni në vetmi, kur fjala nuk kërkon më të shkruhet?

RIDVAN DIBRA: Po, kështu ka qenë dhe do të jetë përherë: gjithmonë mbetet diçka e pathënë, qoftë edhe në rrëfimin më të singertë; diçka që nuk di, nuk do, apo nuk ke mjetet e duhura për ta thënë. Në fakt, Ridvan Dibra, shkrimtari, nuk ndryshon dhe aq nga Ridvan Dibra në jetën reale. Sepse vepra ime letrare ka qasje autobiografike (jo e tillë plotësisht!), e ngopur me elementë, ngjarje e përjetime biografike. Kësisoj, për mua mund të mësoni thuajse gjithçka përmes leximit të vëmendshëm e të kujdesshëm të veprës sime. Mandej, unë e shoh Shkrimtarin si një mekanizëm “perpetuum mobile”, domethënë të tillë që është vazhdimisht në “gjendje pune”, edhe kur nuk po shkruan. Përndryshe, Ridvan Dibra është një individ i zakonshëm, që bën jetë familjare e sociale.



HEJZA: Për një shkrimtar të vërtetë, fjalia është si notë muzike. Ka ritëm, harmoni, peshë. Disa fjali nuk janë shkruar për të thënë, por për t’u dëgjuar. Si e përjetoni ju estetikën e të shkruarit? Ka momente ku nuk shkruani për të treguar, por për të “krijuar bukuri”?

RIDVAN DIBRA: E prisja me dëshirë këtë pyetje. Sepse po flisni për disa elementë formalë, të cilët i vlerësoj shumë dhe u jap rëndësi gjatë aktit të krijimit. Kritikët, disa herë, e kanë ngjasuar prozën time me poezinë, duke spikatur në të jo pak elementë poetikë: ritëm të brendshëm, pasuri figurash, përzgjedhje e kujdesshme e fjalëve, prani e shpeshtë e nëntekstit dhe të tjera. Në përgjigje të pyetjes suaj, do të thosha se jo në momente të caktuara por përherë shkruaj edhe për të treguar, edhe për të “krijuar bukuri”. Diçka e rrëfyer bukur josh e tërheq dhe, besoj unë, ka jetëgjatësi.

HEJZA: Çdo libër është një mënyrë për të mos vdekur menjëherë. Për të qëndruar në kujtesën e dikujt, për të jetuar në një faqe që dikush e lexon vite më vonë. A keni menduar ndonjëherë se përse shkruani? A është letërsia për ju një sfidë kundër harresës?

RIDVAN DIBRA: Edhe kjo pyetje e tundon dhe e mundon jo pak një shkrimtar. Tani po më bien ndër mend me dhjetëra përgjigje, që shkrimtarë të njohur i kanë dhënë pyetjes torturuese “përse shkruani?” Secili në rrekje për t’u dukur sa më i veçantë, origjinal. Kurse unë kam përgjigjen time. Të singertë, besoj. Sipas meje, kjo pyetje i duhet bërë shkrimtarit për çdo libër të tijin të veçantë dhe jo për të shkruarit në përgjithësi. Sepse çdo libër, në gjykimin tim, ka historinë e tij vetjake të ngjizjes, të lindjes; shkaqet e motivet pse është shkruar. Për shembull, librin tim të parë “Prostituta e virgjër” e kam shkruar për t’i pëlqyer e fituar zemrën një vajze. Edhe për dëshmuar - me njëfarë naiviteti atëherë - se “vetëm dashuria mund ta shpëtojë këtë botë të çmendur e të kalbur”. Kurse romanin tim të fundit, “Gruaja që deshe”, e kam shkruar për t’i shprehur dashninë e mirënjohjen sime shoqeje. Edhe për të dëshmuar - i bindur

tashmë - se “vetëm dashuria mund ta shpëtojë këtë botë të çmendur e të kalbur”.

HEJZA: Në letërsitë e mëdha, kritika është një ndërtesë e pavarur, një gjykatë, një shoshë, një zë që nuk ngatërrohet me zhurmën. Te ne, shpesh është heshtje, shpesh miqësi, shpesh ndonjë herë hakmarrje. E rrallëherë një analizë që lartëson ose orienton. Si e përjetoni mungesën ose dobësinë e kritikës letrare shqiptare sot? A i lë kjo krijuesit në një lloj zbrazëtie, ku nuk e dinë nëse po ecin drejt apo jo?

RIDVAN DIBRA: Keni të drejtë në ato që thoni. Edhe pse unë nuk besoj që jam i duhuri për të mbajtur qëndrim tepër kritik ndaj kritikës. Sepse ajo, domethënë kritika, jo rrallëherë ka qenë e vëmendshme ndaj veprës sime letrare. Edhe e saktë dhe e paanshme në jo pak raste. Sidomos në disa analiza që vijnë nga Prishtina. Para pak kohësh, këtu në Universitetin e Shkodrës ndodhi një ngjarje e rëndësishme për mua: u organizua një Konferencë Shkencore me afro njëzet tema e analiza rreth anëve të ndryshme të krijimtarisë sime letrare. E përmenda këtë fakt për të thënë se nuk mund të jemi krejt nihilist e mohues ndaj gjykimit shkencor letrar. Kurse për pjesën e fundit të pyetjes suaj më lejoni të zgjatem paksa. Ai krijues që pret gjykimet e kritikës apo çmimet e vlerësimet për ta ditur nëse po ecën drejt, nuk besoj se ka për të mbërritur larg. Nëse nuk ka marrë “bukën” me vete - besimin, talentin e lindur, kulturën, guximin, ambicien - dhe e pret atë “bukë” nga të tjerët, më mirë të mos niset për udhë. Ka një parabolë të mrekullueshme Kafka rreth këtij argumenti.

HEJZA: Një libër që nuk lexohet është si një letër që s’është hapur kurrë. Por në kohën e rrjeteve, lexuesi nuk e kërkon më “thellësinë” e një libri, por shpejtësinë e një postimi. Dhe shkrimtari vihet përballë një dileme të pashpallur: a duhet t’i afrohet lexuesit, apo ta sfidojë atë? Çfarë marrëdhënie keni sot me lexuesin shqiptar? E ndjeni si bashkëudhëtar, si shpërfillës, apo si një figurë gjithnjë në ndryshim?



RIDVAN DIBRA: Të vërteta ato që thoni ju. Kurse lidhur me “dilemën e pashpallur”, nisur nga përvojat letrare dhe parimet e mia krijuese, them se shkrimtari, njëherësh, edhe duhet t’i afrohet lexuesit, edhe duhet ta sfidojë atë çka, kuptohet, nuk është aspak e lehtë. Nuk them në asnjë mënyrë që, për hir të komunikimit me lexuesin, të sakrifkohet “thellësia” e veprës letrare. Por, ajo thellësi mund të përcillet në format e duhura, duke u perceptuar e duke u bërë joshëse për lexuesin. Një qëndrim arrogant e shpërfillës ndaj lexuesit do të ishte vetëvrasje për shkrimtarin; kështu gjykoj e besoj unë. Marrëdhëniet e mia me lexuesin shqiptar? Entuziaste e disi patetike në fillimet e mia letrare (kujtoj, për shembull, pritjet dhe takimet aq të përzemërta me lexuesit në Tetovë e Shkup para tridhjetë vitesh). Kurse tani këto marrëdhënie duken më të matura, të qëndrueshme. Them se kam lexuesin tim, ndoshta jo të shumtë në numër, që e ndjek dhe e pëlqen veprën time letrare. Dhe kjo është e mrekullueshme për një shkrimtar. Ndaj pohoj se lexuesin e ndjej si bashkudhëtar, gjithnjë në ndryshim; njëjtë si unë.

HEJZA: Është si një zbrazëti që zgjeron vetveten përditë: humnera kulturore që ndan prodhimin e vërtetë artistik nga perceptimi kolektiv. Ndërsa botojmë më shumë, lexojmë më pak. Ndërsa prodhojmë, humbasim përqendrimin. A mendoni se kultura shqiptare po përjeton një krizë thelbësore përballë sipërfaqësisë digjitale? A jemi duke krijuar për një publik që nuk e lexon më veten?

RIDVAN DIBRA: Po, pajtohem (si shpesh gjatë kësaj interviste): kultura shqiptare vërtet po përjeton një krizë të thellë dhe ju i përcaktoni qartë dhe saktë elementët e kësaj krize. Por, mos harroni se një krizë të tillë, në përmasa të ndryshme kuptohet, po e përjetojnë edhe kulturat e tjera. Domethënë, do ta quaja një krizë globale. Kurse pjesën e fundit të pyetjes suaj nuk kam dëshirë ta besoj si plotësisht të vërtetë. Sepse po të ishte vërtet kështu, do të hiqja dorë nga krijimi; vetë akti i të shkruarit bëhet absurd dhe i pakuptimtë në vetvete. Unë besoj që ka publik, ndoshta

Profile

KASEM TREBESHINA

Kritika letrare shqiptare akoma nuk është marrë seriozisht me veprat letrare të K. Trebeshinës. Përveç disa shkrimeve të përcepta dhe gjithsesi favorizuese për të dhe veprën e tij, kritika letrare shqiptare akoma hesht për gjerësinë, thellësinë dhe profilizimin letrar të autorit

Nehas SOPAJ

Kasem Trebeshina ka lindur në Berat në vitin 1926. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, të mesmen në Elbasan, kurse në vitin 1942 inkuadrohet në LNÇ, me ç’rast ndërpret shkollimin përkohësisht për shkak të plagosjes. Pas çlirimit, si edhe shumica e shkrimtarëve shqiptarë, shkon në Rusi, në Sans Peteburg, por për shkak se në atdhe përjashtohet nga Lidhja e shkrimtarëve, i merret e drejta e studimeve dhe kthehet në Shqipëri. Duke qenë një njeri që e kishte përjetuar luftën dhe kishte bindjen e një idealisti, K. Trebeshina iu kundërvu kryetarit të shtetit, andaj tri herë do të burgoset, ndërkaq iu edhe ndërprenë botimet. Duke u shpallur edhe i çmendur, K. Trebeshina do ta kalojë jetën mbi 17 vjet në burg, kurse të gjitha këto vuajtje personale do t’i artikulojë në veprat letrare, të cilat shëmbëllejnë me një mori krijimesh artistike, të cilat dalin nga ajo botë e përjetuar si ironi absurde e fateve njerëzore, individuale dhe kolektive. Pas ngjarjeve të njohura të vitit 1997, K. Trebeshina e braktis atdheun, Shqipërinë, dhe vendos të jetojë në Turqi. Vdiq në Ankara më 6 nëntor 2017. Si një ndër krijuesit e veçantë letrarë shqiptarë, K. Trebeshina paraqet një individualitet dhe profil të një shkrimtari që njihet shumë vonë, edhe pse ai s’është më. Duke qenë një ndër shkrimtarët që kanë përjetuar një golgotë personale gjatë regjimit komunist, veprat e tij nisi t’i botojë vetëm kur u përmbys komunizmi. Edhe pse vepra e tij e parë Artani dhe Min’ja ose Hijet e fundit të maleve ishte botuar qysh në vitin e largët 1961, atëbotë kur shkrimtari ishte i ri dhe kishte dhënë provat e një talenti. Koha e tij e artë e defilimit para lexuesve, koha e vërtetë e botimeve të veprave të tij, janë vitet e `90-ta, atëherë kur nisën të radhiten një mori përmbledhjesh me poezi, novela, romane dhe drama të shkruara shumë më herët, si dhe krijime të tjera aktuale, që do të botohen për herë të parë. Si edhe shumë krijues të tjerë të cilët censura dhe ndalimi i botimeve s’u shkonin për shtati burokratëve të kuq, siç shprehet ai, në punëtorinë letrare të K. Trebeshinës, pranë veprave të botuara pas viteve të `90-ta, akoma presin të botohen një varg romanesh, librash me poezi dhe pjesësh teatrale, që flasin për një shkrimtar shumë produktiv dhe të gjithanshëm, vepra këto që presin të vlerësohen dhe të studiohen nga kritika e kohës. Marrë në përgjithësi, kritika letrare shqiptare akoma nuk është marrë seriozisht me veprat letrare të K. Trebeshinës. Përveç disa shkrimeve të përcepta dhe gjithsesi favorizuese për të dhe veprën e tij, kritika letrare shqiptare akoma hesht për gjerësinë, thellësinë dhe profilizimin letrar të autorit, i cili gjithsesi është shumë interesant, si dhe me rëndësi të veçantë letrare dhe të një krijuesi akoma të pastudiuar. Një simbolizëm dhe surealizëm interesant, janë vlerësimet fragmentare të kritikës letrare pa një thellim dhe analizë të stërholluar të veprës letrare që pret të studiohet, analizohet dhe interpretohet nga kritika, por edhe të botohet ajo që është në dorëshkrim, në mënyrë që mendimi kritik për të të jetë relevant dhe i verifikuar. Disa vlerësime të A. Klosit, S. Hamitit, B. Gjokës etj., dëshmojnë se vepra letrare e K. Trebeshinës është e shumtë dhe me peshë, e shumënduarshme, e thellë dhe shumë ironike. Vepra e K. Trebeshinës e ka kompleksin e regjistruesit të drejtpërdrejtë të ngjarjeve të kohës aktuale dhe vështirësinë e receptimit të distancës së kohës të leximit, dyshimit dhe receptimit pa rezervë, që d.m.th. vështirësitë e njohjes së realtë të së vërtetës që na ofrohet neve si lexues, në mënyrë që gjykimi të jetë i drejtë dhe pa emocione. Absurdi, ironia dhe tallja janë shenjat e qarta e të shpeshta që e shenjëzojnë gjuhën letrare të shkrimtarit, me të cilën e shëtit lexuesin vepra letrare



e K. Trebeshinës. Absurdi i kohës kur shkrimtari i shkruan veprat e tij janë, për shembull, vitet1953-56, kur botohet vëllimi prej tri novelash: e para Stina e stinëve, e dyta me titull Odin Mondalsven dhe e treta Fshati mbi shtatë kodrina, që të gjitha me nga një nëntitull veç e veç. Pastaj është fakti i përpunimit, kur kompleksiteti i fakteve të reja, që në artin e tij patjetër duhet ndryshuar, pra fakti letrar përmbi atë jetësor (që nganjëherë duhet të ndryshohet), e mpleksin tekstin para lexuesit si një faktografi që e lufton të vërtetën reale nga e vërteta reale artistike. Novela Odin Mondalsven ka një kohezion të brendshëm për shumë arsye: e ka kompleksitetin e përzierjes së kohërave dhe të hapësirave. Heroi Odin Modalsven, një danez që më pak është danez e më shumë shqiptar, në fakt është një K. Trebeshina, që në hullinë e absurdeve kërkon identitetin e humbur në këtë kohë dhe hapësirë të tëhuajësuar, të egër dhe të barbarizuar brenda unit që s’e njeh veten, s’e prek, s’e identifikon dot atë. Vepra, sipas datës së shkrimit, mban datën 1953-56, ndërsa është botuar për herë të parë në fillim të viteve të `90-ta në Prishtinë e në Tiranë. Më pak se histori dashurie, ajo ngërthen ironinë e një fati tragjik të heroit, një intrigim për një abuzim fatal të fatit të tij, i cili mund të jetë një “i krisur” që i bën të krisur të tjerët, pra ata që e pandehin për të tillë. Odin Mondalsveni është një personazh që para botës thotë se është danez, se gjyshin e ka pasur italian të martuar me një franceze, por nënën e ka daneze. Një personazh i cili ka humbur toruan e kohës dhe të hapësirës, që është i mbyllur në një spital psikiatrik dhe mediton për kohërat dhe hapësirat, të cilit i shkrepin ide fantastike për realitetin, një Don Kishtot ose një psikopat që të çmerit me ide racionale, por që gjatë meditimit i “ngatërron” ngjarjet, emrat dhe personazheve të tij.

Odin Mondalsvenit i është turbulluar gjithçka. Koha e tij bredh nëpër intuita të papritura, kurse hapësirat nëpër të cilat shëtit mendja e tij janë ato të viseve nordike ose ato të Mesdheut. Të gjitha këto “kurthe” artistike të shkrimtarit, shëmbëllejnë me botën reale të tij,i cili për të na shëtitur në botën e tij shpirtërore, heroin e hedh herë në spital psikiatrik, herë në burg e herë e nxjerr në liri. Gjithë ky kaos, sikur synon të dëshmojë se çdo rrugë “lirie” përfundon me tragjedi. Kjo liri shpaguhet me çmenduri, ndërsa çmenduria shpaguhet me një përfundim tragjik për njeriun. Duke ironizuar me të vërtetën e hidhur të ideologjisë komuniste në të gjitha porët e shoqërisë shqiptare në kohën e pjesës së dytë të shekullit të kaluar, shkrimtari radhit paradokset e njëmendësisë komuniste, kur individi i zhduk vlerat e tij

individuale, duke u shndërruar në një kokë pa tru. Gjithë kjo bëhet ironi therëse në vetëdijen e tij kur e ballafaqon heroin Odin Mondalsvenin me absurdin e përditshëm dhe të gjithanshëm deri në skajshmëri. Novela Odin Mondalsven është vepra që lë mbresë të madhe te lexuesit. Thamë se ajo është shkruar me një dozë ironie të thellë. Në të vërtetë, shkrimtari e satirizon shoqërinë shqiptare të periudhës komuniste, duke i vënë në bisht lahute sa kolektivitetin, po aq edhe individin, kolektivin ose shoqërinë, që është njëmendësi, dhe individin, që është katandisur në qenie pa tru. Në rrëfimin satirik shkrimtari shpik një personazh të cilin e shëtit herë nëpër burgje e herë nëpër spitale çmendurie, madje nganjëherë edhe në fushë të lirë, ku liria është robëri. Odin Mondalsveni, hero i kryesor i rrëfimit, të gjitha veprimet i bën rreth dy koncepteve të përgjithshme njerëzore, siç janë liria dhe robëria. Në planin intim, aty është një grua e ndarë nga burri, e cila do të martohet me të, por meqë ai është një njeri i përndjekur, atij i bie që të luftojë që ta kthejë atë (gruan) kah vetvetja, d.m.th. të çlirohet nga ndjekja që ia bëjnë të tjerët. Aty parakalojnë njerëz që përpiqen “ta shërojnë” nga gjendja e vështirë mentale që e ka pllakosur. Është vështirë kuptohet në janë ata mjekë, njerëz të politikës ose edhe gardianë burgu. Të gjitha alegoritë shpijnë në Shqipërinë komuniste –edhe kur “danezi” Odin Mondalsfen, “i ardhur nga një planet tjetër” sikur me të vërtetë është një ardhacak. Konstelacionet e analogjive për të flasin për një shqiptar i cili gjendet brenda procesit gjyqësor, kurse në rrëfimin e autorit rreth tij sillen hetues, trupa hetuesish, po kaq sa edhe mjekë e spitale neurologjish. Këtu parakalojnë Putifari, faraonët, gruaja e bukur e Putifarit, Josifi, që mund të ishte Isuf, Mehmeti etj., personazhe që ironizojnë dhe satirizojnë personalitete të ndryshme të kohës publike dhe anonimate të kohës. Novela ka një pëshjtjellim të qëllimshëm të kapitujve, të ngjarjeve dhe të personazheve, ku çdo gjë sillet sipas terkut të absurdit të aktualitetit. Teknika e rrëfimit është një rrëfim i rrëfimtarit të gjithëdijshëm, që nuk emocionohet gjatë dialogëzimit të personazheve dhe në to shihen përgjasime të stilit të Kafkës etj., përgjasime që, megjithatë, janë më shumë koincidenca letrare sesa ndikime të autorit. Ndër veprat më të realizuara të K. Terbeshinës patjetër është Ku bie lliria, një vëllim prej gjashtë tregimesh, që lexuesi mund t’i lexojë edhe si një roman. Tregimet Dy mijë vjet në një natë, Ngatërresa në Apoloni, Kambanat e Shën Ilisjë, Hani i Bregomirës, Koka e Artemidës dhe Ëndërr qershori, ndërtohen mbi bazë të konceptit të jetës dhe të ëndrrës, që për bartës kanë personazhet e tregimeve të tyre të ndryshëm. Shkrimtari, ngjashëm si

edhe te Odin Mondasveni, me qëllim bën përshndërrimin e koncepteve kohë dhe hapësirë në të cilat kohërat alternohen, duke u nisur nga koha e tashme e deri te ajo fiktivja (por edhe mitikja), kurse hapësirat alternohen që nga Shqipëria, Egjipti e gjer te ato të trilluarat, të ironizuara pafundësisht. Si edhe në të gjitha veprat e tjera, romanet dhe dramat, personazhet e këtyre tregimeve sorollaten brenda një hapësire në të cilën sundojnë padrejtësia, pasiguria, snobizmi, egocentrizmi etj. Pena e K. Trebeshinës është tepër kryengritëse, rebele dhe skajshmërisht e nxjerr fatin ironik të personazheve, të cilët shpesh janë tragjikë dhe ruajnë në vete hovin shpirtëror të mohimit të realitetit tallës të kohës. Prandaj regimet e tij mund të kuptohen si parodi të ndryshme që kanë ndërtime që e përplotësojnë njëri-tjetrin. Tregimi Lashtësi moderne, me një nëntitull që e parodizon historinë dhe vlerat morale kombëtare, bashkë me kultet e besimeve fetare, me një ironi të thellë fsheh thekse bizare me elemente të komikes e humorit, që shpesh arrijnë deri në fundin tragjik të epokave të ndryshme, që për rrethanë e kanë të tanishmen e përhershme. Në këtë tregim në mënyrë artistike rrotullohen kohërat dhe hapësirat, duke i kthyer ato me kokë teposhtë –koha e partisë moniste me kohën e Egjiptit të lashtë, ndërkaq hapësira ku ndodh kjo është hapësira e epit të Niberlungëve të Gjermanisë. Aluzioni i ndrydhjes së lirisë, robërimi i njerëzve, është transparent gjithandej si në të gjitha tregimet e tjera. Për personazhe bartës të rrëfimit shkrimtari merr Asmut Rrakataken dhe Dylon Shuploin, shkrimtarë oborrtarë, që në fakt janë njerëz servilë të pushtetit. Rrëfimi i shkrimtarit është tepër sarkastik –ai ata i ngarkon mbi gomarë njëlloj si Servantesi Don Kishotin. Tregimi tjetër, Dy mijë vjet në një natë, rrëfen për një arkeolog i cili është fshehur buzë një qyteti të lashtë për t’i bishtnuar dënimit të diktaturës dhe shkrimtari e ballafaqon atë me një ëndërr sikur të ndodhte para dymijë e katërqind vjetëve, diç që më vonë përshndërrohet dhe bëhet bashkë me një grup piratësh të shekullit XI. Ëndrra ndërpritet me ardhjen e agut,kut shkrimtari na kthen në atmosferën e tmerrshme të pushkatimeve masive, kurse zëri i ngjirur i personazhit që fsheh zërin komentues të autorit zbraz komentimin gjithsesi Ngatërresa në Apolloni, në të cilin personazhi Nazo Ymeri shpallet kulak sepse ka blerë një gomar dhe me të e ka dëmtuar pasurinë e popullit, kurse revolta e tij, e cila do t’i zbardhë qëllimet e ironisë së shkrimtarit, bëhet përmes ëndrrës. Ëndrra e tij është tmerrësisht sarkastike: ai e sheh ëndërr Hiqmetin, shokun e tij të luftës, të cilin pasi e kanë vrarë shokë e tij partizanë, i shpijnë lule mbi varr. Ëndrra vazhdon më tmerrshëm – atij i dalin njerëz të para njëzet shekujsh, që e akuzojnë për rrëmbimin e një vajze, pastaj i fanitet një skenë tjetër e një epoke më të re, diçka si ëndërr në ëndërr, sikur i del para sysh Isa beu dhe koha e pushtimit turk, kurse ata e marrin për një akinxhi. Nazo Ymerin e shpëton një njeri i vogël, që është personifikim i një ndërgjegjeje të fjetur brenda vetes së tij. Ai i vegullohet me barkë, për ta ndihmuar që ta shpëtojë kokën. Tregimet e tjera më shumë se tregime klasike janë balada të bukura dhe jashtëzakonisht të realizuara artistikisht. Në tregimin Kambanat e Shën Ilisë personazhi kryesor është kapetan Tafili, i cili sikur me parandjenjë parasheh se nëse u bie kambanave, mund ta gjejë fati i kobshëm.Dhe,ashtu ndodh –ai vritet në luftë me pashain turk, ndërkaq e fejuara e tij, e veshur e tëra me të bardha, hidhet në greminë. Te tregimi tjetër, Hani i Bregomirës, dy gra të internuara nuk duan t’i bien në dorë njeriut të sigurimit dhe prandaj bëjnë vetëvrasje.

175 vjetori i vdekjes së Balzakup

GJENIU QË I NGJAN ÇDOKUJT DHE ATIJ ASKUSH

Balzaku, pa frikë duhet rreshtuar në krye të atyre shkrimtarëve që ndoqën parimet e realizmit kritik, që duke u marrë me demaskimin e fenomeneve negative, nxitën te lexuesit frymën e protestës kundër të keqes



Shpendi TOPOLLAJ

Janë fjalët e vetë atij, për të cilin po marr guximin të shkruaj Nuk besoj se ka shqiptar që ka shkuar ndonjëherë në Paris dhe të mos ketë pritur të takojë në ndonjë qosh rruge, park e kafene, një burrë të bëshëm, me tipare të theksuara ezmere, flokë pak të gjatë, krehur me vizë anash, mustaqe e shikim të butë babaxhani, që quhet Honore Balzak (Honore de Balzac). Po ashtu, askujt nuk i besohet se ai është larguar qysh në 18 gusht të vitit 1850 nga ai vend që me penën e tij i dha famë dhe e bëri të njohur anë e kënd rruzullit, duke lënë pas hijen e ndritur të një gjeniu me 92 vepra të jashtëzakonshme dhe mermerin e busteve të tij. Koha kur ai jetoi (lindi në 20 maj të 1799 në Tur), ishte e ngarkuar me ngjarje që përgjithësisht rëndonin shoqërinë franceze të asaj kohe nga zvetënim i moral, korrupsioni dhe etja për fitime. Revolucion i vitit 1789 që kishte nisur me pushtimin e Bastijës, shpalljen e Republikës së Parë dhe çuarjen në gjiotinë të mbretit, që u pasua me diktaturën jakobine, u zëvendësuan nga pushteti i Napoleon Bonapartit, i cili e hodhi shpejt shikimin përtej Francës. Burbonët e rikthyer pas turpërimit të Bonapartit në 18 qershor të 1815 në betejën e Vaterlos, qëndruan plot pesëmbëdhjetë vjet dhe në 1830, Revolucion i Korrikut solli mbretërimin konstitucional të Lui Filipit. Balzaku e pati jetën e shkurtër dhe e jetoi Republikën e Dytë vetëm nja dy vjet. Pra, ishte një periudhë e ngjeshur me ngjarje dhe me njerëz të lodhur e të zhgënjyer nga pritshmëria e revolucioneve. Për pasojë, kuptohet se edhe karakteret e tyre ishin në një krizë të thellë. Gjallërimi dhe përhapja e ideve të majta, dha ndërkohë një farë shprese, gjë që u pasqyrua edhe në art e letërsi me atë që u quajt realizëm dhe që ishte parë te Rilindja me Bokaçion, Rablen, Servantesin, Lope de Vegan e Shekspirin me shokë. Balzaku, pa frikë duhet rreshtuar në krye të atyre shkrimtarëve që ndoqën parimet e realizmit kritik, që duke u marrë me demaskimin e fenomeneve negative, nxitën te lexuesit frymën e protestës kundër të keqes. Në themel të tij, ky realizëm kritik, pati përhapjen e idealeve pozitive si atdhedashuria, nevoja e lirisë dhe çelja e perspektivës për jetë më të mirë. Por trashëgimia letrare e atij vendi ishte mësuar me shije të tjera letrare, si dramat e poezitë, ndaj dalja në skenë e Balzakup si romancier, ishte diçka e re. Megjithatë, për atë popull qe fat, dalja e një talenti të tillë, i cili me veprën e tij madhore edhe e oriento i lexuesin nga ky zhanër, për të mos thënë se romanet e tij priteshin me padurim, sidomos për të vërtetat që mbartnin

brenda tyre. Ja pse edhe shkrimtari tjetër francez i atyre viteve, Charl Bodëler (Charles Boudelaire), e quante vizionar të mrekullueshëm dhe shumë të tjerë, baba të romanit. Babai i tij quhej Fransua Balssa (që më pas ju mbush mendja ta bënte Balzak), dhe kishte shërbyer në ushtri me detyrën e intendentit, kurse e ëma, plot tridhjetë vjet më e re se ai ishte një bishtpërdredhur që i dha Balzakup një vëlla të jashtëligjshëm që quhej Anri. Kishte dhe dy motra, Laurën dhe Lorencën, shumë pak më të vogla se ai. Gjendjen ekonomike se familje e kishin të mirë, pasi i ati që ishte me origjinë nga fshati, bëri prokopi gjatë rrëmujave të revolucionit. Nga mosha tetë vjeçare, djaloshi shkoi për gjashtë vjet në shkollë në Vandome, dhe më pas në kolegji në Tur. Kur më 1814, familjarisht shkuan në Paris, ai kreu studimet e larta në Universitet në degën e Jurisprudencës. Si u diplomua, punoi për ca kohë në një zyrë avokatie, por mendjen e kishte dhe krijimtaria letrare. U vendos siç ishte zakoni në një dhomë të lagjes Bastija dhe gjeti një botues të quajtur August Le Poitevin. Shkroi një dramë me titullin “Kromuell”, por ajo kaloi pa u vënë re. Në bashkëpunim me mikun botues, nisi krijimet e para si “Trashëgimtari i Birag”, “Famullitari te Ardenët”, “Argou pirati” etj. të cilat i botoi me pseudonime. Nuk ishin kushedi çfarë, megjithatë ai nuk ngurronte të shprehej se do ta pushtonte botën me penë, si Napoleoni me shpatë. Dhe e bëri! Është koha kur njihet dhe tërheq vëmendjen e një gruaje më të madhe në moshë, të quajtur L’or de Bernit e cila nuk ja kurseu asnjëherë përkrahjen. Dhe si për t’ia shpërblyer miqësinë, ndihmën dhe mundet edhe dashurinë, Balzaku një vit para vdekjes së saj botoi librin që ja kushtoi, “Zambaku në luginë” (1835).

Gjithmonë në sjelljen dhe stilin e të veshurit, kishte një farë snobizmi, madje thuhet se pasi vdiq, megjithë borxhet që pati, i gjetën në garderobë treqind jelekë. Kjo qe dhe arsyeja përse i shtoi biemiemit të tij atë dë - në. Po ashtu, nisi të frekuentonte edhe sallonet mondane të kryeqytetit, ku ra në dashuri me markezin de Castri, dhe duke ditur se kjo lloj jete kërkonte para, ju fut, por pa sukses biznesit. Kështu, tentoi aty nga viti 1825 të bëhej vetë tipograf, por nuk ia doli, të vinte në shfrytëzim një minierë argjendi në Sardenjë, por kot, dhe u mor me tregtinë e drurit në Poloni, ku gjithashtu dështoi. Ndofta, ky qe fat i madh për letërsinë, pasi i la kohë që të shkruante nëntëdhjetedy libra. Kishte dhe një fiksion pas mobilieeve antike, ku shpenzonte shumta të mëdha. Kurse për të shkruar, punonte kryesisht natën, deri edhe 10 orë, duke qëndruar në këmbë dhe

duke rufitur pa fund filxhanët e kafesë. Kishte parimin “Për të qenë zotëria i dijes, duhet të jesh skllavi i punës”. E tërhiqnin gratë, dhe ato e vlerësonin për mendjen e tij të pazakontë dhe sidomos mendimet e tij rreth tyre dhe martesës, të shprehura te libri i tij “Fiziologjia e martesës”, kryesisht me shkrime të vogla për zbavitje. Por, akoma më shumë tërhoqi vëmendjen e tyre romani “Lëkura e shagrenit”, që e shkroi kur ishte gazetar te “Letra mbi Parisin”, ku ato në filozofinë e tij gjetën nevojën e trajtimit njerëzor të tyre. Për të shprehur konsideratat e tyre, nga të gjitha anët, shkrimtarit i vinin letra mirënjohjeje dhe ky qe rasti kur simpatinë e saj e shprehu në 1832 dhe kontesha polake Eva Hanskaja që nënshkruante “E huaja”. Ajo ishte një grua e martuar që jetonte në Ukrainë dhe që e vazhdoi korrespondencën me Balzakup për tetëmbëdhjetë vjet me radhë, gjersa u bashkuan. Në një dhjetë vjetësh (1830 - 40), krijoi ndër të tjera figurat e tre B - ve të mëdha; Gobsekun, Grandenë dhe Gorionë, respektivisht te romanet e tij “Fajdexhiu Gobsek” (31), “Evgjeni Grande” (33), dhe “Xha Gorio” (34). Punun me vullnet titanik, dhe të çudit fakti se ai lidhte kontrata me botuesit dhe ua dërgonte romanet me fashikuj për gazetatat. Duhet të ishe Balzak që ta bëje një gjë të tillë, pasi dihet se procesi i botimit të një romani, kërkon që ta shohësh e rishohësh, ta shoshitësh e ndreqësh, ta korrigjosh e plotësosh atë. Veç këtyre që përmendëm, romane të rëndësishme të këtij autori fenomenal, janë edhe “Mjeku i fshatit” (33), “Koloneli Shaber” (33), “Iluzione të humbura” (37 - 43), “Shkëlqimi dhe mjerimi i kurtizanave” (39 - 43), “Kushërira Beti’ (46), “Kushëriri Pons” (47), “Fajdexhiu”, “Fshatarët” etj. Për gjithë këtë veprimtari letrare, pra për botimin e paparë të dy deri tre romaneve në vit, në vitin 1839, Honore Balzaku zgjidhet kryetar i Shoqërisë së Shkrimtarëve. Tematika realiste e zgjedhur prej tij të trondit si me tematikën që trajton, ashtu edhe me forcën përshkruese të karaktereve që të mbesin të pashlyera në mendje. Kështu, mund të përmendim romanin “Xha Gorio” që mbahet nga kritike si kulmi i talentit të tij që përshkruan si rrallëkush psikologjinë e babait të ngujuar në hotelin “Voker” (Vauquer Maison), dashurinë që ai ka për bijat e tij Delfina e Anastasia, të martuara, njëra me kontin De Resto dhe tjetra me baronin De Nysingen, dhe indiferencën e pabesueshme të tyre, që e kanë për turp të pranojnë në shtëpi babanë jo aristokrat. Vajzat që i rrëmbejnë gjithçka, e lënë të atin të vdesë në mjerim dhe për ta varrosur nuk denjojnë të shkojnë vetë, por çojnë karrocata e tyre. Çfarë ironie e karaktereve njerëzore,

çfarë mosmirënjohjeje, çfarë shembulli për të treguar se deri ku të çon lakmia dhe ambicia për emër, lavdi e pasuri. Po sa bukur na e jep ky mjeshtër studentin Rastinjak i cili ka virtyte, por duar - duar edhe ai i afrohet të keqes, se fundja në të tillë kohë jeton, dhe e ka të vështirë të dalë jashtë saj. Dhe si për të mos e flakur tej të mirën, Balzaku ne jep portretin e shokut të tij Bajshonit i cili i ruan deri në fund vlerat njerëzore. Në krijimtarinë e këtij autori madhështor gjejmë qindra e qindra personazhe, mbi dymijepesëqind të tillë, tipa e karaktere nga më të çuditshmet dhe secili me profilin dhe veçoritë e veta. Ka aty oborrtarë, nëpunës të lartë, pasanikë, varfanjakë, kryeneçë, servilë, dinjitozë, të paskrupullt, të papunë të të gjitha regjimeve nga kaloi Franca e asaj kohe. Besimi për “Liri, Barazi, Vëllazëri”, mesa duket kishte qenë vetëm një dëshirë, një ëndërr, një utopi. Por iluzionet humbën. Humbën, por lanë pas një galeri të pafund personazhesh, të cilët mjeshtri Balzak i përmbloodhi te vepra madhore “Komedia njerëzore”, të cilën mund ta quante edhe “Tragjedia njerëzore” apo “Tragjikomedia njerëzore” (La comedie humaine), dhe që ndahet në jetë private, jetë në provincë dhe jetë parisiane. Sidoqoftë, pavarësisht larmisë së temave apo gjendjeve e qëndrimeve të heronjve të saj, në këtë kryevepër, aq sa ndeshim neverinë për vesin e të keqen, aq dhe konstatojmë vlerësimin për virtytin e të mirën. Se fundja, sipas autorit, gjithçka është pasojë e rregullimit jo të drejtë të shoqërisë, ku i fuqishmi, i pasuruari në rrugë të pandershme, i pushtetshmi, shpesh triumfon dhe e nëpërkëmb të varfrin, të dobëtin, të ndershmin edhe pse ky i fundit mund të jetë i mençur a i ditur. Ja pse e gjithë vepra e këtij autori nga më të mëdhenjtë që njerëzimi ka nxjerrë, merr vlera të veçanta edhe në ditët tona, dhe sidomos për ne shqiptarët, për situatat sociale, politike dhe ekonomike që po kalojmë. Ndofta, prandaj dhe ne kur ndodh të shkojmë në Paris, e kërkojmë atë që kishte punuar aq shumë, sa edhe vetë e kishte kuptuar, kur thoshte se “Puna e shumtë e ha të zotin”. I rraskapitur nga kjo punë titanike, ai vdiq sapo kishte kapërcyer të pesëdhjetat, atë vit kur lindi një tjetër mjeshtër i madh i penës franceze, Gi de Mopasani (Guy de Maupassant), kur nuk kishte shumë që ishte kthyer nga ceremonia e martesës me konteshën polake, që çuditërisht e deshi akoma më shumë se gratë e Francës.*

*Letërkëmbimi i tij me konteshën Evelina Hanska me titullin “Lettre a madame Hanska” u botua në vitin 1968.

Ndodh që dhe poezia ndryshon

DONJA MARIA E POETIT KUBAN NICOLÁS GUILLEN DHE SHQIPËRIA

Nicolas Guillen do të bëhej figura kryesore e poezisë afro-kubaneze (poesía negra), duke kombinuar ritme muzikore nga “son” me onomatopoetikat dhe dialogun popullor për të përshkruar mënyrën e jetës së komunitetit...

Nga Visar ZHITI

Shohim nëpër anketa dhe intervista të bëhet dhe pyetja për librat që të kanë ndryshuar jetën dhe përgjigje nga më të ndryshmet, të bukura dhe me të papritura, por unë them se ka dhe poezi me ndikim të fuqishëm, që sjellin ndryshime jo vetëm brenda teje, por edhe jashtë, mund të ndryshojnë dhe ngjarje dhe rrjedhën e tyre...Dhe ajo poezi mund të jetë nga andej ku s’pritet, e thjeshtë, madje mund të jetë dhe përkthim. Kam një të tillë, që më ka ndihmuar. Dhe unë kam poetë të mi, që më kanë bërë të ndjej shumë, më duket se dhe më kanë formuar së brendshmi me poezinë e tyre të madhe. Dua të kujtoj njërën, disi e veçantë, që më duket se më ndihmoi shmangien e një kërcënimi, që ndryshoi rrjedhën e ngjarjeve. Më ndodhi kur më kishin arrestuar dikur. E kam treguar dhe në burgologjinë time “Rrugët e ferrit”:

NË QELI:

...Dhe ti kërkon libra në qeli, tallej njeriu tjetër i qelisë. S’lejohen. Po sikur të na pushkatojnë? - thoshte. Pse, ç’ke bërë ti? Doja të arratisesha në Kosovë... Por më kapën, m’u hodh qeni i kufirit, më nguli dhëmbët. Të ka lënë shenja? - u dëshpërova unë. - Do ndonjë copë këmishë ta lidhësh? Jo, jo, u zverdh ai. Copë e kam, ma shqeu qeni. S’ka shaka me këta! Prano edhe ti që doje të arratiseshe. Por, unë s’kam dashur. Kurrë? - pyeste ai. E pamundur, përgjigjej vetë. - Po ç’ke bërë? Këta s’të kapin kot. Do të sqarohet, - thosha unë dhe s’duroja pa sharë: Bastardët. Dhe, kur më erdhën sërish ushqime nga shtëpia, copat e byrekut, që isha i sigurt se qenë lagur dhe me lotët e nënës sime, i ndava me të. Dhe ai i ndau të vetat me mua, vetëm herën e parë. Ushqimet e tij ishin si të blera, kuleç nga ata pesëlekëshit. Edhe dysheku i tij dukej si i reparteve ushtarake. Herë pas here kishte qejf të vishte pardesynë time dhe të shëtiste me të nëpër birucë. Si në qytet, thoshte. Dhe s’ma linte fshesën në mëngjes, jo ti, jo, se je intelektual. Unë gjeja rast dhe përsëritja poezitë e mia, me frikën se mos nxirrja zë, kur lëvizja buzët. Po flas me vete, e ç’të keqe ka? Bibliotekën e padukshme e kisha lënë atje... Tjetri e kishte mbaruar xhiron e tij. Ia shihja hijen në mur, me veshët e mëdhenj. Mi i stërmadh, shumë minj bashkë. Por... Shumria, i thosha, fshati nga je ti, ka kuptimin Shën Meri. Bukur, ë? Ti në burg s’do të rrish me mua, por me të tjerë, - brengosej ai, - me intelektualë. Njeh ndonjërin? Jo. Pastaj, se ç’më shkrepì, i recitova një poezi, për një nënë, Donja Maria, ë, ngjan me Shumria, e gjora s’dinte gjë për djalin spiun, “që ia paguante policia”... Jotja është? - U tmerrova. - Jo, jo, e një poeti kuban. Kurban? Ku e ke parë? Asgjëkundi. E ka përkthyer Petro Marko, e ke dëgjuar? Ka luftuar në Spanjë... E ç’të vazhdoja? Quhet Nikolas Gilen, - thashë. Kush? Ai poeti. Ia thashë, që ta dinte që s’ishte poezi imja. Po ti shkruan? - më pyeti befas. Kam shkruar. Këtu? Ndala. Mos kisha folur natën? Kur unë bëja gjumë të çartur, ai flinte i qetë. Po aq i qetë vinte nga hetuesitë, ndonjëherë



edhe i ngrënë, sepse binte erë hudhër e sallam, kurse unë kthehesha i rraskapitur, i verdhë, si pa gjak, më thoshte ai, si i porsapërmendur nga një të fikët i rëndë. H. H. ishte provokatori që më kishin futur në qeli dhe unë i flisja për poezinë. Vetëmbrojtje? Por dhe sulm. Unë për poezitë isha arrestuar. Mos po e rëndoja veten? Dhe për çudi, i recitova poezinë “Donja Maria”:

E gjora Donja Maria, E mjera që s’di gjë, Djali i saj – gjarpër pa zë, Paguhet nga policia.

Dje si dhelpra me hile Vinte rrotull shtëpisë time. Më hodhi ca shikime, Ish veshur me rrova civile.

E mjera Donja Maria, Një zonjë tepër e nderuar, Për djalin s’e ka kuptuar, Që e paguan policia.

E di ende përmendësh, e shkruajta tani pa e pasur librin ndër duar, shumë gjëra më kanë humbur nga kontrolltet dhe konfiskimet, është poezi e poetit kuban, Nicolas Guillen, marrë nga libri i tij “Kitara kubane”, përkthyer në shqip nga poeti dhe shkrimtari ynë, Petro Marko. E kisha gjetur atë libër kur isha gjimnazist në Lushnjën e vogël, ndërkohë ishte ndaluar, sepse miqësia politike e Shqipërisë së Enver Hoxhës me Kubën e Fidel Kastros nuk zgjati shumë, qe ftohur fare, se ata, kubanët, ishin me Bashkimin Sovjetik, ai dhe i mbështeste dhe ndihmonte revolucionin e tyre, marksizëm-leninizmin, kurse Shqipëria ishte fare e vogël, mjerisht e varfër dhe qe ndarë nga kampi socialist, duke shkuar më keq, qe lidhur me Kinën e Mao Ce Dunit e të revolucionit kulturor, ndryshe diktatori Hoxha s’rrinte dot në pushtet. Ndoshta atë periudhë të paktë miqësie e shfrytëzoi Petro Marko dhe përktheu nga spanjishtja një poet kuban, ia kërkuan sigurisht, por bëri poetin guximtar, gjeti poezi të shkëputura nga vargonjtë e Realizmit Socialist, të çlirëta, gjithë kumbime të artit të Amerikës Latine. Ndodhte që biblioteka në provincë e harronte listën e librave të ndaluar a bënte sikur me të njohurit e vet, ndërkaq libra të tillë çoheshin në fabrikën e letrës për t’u ricikluar në letër. Mbaj mend dhe 4-5 kubanë, që kishin ardhur për specializim në bujqësi, kështu thuhej, mësonin të prashisnin dhe pasdite rrinin te një lulishte e vogël para hotelit të vetëm që kishte qyteti, “Myzeqeja”, mblihdeshin

kalamajtë përreth tyre dhe thoshin me zë të lartë: Kuba si, janki no! Ata qeshnin, njëri guxoi e bërtiti si me të tallur: Kuba no, janki si! S’e di a e denoncuan?... Mes tyre ishte dhe një zezak i gjatë e i hollë, ia kërkova adresën dhe unë, e mbaj mend, quhej Nadividat, shkruaji që tani, po të duash, një letër motrës time Dalia në Havana, tha, se përgjigjet, etj, etj. Bëri bujë në Lushnjë që Sekretari i Parë i Partisë, shoku Q. M. u caktua në një delegacion qeveritar që të shkonte në Kubë. Nuk e di pse u gëzuam dhe ne, kalamajtë e lagjes. Kur u kthye, bëri një takim me intelektualët e Lushnjës, ku ishte dhe im atë me të gjithë estradën ku ai punonte. Sekretari i Parë u foli për mrekullinë kubane nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, ku krahas kasolleve, kishte vetura dhe grataçe dhe tregoi për betejen në Plazhin Zhiron (Playa El Girón) në Gjirin e Derrave (Bahia de Cochinos), ku zbarkuan emigrantë kubanë të mbështetur nga CIA për të përmbysur regjimin e Fidel Kastros. Përpjekja dështoi. Revolucioni kuban kishte fituar kundër imperializmit amerikan. Plazhistët, ashtu siç ishin me rroba banjo, ishin hedhur në sulm, e kishin goditur armikun me çadrat e plazhit, me këpuçë kokës dhe në muze dokumentohet kjo luftë me fotografi e armë e avionin e rrëzuar, etj. Asosacion idesh. Një avion tjetër amerikan është në Muzeun e Kalasë së Gjirokastrës, që forcat tona ajrore syshqiponja e rrethuan në qiellin tonë dhe e detyruan të ulet, të zënë rob. Ka dhe një poemë për këtë akt heroik...

Mbas rënies së komunizmit dolën të dhënat se ai avion i vogël kishte ngatërruar aeroport nga shkaku i mjegullës, po fluturonte për në Napoli dhe u ul vetë në Rinas, kur aeroporti kishte nisur të ndërtohej nga të burgosurit politikë. U botuan dhe ç’kishte thënë piloti amerikan në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që e kishin trajtuar mirë duke i dhënë leje të ikte, por pa aeroplanin. E kam shkruar këtë histori dhe në burgologjinë time “Rrugët e ferrit”. Ndërsa në Vlorë është një copëz plazhi që u quajt “Zhiron” dhe ndoshta të rinjtë s’e dinë përse. Ndonjë dhe e shpjegon me fjalën e zakonshme shqipe “xhiro”, që do të thotë “vjen rrotull”, kur dhe xhiro është huazuar dhe vjen nga italishtja. Atëherë si gjimnazist ia kisha shtuar bibliotekës time edhe një libër tjetër të ndaluar, “Kitara kubane” dhe ia dhashë dhe shokut tim, Sherif Bali, ishte nja dy klasë më lart se unë në gjimnaz, shkruante lirika të mrekullueshme eseniniane, ishte ndër ata të paktët që i besonte vëllai im më

i madh, Ilirjani, prej tij dhe unë. Na pëlqeu aq shumë poeti kuban, mësuam poezi të tij përmendësh, ia thoshim njëri-tjetrit... Kërkoj sot të di më shumë për atë poet...

POETI I KITARËS KUBANE

Nicolás Cristóbal Guillén Batista, lindi më 10 korrik 1902 në Camagüey, Kubë dhe vdiq më 16 korrik 1989 në Havanë, atë vit kur do të shembej Muri i Berlinit dhe do të binte komunizmi në Europën Lindore. Rridhte nga një familje me prejardhje afrikano-evropiane, babai i tij ishte një gazetar liberal, u vra nga forcat qeveritare në 1917. Nicolás Guillen boton “Sóngoro Cosongo” (1931), “West Indies Ltd” (1934)... Në vitet ’30 (shekulli i kaluar) u arrestua si kundërshtar i regjimit të Gerardo Machado. U përjashtua gjatë regjimit të Batista-s në vitet ’50 dhe qëndroi në ekzil për disa vite në Amerikën Latine dhe Europë. U kthye pas revolucionit të 1959, u bë anëtar i Partisë Komuniste të Kubës dhe u rreshtua plotësisht përkrah Fidel Kastros. U emërua Poet Kombëtar i Kubës në 1961 dhe u bë president i Unionit Kombëtar të Shkrimtarëve dhe Artistëve të Kubës (UNEAC). Botoi më vonë “El gran zoo” (1967).

Nicolas Guillen do të bëhej figura kryesore e poezisë afro-kubaneze (poesía negra), duke kombinuar ritme muzikore nga “son” me onomatopoetikat dhe dialogun popullor për të përshkruar mënyrën e jetës së komunitetit... Mori mbështetje të madhe shtetërore, përfshirë botime, çmime dhe përfaqësime ndërkombëtare si poet dhe “zë i popullit revolucionar”. Është fitues i Çmimit Ndërkombëtar “Botev” (1976), Çmimit për Paqe Lenin/Stalin (1954), - mjerë paqja si Donja Maria e poezisë tij me këto emra çmimesh kështu, - them unë. Mori dhe Çmimin Kombëtar për Letërsinë e Kubës (1983), etj. Guillén simbolizon përzierjen kulturore kubaneze dhe luftën kundër racizmit dhe pabarazisë. Ai solli në letërsi klithmën, ritmet dhe narrativat e diasporës afrikane në Kubë. Veprat e tij vazhdojnë të studiohen dhe të përkthehen në më shumë se 20 gjuhë, etj, etj. * * *

Kur isha student në Shkodër, një herë me Profesorin tim, të urtin Vehbi Bala, ra fjala për Nicolas Guillen dhe ai më tregoi se kishte qenë bashkë me të në Rumani, në një festival poezie në Bukuresht. I kishin venë bashkë në një veturë dhe ai, Guillen-i, kishte nxjerrë makinën e shkrimit nga çanta, të vogël, dhe po i rrihte tastat shpejt e shpejt me gishtërinj, po shkruante direkt dhe bisedonte, një artikull për Vehbi Balën, që u botua në Kubën e tij, po më tregonte Profesori, një

fage gazete dhe titulli i shkrimit, mbaj mend që kishte dhe fjalën zemër. Si i kishin shkrimtarët makinat e shkrimit në Kubë, me autorizim si ata pak shkrimtarë që i kishin me leje në Shqipëri? Të regjistruara në Degën e Punëve të Brendshme se mos shtypnin gjëra të ndaluara, - larg qoftë, trakte e shpërndaheshin fshehurazi... se dhe kishte ndodhur...

A kishte dalë libri i tij shqip atëherë? A i tha Profesori Vehbi Bala poetit kuban Nicolas Guillen që e kishte përkthyer Petro Marko, një revolucionar, që kishte marrë pjesë dhe në Luftën Civile të Spanjës, që në çdo vend që kishte shkuar e çdo regjim e fuste në burg? Që herë pas here i ndaloheshin veprat në atdhe nga regjimi, më keq se në Kubë? E Guillen a i tha se ishin të zhgënjyer nga komunizmi apo kjo u ndodhte vetëm atyre që përndiqeshin prej tij? Jo, jo...

Çfarë, duhej pritur radha?

E KUBA?

Është ishulli më i madh në Karaibe, 110.860 km katrorë, - sa 4 herë Shqipëria jonë, - afër brigjeve të Floridës, mes Gjirit të Meksikës, që ka sugjerime të quhet Gjiri i Amerikës si një reagim kundër Meksikës për çështje të emigracionit gjatë Presidencës Trump.

Si një hardhucë të blertë, - e quan ishullin e Kubës poeti Guillen.

Ka 11.2 milionë banorë, - kaq a më shumë është diaspora shqiptare nëpër botë, - kryeqyteti është Havana. Rimon dhe me Tirana. Kuba ka ende regjim socialist një partiak me Partinë Komuniste në pushtet dhe kryetari i partisë është dhe presidenti i vendit. Zgjedhjet janë të kontrolluara dhe nuk lejohet parti tjetër si në Shqipërinë diktatoriale. Marrëdhëniet e Kubës me SHBA mbeten të tensionuara që nga revolucioni i 1959 me ligjin e embargos në fuqi, të përkeqësuara sërish me administratën Trump.

Mbay mend që në librin “Kitarra Kubana” nuk flitet mirë për SHBA e jankit.

Dhe në Kubë në vitet ’60 dhe ’70 u vendos një kontroll i rreptë mbi letërsinë dhe artet. “Brenda revolucionit - gjithçka; jashtë revolucionit - asgjë”, - tha Fidel Kastro gjatë atij fjalimit të famshëm “Palabras a los intelectuales” (“Fjala për intelektualët”) në 1961 përpara një grupi shkrimtarësh, artistësh në Bibliotekën Kombëtare. Si fjala e Enver Hoxhës në Pleniumin IV të PPSH për letërsinë dhe artin në Shqipëri (1973). Edhe në Kubë kushdo që shkruan, pikturon, kompozon duke menduar ndryshe nga ç’do partia, rrezikon të shpallet armik i popullit ose kontrarevolucionar. Deviatorët akuzohen si në Shqipëri për “dekadencë borgjeze” ose “influenca perëndimore” dhe merren masa kësisoj:

- Izolim shoqëror, përndjekje mediatike, ndalime udhëtimi. (Edhe Shqipëria i kishte...)

- Ndalim botimi, internim ose burg. (Si te ne...)

- Punë të detyruar në kampet e famshme UMAP: Unidades Militares de Ayuda a la Producción. (Në Shqipëri ishin shumë më të rënda burgu i Burrelit, Këneta e Maliqit, Tepelena, Grabiani, Spaçi, Qafë-Bari, etj.) Poeti Kombëtar, Nicolás Guillén, nuk ka pasur probleme me regjimin komunist kuban, përkundrazi, ai u la të bëhej një figurinë qendrore e kulturës zyrtare revolucionare. Kështu dhe në Shqipëri, se diktaturat ngjajnë, letërsitë e tyre jo dhe aq...

Ndërkaq kolegë të Nicolas Guillen si:

1. Poeti dhe eseist Heberto Padilla u arrestua në vitin 1971, pasi botoi librin Fuera del juego (“Jashtë lojës”) që kritikon sistemin. Shkaktoi një tronditje të madhe në botën letrare dhe u njoh ndërkomtarisht si rast. Shumë intelektualë të njohur botërorë, Jean-Paul Sartre, Mario Vargas Llosa, Susan Sontag, Octavio Paz, etj, protestuan kundër regjimit kuban.

2. Reinaldo Arenas (1943–1990), shkrimtar homoseksual, opozitar i regjimit, u persekutua për vite të tëra. U arrestua dhe u dënua me burg. Ai u arratis nga Kuba më 1980 gjatë eksodit të Marielit dhe botoi kujtimet e tij tronditëse Antes que anochezca (“Para se të bjerë nata”), dëshmi të censurës, represionit dhe homofobisë në Kubë.



3. Guillermo Cabrera Infante, një nga shkrimtarët më të njohur kubanë në mërgim. Fillimisht mbështeti revolucionin, por më pas u kthye kundër regjimit dhe jetoi në Londër për dekada, ku botoi vepra si “Tres Tristes Tigres”. Ishte i ndaluar në Kubë.

Me burgosje shkrimtarësh e pushkatime poetësh Shqipëria ia kalon jo vetëm Kubës, por... Sociologë e politologë ndajnë

a sueldo en la policía.

Ayer, taimado y sutil, rondando anduvo mi casa.

¡Pasa! - pensé al verle - ¡Pasa!* (Iba de traje civil.)

Señora tan respetada,

la pobre doña María,

con un hijo policía,



mendimin që në Shqipëri censura ishte më e rreptë dhe më sistematike nën Enver Hoxhën, ku edhe shkrimi i një poezie: “e dyshimtë”, mund të çonte menjëherë në 10 vite burg, etj, etj. Po le të kthehemi te ajo poezia e Nicolas Guillen, që çuditërisht u botua dhe në Shqipëri:

PËR NËNËN E BASHKËPUNËTORIT...

Dhe gjeta origjinalin “Doña María”:

¡Ay, pobre doña María, ella que no sabe nada! Su hijo, el de la piel manchada,

y ella que no sabe nada.

Vazhdon të më pëlqejë përkthimi i Petro Markos, ka muzikalitet, dëshpërim, imazh, pafajësi dhe keqardhje për nënën e atij që është bashkëpunëtor i policisë sekrete, spiunit dhe ka shtuar fjalët ‘gjarpër’ e ‘dhelpër’ për të, sigurisht është mllefi i tij për ata që e ndiqnin gjatë diktaturës, një denoncim artistik i atëhershëm, aq mundej dhe besoj dhe autori e ka tejkaluar atë poezi në vendin e tij si të ishte për kohën para revolucionit, gjatë regjimeve antipopullore. Ta ketë pasur me spiunët e Realizmit Socialist? Do t’më pëlqente, prandaj.... Po edhe atë

do ta kenë denoncuar kolegë, ndonjë nga shokët do t’i ketë çuar letër dhe Fidel Kastros... Do t’i kenë urryer dhe poezinë, tirazhin e librave... Por më intereson tani dhimbja për nënën e spiunin, Marien e gJORë që nuk di gjë, e ndjej dhe unë, një mëshirë e tillë ishte e ndaluar, natyrisht në kah të kundërt atëherë, se mund të mësonim kështu zbutjen e luftës së klasave, kur ajo ashpërsohej gjithnjë e më shumë, e kisha ndjerë fort mbi kurrrizin tim... Dhe u arrit kulmi dramatik, unë arrestohem për poezitë e mia, kur isha mësues në një fshat të Kukësit dhe në qeli më futën një provokator, të cilit i flisja për poezinë. Hetuesi më lemeristë netëve, më pyeste për shokë të mi poetë... kujtoja nënat e tyre... dhimbja dhe vuajtja po më shembnin... hetuesi ngulmonte mizorisht, ndër të tjera donte bashkëpunimin tim, se do të kisha lehtësira, do të dënohesha më pak... Dhe Hyji i poezisë sikur më tha që t’ia recitoja në qeli provokatorit tim H. H. “Donja Maria”-n e Nikola Gilenit, neverinë dhe urrejtjen time për spiunët...

Besoj poezia bëri kthesën. Se provokatori i raportoi hetuesit dhe ai do më thoshte pas ca ditësh: Ne kishim menduar një gjë të mirë për ty, por ti s’e meriton... dhe u la kjo çështje, të paktën për gjatë kohës së hetuesisë. E kam shkruar se siç thoshin ata që partizanët ia merrnin armët armikut dhe me to e luftonin atë, ne shpesh kemi qëndruar dhe jemi përpjekur t’u përgjigjemi duke përdorur dhe armët e tyre”, poezitë që ata botonin, ata libra që më pas edhe i ndalonin apo i grinin duke i bërë letër të bardhë sërish si harresa. Burgu do të kishte halle edhe më të mëdha e tmerre të tjera, po edhe pasburgu ende në diktaturë, përndjekjet, braktisjet, asnjë e drejtë, dhuna prapë, kërkesa për bashkëpunim me Sigurimin e Shtetit, se tani, sipas tyre, do të isha dobësuar më shumë, do të doja një punë që ta përballoja, jo gjithmonë punëtor krahu dhe do të ëndërroja të botoja poezi, por pa lejen e tyre s’bëhej dhe unë vazhdoja dhe refuzoja, jo, le të bëhej ç’të bëhej, qoftë dhe në burg prapë le të më çonin... dhe ajo “Donja Maria” – e gjora poezi... - më nxirrte para fytyrën e nënës, e të gjitha nënave...

Nëna është poezia që e ndryshon jetën!

* * *

Tani dhe Nicolas Guillen dhe Petro Marko janë në jetën tjetër. Ndoshta ndodh të takohen në kopshtet qiellore, shumë miq e shokë mund të jenë në Purgator e një pjesë në Ferr. Takohen si të mundin, flasin për poezinë, por dhe për komunizmin mbase, që ka rënë e s’ka rënë. Si është Kuba, është zbutur? Shkëlqen ende ylli Guillen? Shqipëria ka ndryshuar shumë së jashtmi, ata që bënë diktaturën, janë shndërruar në demokratë, po ndërtojmë kapitalizmin duke shembur të vjetrën, si ngrahina, po edhe të renë, po i doli para... Gjithsesi Petro Markon po e çmojmë më shumë. Fëmijët shqiptarë të “Donja Marieve” shqiptare? Janë më mirë seç ishin, janë pasuruar, merren me biznes, kanë shkuar jashtë shtetit, Romë, Paris, Londër, Vjenë, New York... bëjnë pushime buzë oqeanit në plazh dhe shohin me nostalgji nga ishulli që s’duket, Kuba, në fakt në ishullin politik që kanë brenda vetes së tyre. Dhe ndjeva dëshirën ta përkthej dhe unë tani poezinë e Guillen-it, “Donja Maria”, m’u gjend, më ndihmoi, të vazhdojmë bisedën:

ZONJA MARIA

(përkthim imi)

Ah, e urta zonja Marie, s’di gjë ajo, e vrerosur, I biri - lëkurë njollosur, u bë spiun policie.

Dje erdhi në shtëpinë time, Pa librat, ç’kisha shkruar. Shkofsh ku ke për të shkuar! (Ish veshur me rroba civile)

Grua shumë e respektuar, Por gjë s’di Zonja Marie, Të birin, agjent policie, Fshehtas e kanë dekoruar.

Nuk e pata dot mllefin brilant të Petro Markos, as kafshët që s’i ka origjinali i poezisë dhe shtova librat dhe një dekoratë. Përkthimi sipas kohës...

Profile

MARIE NOËL

Porosi e Marie Noël: Mësoni të lexoni poetët. Mos i lexoni si ‘gazetarë’. Në ta do të gjeni thelbin e fakteve, veprime që ushqejnë më shumë se një kureshtje. Duhet t’i lejoni t’ju ofrojnë shpirtin e tyre. Bukurinë pa emër dhe pa vend të Fjalës që këndon.

E lindur në një familje katolike praktikan-te, poetja franceze, Marie Noël, shfaqi një frymë fetare tepër të ndjeshme në moshë shumë të re, të prirur drejt kërkim-it të absolutes përmes krizave të vërteta mistike. “Poezia,- pohon ajo,- është një udhë e thellë, një emocion i fuqishëm që shpërfytyron, ora e hirit që kap asgjënë dhe e zgjeron atë në pafundësi.”

Shkrimtari Henry de Montherlan, në vitet 20’, tha për* të: “Për mua, Marie Noël është poetja jonë më e madhe franceze e gjallë. Krishterimi që e zotëron nuk i bën të mër-zitshme vargjet e saj. Disa nga poezitë e saj janë ndër më të bukurat shkruar ndonjëherë në gjuhën frënge.”

Ajo jetoi gati e vetmuar, duke mos u bashkuar kurrë me shoqërinë letrare të kohës së saj, duke iu përkushtuar veprave bamirëse për nevojtarët, letërkëmbimit me intelektualë të ndryshëm, shkrimit të “Shënimeve Intime”, një ditar në të cilin regjistronte meditimet e saj shpirtërore, por mbi të gjitha poezisë së saj. U nomi-nua për Çmimin Nobel në vitin 1960. Në pesëdhjetëvjetorin e vdekjes së saj, më 23 dhjetor 2017, Kongregacioni për Kauzat e Shenjtorëve të Kishës Katolike hapi pro-cesin e lumturimit si shërbëtore e Zotit.

“Shkrimi i saj, - shpjegon kritikja Co-



lette Nys Mazure, - kthehet te burimi i këngës mesjetare të devotshmërisë. Një jetë e përmbushur, por e thyer, e palid-hur si trotuari i çrregullt i Auxerre-s, mbi të cilin ajo ngutej që t’u shpinte ndihmë të përlurve, më pak fatlumëve, gjë që e bëri atë, të palodhurën, të pengohej. Jo e bukur, kurrë e dashur, por unike në sytë e Zotit, e adhuruara e Kantikut të Kan-tikëve. E privuar nga gjithçka, duke filluar nga koha për të shkruar. Familja e mbylli në zinxhirë detyrimesh, megjithatë ajo ia doli të mos zbutej, të krijonte një vepër që të emocionon.

Marie Noël

DITA E VOGËL

Do të doja të vdisja në një kopshtije, nën diellin e plotë të verës,

pa e ditur askush, si lulet... të cilat pak nga pak shpërbëhen dhe zhduken në erë pa qenë të detyruara të kthehem në terrin e tokës.

VDEKJA ME DUART E TRISHTA

Vdekja me duar të trishta mbërriti në Parajsë. “Ku po shkon, bija ime, kaq e zbehtë në mes të ditës?” Po kthehem në tokën ku kisha atdhe, në stinën e re ku kisha një mik. Ai më dha tri trëndafila por kurrë një kallëz. Para se lulja të çelë

para se gruri të piqet, menjëherë dje, më tradhtoi. Kështu që po vdes sot.

“Mos qaj, bija ime, koha ka mbaruar. Do të dërgojmë në tokë, në vendin tënd, një engjëll, për ta kapur mikun tënd tradhtar dhe për ta sjellë këtu.” Mos e bëj, at, lëre në tokë. Hijeshia e tij është më e bukur se vetë bukuria, lëre! Nëse qan natë e ditë pa mua, do më duhet të vdes edhe një herë: ai është shqetësuar shumë.

DY BOTË

Kur Zoti fryu mbi baltën time për të më dhënë shpirt, me siguri duhet të ketë fryrë shumë fort.

Nuk e mora kurrë veten nga kjo frymë e Zotit. Dhe nuk ndala kurrë së dridhuri si një qiri i luhatshëm midis dy botëve.

(Përgatiti dhe përktheu: Rielna PAJA)

Estetikë

E SHËMTUARA SI PASION

Ndërsa duket se e shëmtuara implikon një pasion, pikërisht neverinë, mospranimin; prandaj si mund të japim një gjykim estetik të së shëmtuarës, po nuk qe mundësia e shkëputjes

Zija VUKAJ

Përgjatë shekujve ka pasur shumë tek-ste mbi relativitetin e së shëmtuarës, si për të bukurën. Në shekullin XIII Giaco-mo da Vitry thoshte: “Me siguri ciklopët që kanë një sy çuditën me ata që kanë dy, siç i konsiderojmë ne të shëmtuar etiopi-anët e zinj, por mes tyre është më i ziu, ai që konsiderohet më i bukur.” Shekuj më vonë Volteri thoshte: “Pyeteni mashkullin e një thithlope çfarë është e bukura (...) Do t’ju përgjigjet se është femra e tij, me sytë e bukur të rrumbullakët që dalin nga koka e vogël, qafa e gjerë dhe e rrafshët, barku i verdhë, shpina e zeshkët. (...) Pyete-ni djallin: do t’ju thotë se e bukura është një palë brirë, katër putra me thonj dhe një bisht.” Për Darwinin duket se lëvizjet e ndryshme përshkruese si shprehje të përçmimit e të neverisë janë identike në pjesën më të madhe të botës: “Një neveri e lartë shprehet me lëvizje gojore të ng-jashme me ato që paraprijnë të vjellat.” Por shton se në Tokën e Zjarrtë “një indig-jen, duke çikur me gisht një copë mishi të ftohtë të konservuar që unë po e haja në fushim, shfaqi neverinë më të madhe tek ndjeu butësinë. Ndërsa unë nga ana ime ndjeja një neveri të fortë tek shihja se një i egër vinte duart mbi ushqimin tim, sado që nuk më dukeshin të pista.”

A ka shprehje universale për të bukurën? Jo, sepse e bukura është shkëputje, mung-esë pasioni. Përkundrazi, e shëmtuara është pasion. Të përpiqemi ta kuptojmë këtë pikë, për të cilën të tjerët kanë thënë se nuk mund të ketë gjykim estetik të së shëmtuarës. Pra, një gjykim estetik imp-likon një shkëputje: unë e gjykoj të bukur

një gjë, edhe nëse nuk e kam; i vë të hes-htin pasionet e mia. Ndërsa duket se e shëmtuara implikon një pasion, pikërisht neverinë, mospranimin; prandaj si mund të japim një gjykim estetik të së shëmtu-arës, po nuk qe mundësia e shkëputjes?

Me siguri ka një të shëmtuar të artit dhe një të shëmtuar të jetës. Ka një gjy-kim të shëmtisë si një gjegjëse ndaj ide-alit të së bukurës, si, për shembull, kur themi se vazoja e luleve që do të sho-him është e bukur. E dini kush e ka bërë? Hitleri, është një nga pikurat e rin-isë së Hitlerit. Ndërsa ka një reagim pa-sionant në vend të asaj që e konsid-erojmë të pakëndshme, shtytëse, të tmerrshme, të shpifur, groteske, të urreyer, të krupshme, të gërditshme, të frikshme, të ulët, të përbindshme, të hukubetshme, rrëqethëse, të fëlliqur, të hatashme, ter-rorizuese, drithëruese, shtypëse, të ankthshme, revoltuese, të pabukur, ma-jmuneske, shtazarake... (në fjalorin e si-nonimeve ka më shumë sinonime për të shëmtuarën sesa për të bukurën).

Megjithatë, kundër Platonit që porosiste të shmangej paraqitja e së shëmtuarës, nga Aristoteli e në çdo epokë, është pran-uar që edhe e shëmtuara e jetës mund të paraqitet në mënyrë të bukur dhe të bëjë të shpërthejë të bukurën apo të mbësht-esë një tezë morale. Dhe, siç thoshte shën Bonaventura, “imago diabolic est pul-chra, si bene rapraesentat foeditatem di-aboli”, domethënë, imazhi i djallit është i bukur nëse paraqitet bukur e shëmtuara.

Dhe prandaj arti ka dhënë më të mirën e tij në paraqitjen e të shëmtuarës së djallit. Por gara për të paraqitur mirë të shëmtu-



arën na bën të dyshojmë se në realitet ka qenë, edhe pse e nëndheshme, një kën-aqësi e vërtetë për të llahtarshmen, jo vetëm në vizione të ndryshme të fer-rit. Mos më thoni se disa ferre kanë qenë konceptuar vetëm për të tmerruar besim-tarët: janë konceptuar edhe për t’i bërë të gëzojnë si të marrë. Edhe disa “Triumfe të vdekjes”, me bukurinë e skeletit, ashtu si në filmin “Pasioni i Krishtit” i Mel Gibson: shihet pikërisht tmerri si burim pasioni. Nga ana tjetër, Shileri ka shkruar (“Mbi artin tragjik”, 1792),

“Është një fenomen i përgjithshëm i natyrës sonë që ajo e cila është e trishtë, e tmerrshme, deri e lemerishme na tërheq me një yshtje të parezistueshme dhe nga skenat e dhimbjes e të terrorit ndihemi të shtyrë me një forcë të madhe. Ne përtëri-jmë me lakmi përrallën më aventuroze të fantazmave dhe sa më shumë që na ngri-hen flokët përpjetë, aq më e madhe është lakmia. Është si një suitë e panumërt që shoqëron kriminelin në vendin e tor-turës”.

Sulejman Mato: NESËR DO TË VIJ

POETI BLERON NË TË KATËR STINËT

Autori nuk sforcohet me e rishpikë veten. S’ka nevojë, vetvetja s’ka ngrirë, ka ecur me kohën. Nuk përdor fjalë të mëdha, në “modë”

Mehmet ELEZI

Bëra një udhëtim nëpër poezitë e zgjedhura të Sulejman Matos “Nesër do të vij” (Ura, Prishtinë, 2024). Ende më fëshfërinin në shpirt lirikat vezulluese të përmbledhjes së tij “Nën diellin e jugut” (1969), kur kam qenë student. A do ta ketë ruajtur poeti të njëjtën dritë e njomështi? A do të jetë ftohur vargu bashkë me vitet që shkojnë, do të jetë bërë më pak spontan? Libri shpalohet si album akuarelesh për Dashurinë. Dashurinë për gruan, për nënën, për Shqipërinë në çdo skaj (përfshi Kosovën), për njeriun, për të renë, për... Dielli dhe deti i Jugut, malet e Veriut, yjet që pikojnë mbi ujëra, ullinjë, varret. Metaforat e tejdukshme, detajet zbritin si pikla vese. Autori nuk sforcohet me e rishpikë veten. S’ka nevojë, vetvetja s’ka ngrirë, ka ecur me kohën. Nuk përdor fjalë të mëdha, në “modë”. Nuk i përbalt metaforat, për me u shfaqë “modern”. Nuk i ftoh ato, për t’u dukur “cool”. S’ke punë me metaforat e mia, i thotë mendjes. Lerja shpirtit. Dhe ato rrjedhin nga poezia në poezi:

“Netëve të kam pritur në degët e shirave
Ti më gjuaje me bubullima!”
Papritmas niset. Për ku?
“Po shkoj te nëna. S’kam kohë, më pret
Përpara do të më nxjerrë një gotë rakie
Kam frikë se vonoj
Po sikur mos ta gjej?

Do ta kërkoj edhe në yje!”

Çon vetëm pak cepin e siparit të skenës. Aty ku qysh në ngjizje është luajtur drama e jetës sonë:
“Ne nuk patëm për ninulla

Nina-nana të çuditshme
Hyn e del në ëndrrat tona
Putra e ujkut, e përhime.”

Mes dritësimit paqëtues, një shkrepitimë epike. Qysh në titull, gati biblik: “Ymer Xhafua shkon pa kokë”!

“Era meku
Zogjtë ngrinë
Pikon gjaku pikë-pikë
Shpata maleve bën dritë!”

E ka përjetuar motivin migjenian të kangëve të pakëndueme. I dhemb gjithnjë, i ther.

“Fjalët që s’u thanë, kanë mbetur tek unë
Dhe ka shumë vitë që vetja më ngjan
me një varrezë plot zhurmë.”

Qysh më 1972, derdh në vargje një peng të madh, një mall pa fund. Pritmë Kosovë!

“Atje larg në veri
Herë në diellin që djeg
E herë nën rrufetë që shkrepitjnë
Është profili i hequr i Kosovës sime
Me dritaret e lëna ditë e natë nga era e Jugut.
Drejt saj nxitoj të arrij para kësaj kënge
Se më ka marrë malli për ty Kosovë



Për profilin tënd të hequr,
Për qytetet e tua, rrugët, fshatrat, malet,
Për burimet, bjeshkët, zjarret, stanet e tua,

Që nuk i kam parë kurrë...”


Libri përmbledh rreth 320 poezi. Disa dhjetëvjeçarë krijimtari. Krahës veprave të tjera në prozë: romane, përmbledhje me tregime, studime..., një listë e gjatë. Ka punuar pa pushim, modestisht. Pa

bubulluar nëpër ekrane, pa fryrë gjoksin nëpër takime. Ka ruajtur identitetin e vet artistik, duke e përpunuar natyrshëm nëpër vite, pa u sforcuar. Pa përpjekjen me e tjetërsue, që shpesh mund të çojë në prishjen e ADN-së artistike vetiake. Ai nuk është pemë që i bien gjethet në vjeshtë. Në librin e Sulejman Matos gjeta rishtazi lirikun e rinisë sime, me vargjet e dridhshme. Lirikun me metaforën e sinqertë, që bleron në të katër stinët.

Vështrim

ELEGJI MODERNE PËR SHPIRTIN SHQIPTAR

(Rreth librit poetik “Gdhendësi i pikëllimit” të Shkëlzen Halimit, botoi Armagedoni, Prishtinë, 2023)



Nga Mexhid MEHMETI

Në një kohë kur fjala poetike rrezikon të humbë në zhurmën e botës, poezia e Shkëlzen Halimit vjen si një lutje e qetë, e brendshme, një zë që gdhend në heshtje fytyrën e një dhimbjeje të përbashkët, të trashëguar, por edhe të rizbuluar në vetminë e epokës sonë. Libri me poezi «Gdhendësi i pikëllimit», është një testament poetik ku ndjeshmëria, përsiatja ekzistenciale dhe shqetësimi historik bëhen njësh në strukturën e një poezie të pjekur, të përmbajtur, por thellësisht tronditëse.

Nga poema e parë e deri në fundin monumental të vargjeve për Çamërinë, përmes metaforash që përngjajnë me gdhendje të dhimbjes në murin e kohës, Halimi përkshkruan një univers të brishtë, të trazuar nga vetmia, humbja, kujtesa e përvuajtur dhe dashuria e pamundur. Kjo nuk është thjesht poezia e pikëllimit – kjo është poezia e gdhendjes së pikëllimit, në kuptimin literal dhe metafizik: poeti përpunon dhimbjen, e punon si skulptor në një gur të padukshëm të shpirtit. Në poezitë si “Stacioni i ndarjeve”, “Ferr i Dantës”, “Sizifi”, “Dalja nga pikëllimi”,

“Ngjallje”, “Porta e dhimbjes”, autori risjell mitin, tekstin biblik, historinë personale dhe kolektive, duke i thurur në një poezi të qetë, por të mprehtë si thikë. Shpesh e dashura – figura femërore – është më shumë simbolikë sesa realitet: ajo është kujtesë, mungesë, atdhe, jetë, vdekje, vetë poezia. Vargjet e Shkëlzen Halimit janë të kontrolluara, pa shpërthime emocionale të panevojshme, por me një thellësi që të bën të ndalesh pas çdo strofe. Ai është mjeshhtë i një fjalori të zgjedhur, të qartë, pa ekzagjerime stilistike, por që arrin të krijojë një klimë të dendur emocionale. Figura si “më prit me kujtimin e fundit që u bë portret stacioni” ose “kam frikë nga kjo botë e panjohur, më mirë i kthehem errësirës dhe grimit” janë shprehje të një gjuhe që përfton bukuri nga thjeshtësia dhe trishtimi. Poeti përdor shumë simbole: stacioni, porta, valixhja, qiriu, xhami, arkën e kujtimeve, fanarin pa dritë – të gjitha bartin peshën e një bote në shpërbërje, një shoqërie që po e braktis kujtesën, ndërsa subjekti lirik përpigjet të ruajë esencën e shpirtit njerëzor në një botë të zhurmshme dhe të harresës. Libri është i ndarë në cikle të qarta tematike (siç del edhe nga ndarja e brendshme), ku motivet e ndarjes, vdekjes, mallit, atdheut, dashurisë së largët dhe luftës për identitet ndërthuren në një simfoni meditative. Poezitë si “Ikja nga trupi i vdekur”, “Përbindëshi”, “Largësitë”, “Thika” dhe

më së fundi, e përmbyllura madhështore “Pikëllimi për hënën mbi Çamëri” janë kulme të përpunimit tematik dhe stilistik të autorit. Pikëllimi i Çamërisë, në veçanti, rrok jo vetëm një tragjedi kombëtare, por edhe mënyrën si harresa zë vend në historinë e individit dhe kolektivitetit. Ai përdor simbolin e hënës mbi Çamëri si një metaforë universale për atdheun e lënë në harresë, për të cilin poetët duhet të qajnë me heshtjen që zë vendin e këngës së ndaluar. Shkëlzen Halimi është pjesë e atij brezi poetësh që nuk bërtasin, por lëvizin themele me heshtje. Ai i përket një poetike të reflektimit, të qartësisë së dhembjes, të kujtesës që nuk lejon mbyllje, të përjetimit si akt estetik dhe etik njëkohësisht. Në poezinë e tij nuk ka vend për patetizëm apo teatralitet të zbrazët – çdo metaforë është e nevojshme, çdo poezi është një kapitull në romanin e heshtur të jetës shqiptare bashkëkohore. “Gdhendësi i pikëllimit” është më shumë se një përmbledhje poetike – është një testament shpirtëror i njeriut që jeton midis kujtimit dhe harresës, midis dashurisë dhe dhimbjes, midis atdheut dhe vetmisë. Është një libër që të fton të ndalesh, të lexosh ngadalë, dhe të përjetosh përmes tij atë që ndoshta nuk mund ta thuash dot me zë. Kjo është një poezi që nuk kalon, por mбетet – si një qiri i ndezur në portën e kujtesës.

Fushë Kosovë. 2025

Qasje

LIBËR QË FLET PËRSHPIRTSHËM

“Fundi i historisë së një dashurie” i Graham Green, nuk është vetëm një histori për tradhtinë bashkëshortore – është një rrëfim, një lutje, një autopsi e ngadaltë e besimit, dëshirës, obsesionit dhe humbjes

Kamran ABBAS

Ajo nuk fliste shpesh për të, por hidhërimi e rrethonte si parfum - i zbehtë, këmbëngulës, i ngjitur. Ai nuk ishte i vdekur. Thjesht... i zhdukur. Lidhja mbaroi vite më parë. E megjithatë, edhe pasi rindërtoi jetën e saj - shtëpi e re, zakone të reja, heshtje e re - ajo ndonjëherë shikonte nga dritarja me një vështrim që thoshte: “Ende e ndiej atë në dhomë.” Kur i dhashë këtë libër, ajo e lexoi ngadalë, pothuajse sikur i dhembte. Dhe kur mbaroi, tha vetëm një gjë: “Ai e kuptoi.”

Graham Green nuk shkruan për dashurinë siç bëjnë shumica e autorëve. Ai shkruan për rrënimin e saj. Pasojat e saj.

“Fundi i historisë së një dashurie”, nuk është vetëm një histori për tradhtinë bashkëshortore - është një rrëfim, një lutje, një autopsi e ngadaltë e besimit, dëshirës, obsesionit dhe humbjes. Janë shtatë mësimë që na ofron ky libër.

1. Dashuria nuk mbaron kurrë - ajo thjesht ndryshon formë: Kur mbaron lidhja, Maurice nuk mbetet gjë tjetër veçse kujtime. Por dhimbja mbetet. Ashtu edhe obsesioni. Ky libër shkatërron mitin se dashuria zhduket kur personi zhduket. Ajo mbetet në zakonet e vjetra, në letra, në hijet e ditëve të zakonshme. “Nuk ndalesh së dashuruari dikë vetëm sepse nuk mund ta kesh.”

2. Xhelozia nuk do të thotë posedim - do të thotë prani: Xhelozia e Maurice është mbytëse. Ai dëshiron që Sara t'i përkasë atij, madje edhe në kujtime. Por ajo që Green kap me kaq dhimbje është se xhelozia, në formën e saj më të papërpunuar, nuk ka të bëjë me kontrollin. Ka të bëjë me mungesën. Për të parë dikë që e doni të ju rrëshqet nga gishtat dhe për t'u përpjekur ta mbani atë në çdo mënyrë që mundeni - edhe nëse ju shkatërron.

3. Besimi është dashuri e maskuar: Transformimi shpirtëror i Sarës ndihet i papritur, i çuditshëm - pothuajse çmendës. Por poshtë udhëtimit të saj fshihet një dashuri e thellë dhe e dhimbshme. Për Zotin. Për Maurice. Për një jetë që do të thotë diçka më shumë. Green ndërthur teologjinë dhe pikëllimin aq delikat sa na bën të kuptojmë diçka: ndonjëherë hyjnorja hyn në jetën tonë jo me dritë, por me humbje.

4. Mund të humbasësh dikë ndërsa është ende pranë teje: Lidhja e dashurisë (dashuria) mund të jetë “fundi” në titull, por ajo që e përndjek librin është se si dashuria vdes në heshtje, shumë kohë para se njerëzit të largohen. Maurice dhe Sara kalojnë pjesën më të madhe të kohës së tyre së bashku duke mos e kuptuar njëri-tjetrin. Duke folur për njëri-tjetrin. Versione të dashura të njëri-tjetrit që mund të mos kenë ekzistuar kurrë. Ai erozion i ngadaltë? Ky është pikëllimi i



vërtetë.

5. Sekretet na mbrojnë - dhe na shkatërrojnë: Kaq shumë gjëra të pathëna në këtë roman. Kaq shumë rrëfime të vonuara, të vërteta të shtrembëruara, letra të djegura. E megjithatë Green tregon se gjërat që i mbajmë të fshehura - nga turpi, frika, ose dashuria e gabuar - janë shpesh gjërat që acarohen. “Do të doja t'i kisha thënë të vërtetën para se të

ishte tepër vonë.”

6. Hidhërimi mund të bëhet përkushtim: Ajo që bën Maurice me dhimbjen e tij - mënyra se si ai piketon, rrëfen, fikson - është një lloj adhurimi. I Sarës. I historisë së tyre. I vuajtjes me të cilën ajo e la. Hidhërimi, në duart e Green, bëhet i shenjtë. Është altari mbi të cilin dashuria vazhdon të digjet, shumë kohë pasi duhej të ishte shuar.

7. Të duash plotësisht do të thotë të dorëzohesh: Ky është mësimi më i vështirë. Më njerëzor. Green nuk ofron shpengim të lehtë ose falje të pastër. Në vend të kësaj, ai ofron dorëzim: ndaj dashurisë, ndaj humbjes, ndaj të panjohurës. Të duash dikë plotësisht, ndonjëherë, do të thotë ta lësh të shkojë.

“Fundi i historisë së një dashurie”, realisht nuk është një histori dashurie. Është një histori hidhërimi e maskuar si e tillë. Është lloji i librit që lexon kur ende mban dikë në gjoks që nuk të përket më. Green nuk premton shërim - vetëm ndershmëri. Vetëm të vërtetën e papërpunuar dhe të dhimbshme se ndonjëherë dashuria na thyen... dhe prapëseprapë, ne do ta zgjidhnim përsëri. Nëse keni dashur ndonjëherë dikë që ju është dashur ta humbisni - ose nëse ende po përpiqeni të bëni paqe me heshtjen që lë pas - ky libër do t'ju flasë përsëritshëm. Jo me ngushëllim. Por me mirëkuptim.

(Solli në shqip: Fitim Nuhui)

Shënime letrare

BARDHYL XHAMA DHE ROMANI "EKSPEDITA E KALTËR"

Duke iu rikthyer biografisë artistike të shkrimtarit Bardhyl Xhama, mendojmë që kontributet dhe arritjet e tij letrare shpërfaqen veçanërisht në dy rrafshë: në zhanrin fantastiko-shkencor e në zhanrin e rrëfenjës

Xhahid BUSHATI

Bardhyl Xhama u lind më 13 qershor të vitit 1933, në fshatin Pterrë të rrethit të Sarandës. Ndërroi jetë më 11 dhjetor të vitit 2022 në Tiranë. Botimet letrare të autorit, shumica të nderuara me çmime në konkurset kombëtare, janë këto: “Përrallat e detit”, përralla, 1975; “Zhytësit e vegjël të thellësive”, novelë, 1977; “Ekspedita e kaltër”, roman fantastiko-shkencor, 1980; “Zjarrëfiksi i pyllit”, përralla, 1987; “Tërfili me katër

fletë”, novelë e përralla, 1989; ribotim, 1999; “Pse qau delfini?”, 50 rrëfenja, 1996; “Në kthetrat e piratit”, roman, 1997; “Lejleku me akullore”, 20 përralla, 1998; “Djaloshi që kapte rrufetë”, 60 rrëfenja, 2000; “Djali me tre brirë, përralla, 2002; “Tre vëllezërit”, novelë, 2003; “Arratisje nga kafazi”, përralla e rrëfenja, 2007; “Pëllumbi me fjongo të kuqe”, 60 rrëfenja për fëmijë e prindër, 2007, “Shtëpia pa libra si trupi pa shpirt”, 32 rrëfenja, 2012, etj.

Duke iu rikthyer biografisë artistike të

shkrimtarit Bardhyl Xhama, mendojmë që kontributet dhe arritjet e tij letrare shpërfaqen veçanërisht në dy rrafshë: në zhanrin fantastiko-shkencor e në zhanrin e rrëfenjës. Le t'i themi dhe ca fjalë për zhanrin e parë, më shumë në aspektin e këtij zhanri duke parë prirjet e lëvrimit të krijuesve drejt kësaj letërsie. Me të drejtë studiuesi Astrit Bishqemi, duke marrë si bazë përmbajtjen e krijimit artistiko-shkencor, qëllimet e tij, shkallën e fantazisë, etj., bën dy ndarje të këtij zhanri: a) degëzimi njohës-shkencor dhe b) degëzimi fantastiko-shkencor. Duke qenë njohës i krijimtarisë së Bardhyl Xhamës, vërej se, dukuria e tij më e shumtë është drejt degëzimit të parë. E dyta zë më pak hapësirë. Assesi nuk është mangësi; kjo është e lidhur me parapëlqimet vetjake të shkrimtarit, me komunikimin artistiko-shkencor të tij me lexuesit e vegjël.

Në vitet '80, shkrimtari Bardhyl Xhama boton veprën “Ekspedita e kaltër”. Një roman fantastiko-shkencor. Nuk ishte rastësi dhe as e papritur. “Shenjat” e para autori i kishte dhënë që me novelën “Zhytësit e vegjël të thellësive”. Romani “Ekspedita e kaltër” (lëvron për herë të parë këtë gjini) plotëson më tej portretin shkrimtarit dhe është një mbarësi për të në sprovën e tij në këtë gjini të rëndësishme. Duke qenë një zhanër të ri në fushën e letërsisë për fëmijë dhe të rinj, dhe për vetë letërsinë ishte një zhvillim i ri, romani “Ekspedita e kaltër” theu disa tabu e klishe që mbartte politizimi i asaj kohe në lidhje me problematikat

që trajtonte. Autori i shmangu me mjeshtëri. Vepra fitoi vlera se autori e njihte mirë detin dhe botën nënujore. Ajo, (“Ekspedita e kaltër” – nënvizimi im Xh. B.) kërkesat e artit i shkriu natyrshëm me informacionin shkencor. Subjekti është interesant e tërheqës, ku veprojnë një numër personazhesh të realizuar artistikisht dhe bartës konfliktesh të shumëllojshme. Aso kohe vepra solli kërshëri e interes tek lexuesit e vegjël. Romani përmendet jo vetëm si arritje e autorit, por edhe si arritje e vetë zhanrit në letërsinë shqipe për fëmijë. Duke mos harruar se, është koha, kur ky zhanër ka një rrugë e përvojë modeste, endet përmes një kohe të politizuar e disa veprave tejet të politizuara e skematike, siç e përmenda më lart. Me këtë vepër dhe me guximin e tij krijues, shkrimtari Bardhyl Xhama çel një udhë të re shikimi në zbulimin e mistereve të detit, sjellë informacion të ri e të panjohur shkencor (të botës nënujore); njëkohësisht plotëson dhe zgjeron më tej larminë në individualitetet krijuese që merren me këtë zhanër, por duke ruajtur gjithnjë veçantitë e profilin të tij.

Rikujtojmë se, në këtë zhanër, kontributi i shkrimtarëve Flamur Topi, Alqi Kristo, Astrit Bishqemi, Ali Eltari, Niko Deda, Thanas Qerama, Bedri Dedja, Konstandin Leka, Arion Hysenbegasi Thani Naqo etj, është i rëndësishëm. I jep jetë, zhvillim dhe arritje. Lë shenjë dhe vlera të vërteta. Përvoja dhe ndihmesa e tyre (e bashkëngjitur me fantastiken dhe artistiken) është e dukshme dhe përcaktuese në njohje të mëtejshme në

disa fusha të ndryshme të shkencës, ku ata, krahas problematikave e tematikave të trajtuara paraqesin edhe profilet e tyre si krijues.

“Ekspedita e kaltër” vjen me një tematike të veçantë, jo e përsëritur nga autorë të tjerë. Ngjarjet vendosen dhe zhvillohen në një të ardhme. Ka një përcaktueshmëri viti dhe kohe. Është fjala për një marrëdhënie të kësaj date me autorin, edhe pse me largësi kohe, autori sikur vë veten në provë në realizimin e “ëndrrave” të tij, për atë çfarë dëshmon në këtë roman. Ka meritën, siç thotë shkrimtari Thanas Qerama, se “... arrin t’i mbajë në një lidhje të shëndoshë ngjarjet e së ardhmes me ato të sotme, me traditën

në përgjithësi, duke nënvizuar idenë se e ardhmja do të jetë vazhdim i të sotmes.” Ngjarjet e kësaj vepre lidhen me një grup fëmijësh, të cilët udhëhiqen nga inxhinier Gëzim Shkëmbi, profesor i shkencave hidrtaulike. Realja dhe fanta-shkenca janë në funksion të ndërtimit të maketit të hidrocentralit. Dhe për të realizuar këtë maket nis udhëtimi-studimor i quajtur “Ekspedita e kaltër”.

Dukuritë e ndryshme shkencore që përshkruhen në raport me detin kanë një lidhje jo të zakonhtë me autorin. Kjo është e lidhur edhe me një veçori i cila e cila zë vend dukshëm në autobiografinë e tij: “Hobi i tij i veçantë, që e ka shoqëruar tërë jetën, ka qenë peshkimi dhe noti.

Ai është zhytur në thellësinë e shumë deteve të kontinenteve të botës. Kjo i ka dhuruar atij mundësi e ndjesi për të njohur të fshehtat e detit, të cilat i ka sintetizuar në shumë vepra të tij artistike për detin, aq sa kritika letrare, Bardhylin e ka quajtur “Shkrimtari i detit”. Deti për të i ngjan një dielli, që nuk njih perëndim. Janë të shtrenjta dhe Fterra, vendlindjen e shtrenjtë të autorit dhe Sarandën e tij të dashur janë emblema e kësaj dashurie. Simbolika e detit, ku më shumë e ku më pak është e pranishme në gjithë krijimtarinë e tij, sepse është pjesë e identitetit të tij, është vetvetja, ku i shëtit shpirti dhe i rreh zemra. Deti për autorin është metaforë fëmijërie,

Në vend të debatit

NARCIZMI DHE METAMORFOZA E KAFKËS

“Metamorfoza” e Kafkës nuk është aspak sulm ndaj babait e familjes, por një ulërimë e fuqishme letrare, në vend të ulërimës së pamundur me zë të një fëmije të abuzuar nga babai

Antela VOULIS

Që të kuptojmë novelën “Metamorfoza” të Franc Kafkës, duhet të kuptojmë çfarë është narcizmi. Narcizmi është çrregullim i personalitetit të njerëzve që besojnë se janë më të mirë dhe më të rëndësishëm se të gjithë. Duke besuar kështu për veten, narcisët gjithmonë gënjejnë, manipulojnë, krijojnë situata të pakëndshme, të vështira, madje të rrezikshme, për të përfituar dhe për t’i dëmtuar pa mëshirë pretë e tyre, empatikët. Abuzimi narcisist është një nga llojet më të këqija të abuzimit psikologjik, sepse narcisi abuzon dhe luan viktimën duke e portretizuar veten sikur ai është i abuzuari. Narcisët jo vetëm që mund të mos arrijnë të kuptojnë ndikimin emocional të veprimeve të tyre tek të tjerët, por gjithashtu mund të jenë indiferentë apo edhe të argëtohen nga vuajtjet që u shkaktojnë të tjerëve. Narcisët abuzojnë dhe e akuzojnë viktimën se ishte ai që i abuzoi ata, e shpallin gënjeshtar viktimën, fajtor madje edhe të çmendur. Mungesa e ndjeshmërisë i bën ata që të sajojnë gjithçka që mundin, për t’i manipuluar, për t’i shfrytëzuar dhe për t’i lënduar të tjerët pa peshën e ndërgjegjes. Ky tipar është veçanërisht shkatërrues në marrëdhëniet e ngushta, ku besimi dhe mirëkuptimi i ndërsjellë janë thelbësorë për një lidhje të shëndetshme.

Por, nëse narcisët që i hasim jashtë territorit tonë të ngushtë, pra jashtë familjes, mund t’i shmangim, duke mos u folur, duke mos u shoqëruar me ta, është shumë e vështirë që të bëjmë të njëjtën gjë me narcisët në familje, pra me prindërit, motrat e vëllezërit, sepse komunikimi e bashkëjetesa me ta shpesh janë të pashmangshme. E, nëse bashkëjetesa me prindër që na duan pa kushte dhe komunikimi me ta është diçka e bukur dhe e dëshirueshme për çdo fëmijë, nuk ndodh e njëjta gjë me bashkëjetesën me prindërit narcisë, sepse prindërit narcisë nuk i duan fëmijët e tyre. Narcisët i shohin fëmijët si mjete për t’i përdorur për qëllimet e tyre. Fëmijët e rritur nga prindër narcisë rriten me ndjenjën e pamjaftueshmërisë, të mosvlerësimit të vetes, se nuk do të jenë në gjendje t’i kënaqin kurrë prindërit. Prindërit narcisë u japin përparësi nevojave të veta dhe kërkojnë admirim nga fëmijët. Prindërit narcisë përdorin taktika manipulimi, kontrolli dhe fajësimi, duke pushtuar privatësinë dhe autonominë e fëmijëve. Prindërimi narcizist ndikon negativisht në zhvillimin psikologjik të fëmijëve, duke ndikuar në arsyetimin, sjelljet e qëndrimet e tyre emocionale, etike dhe shoqërore. Fëmijët e keqtrajtuar nga prindërit narcisë shpesh dështojnë në krijimin e marrëdhënieve të shëndetshme shoqërore, duke përfunduar të vetizolu



nga të gjithë.

Në një mjedis të tillë narcistik ka të ngjarë që ka lindur dhe është rritur edhe Franz Kafka, ky shkrimtar i shumë diskutuar për identitetin e tij në letërsi, i shumë diskutuar sidomos për novelën “Metamorfoza”, të quajtur shpesh edhe si një sulm ndaj babait e familjes së vet. Është e habitshme, se edhe pse në novelë duket qartë sjellja abuzuese e babait dhe e familjarëve të tjerë me Gregorin (Kafkën), ka ende prej atyre që e mbrojnë këtë baba e këtë familje, duke e quajtur anormal apo të tepërt reagimin e Kafkës ndaj saj. Pra, justifikohet dhuna prindërore me argumentin se familja është e shenjtë, e sido që të jetë e çfarëdo që të bëjë nuk duhet sulmuar, siç ka bërë Kafka te “Metamorfoza”. Si viktimë i një babai narcis, Kafka ka qenë në vuajtje të vazhdueshme shpirtërore tërë jetën. Duke e dyshuar veten, ka qenë në konfuzion dhe i pasigurt në ndërveprimet me prindërit dhe me të tjerët.

metaforë ëndrre, metaforë dashurie, metaforë e kthimit në vendlindje. Kjo metaforë me emrin det, që në faqet e romanit na paraqitet si një mrekulli më vete, mbart një anije, ku fëmijët hipur mbi të ndërmarrin një udhëtim studimor. Mendoj që shkrimet kritike që janë marrë me analizën e kësaj vepre, në këtë rrafsh duhej ta përqendronin optikën e vështrimit studimor dhe vlerësues, si një vepër që edhe sot nuk e ka humbur aktualitetin. Ripunimi i herë pas hershëm që autori i ka bërë veprës së tij, ka eliminuar edhe disa disproporcione që janë vënë re në ndërtimin kompozicional të romanit.

qëllimshëm sillen mirë me viktimat, duke i bërë konfuzë e duke u dhënë shpresë të rreme se mund të ndryshojnë. Kjo sjellje e mirë momentale, e përkohshme, është pjesë e manipulimit narcisist, me qëllim mbajtjen pre të viktimës për një kohë sa më të gjatë, që është e pafuqishme për të vendosur kufij apo për t’u larguar përfundimisht nga familja. Madje, jo rrallë, viktimat e abuzimit narcist kanë edhe mendime vetëvrasëse, ashtu si edhe Kafka.

Nën efektet e rënda të abuzimit narcistik atëror, Kafka ishte i pafuqishëm që të hakmerrej ndaj tij. Kjo pamundësi për hakmarrje ndodh, sepse edhe pse prindërit janë abuzuesit, ata janë njëkohësisht njerëzit e tij më të afërt e më rëndësishëm në jetë, ata që duhet ta donin më shumë se kushdo, që duhet ta mbronin, por që realisht e keqtrajtuau derisa e hodhën si të pavlerë. Si çdo i abuzuar nga prindër narcisë, Kafka e urren babain e vet dhe njëkohësisht e do atë. E urren abuzuesin-baba, por e do babain që do donte të ishte në vend të abuzuesit. Por, duke qenë se imazhi i babait abuzues me imazhin e babait të dashur e të mirë të ëndërruar prej Kafkës janë dy persona të ndryshëm në trupin e një personi të vetëm, ngaqë ai është e vetmja referencë atërore që ka Kafka, vuajtja vazhdon pafundësisht, e viktima lufton tërë jetën me mendimet e ndjesitë e veta, me pamundësinë e vetëmbrojtjes, me pamundësinë e ngritjes së zërit, derisa një ditë vendos që ta bëjë këtë me anë të një krijimi letrar.

“Metamorfoza” është drama personale e Kafkës, është hakmarrja e birit ndaj babait që nuk e do si dhe ndaj familjes, që e braktis kur ai nuk është më i dobishëm për të. Kjo hakmarrje letrare është hakmarrja më fuqishme e shkrimtarit të ndjeshëm dhe empatik. Kjo hakmarrje nuk është aspak sulm, por është ulërima nga abisi e një të fëmije të abuzuar. Ulërimë e shkruar për t’u dëgjuar nga të gjithë edhe pas vdekjes së shkrimtarit. Metamorfoza e Gregorit, pra metamorfoza e jashtme dhe e dukshme, transformimi nga njeri në insekt, në një krijesë të dobët, të përçmuar, të neveritshme, të lehtë për t’u shfrytëzuar, është në të vërtetë transformimi i brendshëm dhe i tmerrshëm që ndien një fëmijë i abuzuar sistematikisht nga një prind narcis. Ky është edhe misioni i prindërve të tillë, tjetërsimi i fëmijës viktimë, nënshtrimi, të bërit të ndjehet i paqartë për identitetin e vet, të ndjehet i pavlerë, konfuz, i dyzuar, i ndrydhur, i dobët, i padobishëm, të ndjehet keq për veten, të transformohet. Kjo metamorfozë i ka ndodhur vetë Kafkës përgjatë viteve të abuzimit nga babai dhe më pas ai e ka përdorur si simbol në krijimin letrar.

Poezi: Getniana MINGA

KOHËT QË JANË

Linda me yllin e verdhë mbi gjoks
e prita rradhën për të vdekur.

Ashtu siç e kishin ujdísur ata:
në të gjitha format që njeriu rrek të vrasë tjetrin.

Nëna më lindi në Siri e isha kurde. Azia ma vuri emrin.
Rashë duke luftuar në Manbij, në jug të Eufratit.

Mund te kisha lindur edhe në Montmorency,
në Parisin e ndaluar,

ku pemet nuk shëmben kurrë, nuk vdesin,
ku jashtë të ndaluara janë grillatat.
Dy roje kontrollojnë daljet e hyrjet.

Por linda në Palestinë e ndërrova jetë.
Mijëra herë kam vdekur

në vende të ndryshme rtë shkreta.
Se isha komuniste.

Se nuk isha komuniste.

Se kisha kurajë e kalova shkretëtirën e Sabbas e të Kufras
e i lashë t'më përdhunonin.

Se kisha kurajë e i prita në fshat, në vatrën time,
e më therrën.

Në fakt, askush s'mund ta njohë fatin
e atij që u bashkohet farave të zjarrit
e farave me flatra, e lundërtareve,
se prej lëndinash paanë e detrash,
prej ishujsh e kontinentesh,
asgjë e askush nuk mund ta dijë vërtet
në ka qënë dikur
gjithcka që lindi
e gjithcka që vdiq.

OGURI

Unë nuk besoj që kemi dështuar.

Ka nga ata

që janë më keq se ne.

Të lutem mos u ligështoj aq fort

sa të mos e shohësh

luleborën kur të lulëzojë.

Unë besoj se zemra jonë

është më mirë t'i ngajë

zemrës së mirë të qenit,

syrit të tij të mprehtë kur kërkon shtigjet,

se herë herë

diçka e gjen vëndin e vet pranë diçkaje tjetër,

e njerëzit rrënohen, e njerëzit shuhen,

e prapë jetojnë diku.

Ti je këtu.

Me kujtimet për botën që të lëdojnë.

Por ti je këtu,

ku diçka ta kuron plagën,

t'i heq koret e ditës së vjetër,

të mëson si t'i pastrosh skuthat

e teshat e shpirtit

që të të shkojnë për shtat

në të gjitha botërat.

AH LEEN, VOGËLUSHJA LEEN

Po që s'po mundem ta kapërdij
këtë çapë bukë?

Se mendoj Leenën, Leenën mushkonjë,
nën tendat e Khan Yunis-it

me doçkat që përgatisin pite
atë gojën e uritur që vezullon

kur këndon:

Let's cook cook cook!

Do ketë edhe ajo dikë

që shkon Atje

për pak miell e thjerrëza.

Dikë që e di se mund ta qëllojnë,

se mund të kthehet kufomë.

Dy prej tyre lart do t'ia ngrejnë trupin,
me celofan të bardhë.

Të tjerët do t'i shkojnë pas të rraskapitur.

Koka mund t'i anohet,

krahët mund t'i rrëshqasin jashtë

Mund të jetë një nga djaloshët më të fortë

të fisit,

nga ata që ecin gjatë,

që e dinë

se mund të kthehen kufoma.

Se trupin mund t'ia lënë plandosur

mbi rërë,

E mund t'i shqyejnë

qenë endacakë të uritur,

skeletra të dëshpëruar si ata.

Po që s'po mundem ta kapërdij

këtë çapë bukë?

E të këndoje edhe unë:

Let's eat eat eat!

MIKJA E VETES

Sot e kam zemrën si mjalti.

E di që në këtë orë të flashkët

dikush rri i humbur e i butë.

Dikush rri si pudër sheqeri

mbi torta të vakëta shtëpie,

si pupla mbi pllaka të lyrshme.

Është përhumbja e nurit të thjeshtë,

që i dorëzohet fatit,

që e ka gjumin endacak,

e krahët e lodhur,

ndonëse duart i kanë të fuqishme

si luani.

Ashtu isha e jam edhe unë.

Por sot kam diellin në pëllëmbë

si mandarinë. Rrezet si thakë

që më nxehin gishtat,

e po shoh një plak si llullë që shëtit në lëndinë.

Sot i jam mike vetes.

Si mjalt e kam zemrën,

si korbi gazmor kam hare në sy,

si korbi që kthehet në pranverë e ndalon

mbi të njëjtën shtyllë të qytetit

ende të huaj,

e prej andej vëren lumin

ende të huaj

e këndon,

ndonëse nuk di të këndoje

si bilbil.



Tregime/Zejnullah RRAHMANI

PREMTIMI

Namani u shtri me fjetë. Na duelëm përjashta. Zhurma u peshat. Përjashta ishte ftohtë. Sekush gjeti me shkue diku, ose ndonji punë ashtu sa me u marrë me diçka e me u ngrohë. Unë u ula në rreze. Nana erdh menjherë mbas meje. Ajo i rrotulloi një copë here panto-l lonat e Namanit dhe filloi sikur me i qepë me kujdes të madh. Derisa punonte rrinte pak e ngrysur gjithmonë. Punonte sikur mos

me qenë unë askund. Mbas një copë here mezi e ktheu pak kokën derisa po ulesha pak ma larg se dora e saj me gjilpanë mbërrinte deri te unë. Diçka i dridheshin duert, disa herë e shqepi atë që e kish qepë njëherë tashmë! Ma në fund, si i kreu, i la pantollonat përmbi gju, shmoi njëherë e më pyeti: - Kur të rritesh, a do të na japësh të holla? Me folë drejt e pa hile, nuk mujsha me

e marrë me mend ku kam me i marrë të hollat kur të rritesha. Baba, a nuk asht ai i rritun dhe prap nuk merr të holla kurrkund! - Kam me u dhanë shumë të holla, sa të doni! -i thash në çastin e mbramë para se me iu rrëfye përnjimend. Namani u zgjue. Nana u ngrit për me ia dhanë pantollonat e armuem. Më erdhi keq që ai u zgjue dhe na e këputi bisedën. Qe

rast i mirë me i kallxue për krejt çka kam mendue se kam me u ba kur të rritem. Ai e mbylli derën e dhomës. Ma mirë që u zgjue Namani e na e këputi kohën për me bisedue: nuk e dijsa ma çka kam me u ba kur të rritem dhe si kam me e prishë atë rreth vorfënie. A thue me të vërtetë nana më besoi për ate që i premtova?

BRENGA E FËMIJNISË

Drojta me hy mbrenda se e dijsa që ua prishi bisedën. Tek ne kishin ardhë për vizitë gratë e të afërmeve. Nuk hyna mbrenda në dhomë por as me u largue nuk u largova prej derës se s'mujsha mos me i ndëgjue çka thonë. Fjalët vijshin të plota, flitshin me za të naltë e pa asnji drojë. Nana tha: Mue m'kanë lindë të tanë fëmijë të bukur,

si margaritarë në pe. - Të mëdhejtë po, tamam ashtu mundesh me thanë... mirëpo... nuk asht si të tjerët. Mue më përfshinë gazi kur e shoh, si iriq! - tha njana prej nuseve. Dikush ia krisi gazit, të tjerat filluen me ba zhurmë dhe unë nuk e dallova ma zanin e nanës që të më mbronte. U largova me rrëmbim.

Me folë kah del shpirti, vetë kur shikohesha në pasqyre herë më pëlqente vetja e herë jo! Mirëpo me u shqetësue për këte nuk shqetësohesha kurrë. Ishte e pamundun me e largue nga mendja një dhembje të lehtë dhe një pikëllim i butë i imi ua prishi tanë mbasditen lojën të gjithë shokëve të mi. Në mbramje iu afrova dy herë pasqyres, mirëpo nuk

guxova me u pa... Në mbramje, kur ranë tjerët me fjetë, iu afrova nanës dhe i thash: Nanë, unë jam si të tjerët! Ajo më shikoi pak habitshëm, më tha: Ti ua kalon të tjerëve. Fjeta i qetë. Gjithmonë i kam besue nanës.

SËMUNDJA E NANËS

Ma në fund Baba i gjeti hua të hollat dhe vendosi me e dërgue Nanën në spital. Natën as une nuk flejta, para mëngjesit dola në kopsht. Atje i lava sytë me ujë të ftohtë, mirëpo nuk ishte e mundun me ua heqë të ajtunit. Për të mos e vërejtë Nana që kisha qajtë gjithë natën, nuk hyna në mëngjes te ajo për me e pyetë a i kanë pushue dhimbjet ndopak. Shkova në fund të oborrit dhe fillova të kërkoj diçka. Kurrqja nuk kërkojsa. Mendohe-sha me e bindë veten që kërkimi ishte i vërtetë dhe me arsyë. Baba i ngjiti lopët në qerre. Shtroi në qerre pak kashtë dhe mbi te një thes të konoptë. Mandej shkoi me e marrë Nanën sepse ajo nuk mund te ngritej në kambë. Atje mbetën një kohë të gjatë, mandej u ndëgjuen disa zane... U frigova mos kishte vdekë Nana mu tash që po e dërgojshim në spital. Shpesh kam ndëgjue se si të sëmundët dergjen

me muej në shtrat dhe nuk vdesin, e kur të gjithë e vendosin me i dërgue në spital, ata vdesin befasisht dhe kështu shkuemja në spital nuk asht e mundshme! Ma së shumti vdesin diku në rrugë, madje disa vende të tilla edhe i kam pa vetë mbasi që m'ia ka tregue Baba... I futa gishtat në vesh dhe i mbylla sa munda... E ndieva zanin e Babës që tha: - Eja ndihmom ta qesim në kerr!’, nuk kisha qenë i zoti me i mbyllë krejtësisht veshët e mos me ndie kurrqjë, s'kisha si mos me e ndie a ka vdekë Nana a jo! Prita me e pa kur ta qitshin te pragu, në hajat. Ata u vonuan prapë mbrenda, sigurisht tue i ndihmue me u veshë. Derisa e pritsha, mendova me vete se si nuk asht aspak mirë me e pa Nanën të sëmutë kur ta nxirrshin te pragu se mundem me i pasë sytë e ligë e padashtas me ia randue edhe ashtu shëndetin tepër të ligë! Nuk e shikova drejt në fytyrë po

u ula dhe e futa kokën disi nën krah dhe ashtu e pash: Nana ishte krejt e zbetë, e verdhë, me rrathë të murrme rreth syve dhe rreth buzëve. Shenjat e lisë së vjetër nëpër fytyrën e saj dukeshin si do insekte të neve-ritshme. Trupi i saj i gjatë dhe i drejtë ishte i kërrusun. Me të dy duert e shtrëngonte barkun. Menjherë e ktheva kokën në tjetrën anë, mandej fillova me u shti që po luejsa e nuk po e shihsha se si i ndërronte hapat me mundim, tue i gjakue buzët pa mujtë me i ndalë ofshamët. Në oborret e fqinjve dolën gratë dhe bile u afruan pranë gardhit të oborrit. Disa prej tyne e ngritën te sytë cepin e shamive: u dhimbej. Ma në fund e vendosën në qerre dhe ishin gati me u nisë. Trina ishte e hapun... E pash që ajo i hetoi të gjithë me sy, mandej e ndëgjova zanin e mbyllun e të pafuqishëm të saj që po më thërriste. Tri herë, katër. U lodh dhe ma nuk pati fuqi me

thirrë. Unë shtihesha sikur nuk e ndiejsha. Më dukej që nuk duhej me i dhanë shej Nanës që po mendojsa se doktori nuk ka me i ndihmue, për ma tepër ka me e mbytë me ato thikat e prehta! Shkuemjen e saj, mendojsa, duhet ta bajmë me u dukë e zakonshme, mos me ia përkujtue me asgja ndamje e përjetshme, sidomos jo me e ndie atë ndamje në shpirt! Ku humbe? Shpejt me e pa Nanën tande! - m'u ngërmue Baba. Ma nuk kisha si me u fshehë e me mbetë anash. U ngrita. Pa e ngritë kokën iu afrova Nanës dhe iu hodha në qafë. Ajo nuk më thoshte asgja, vetëm më mbante ashtu. Gjinin e kishte të ftohtë dhe e ndiejsha se faqet po më lageshin nga lotët. Por nuk e di a lotonte ajo apo vetëm unë qajsha me dihamë. Nëse e mban fryma deri te mjeku, Nana ka me u kthye! - mendova kur qerrja po dilte nga dyert.



Udhëtimi në kohë

NË KËRKIM TË MARSEL PRUSTIT



Është e habitshme sesi për disa dekada pas vdekjes së tij, Prusti nuk u vlerësua nga bashkëkohësit dhe kolegët e vet letrarë. E habitshme, sepse për të nuk thotë asnjë fjalë Bretoni, i cili e urrente, ose Aragoni, Malroja, madje as Sartri apo Kamyja

Luan RAMA

“Në kërkim të kohës së humbur!” - pëshpëriti titullin e veprës së Prustit mikesha ime. Ishim në “Shëtitorën Prust” buzë bregut të detit të Normandisë, para “Grand Hôtel” të qytezës turistike Cabourg, aty ku Prusti pëlqente gjithnjë të prehej gjatë verës, larg Parisit, dhe ku ende ruhet një dhomë që quhet “Chambre Marcel Proust”, (“Dhoma Marsel Prustit”). Pas pak, e lumturuar sikur të kishte gjetur diçka të vyer, ajo shtoi: “Vepra e tij më është dukur gjithnjë si një deziluzion i gjatë... Nesër në Paris do doja të më çoje në vendet ku ka jetuar Prusti, - m’u lut ajo. - Do të shkojmë, - qesha unë. Para se të iknim nga Cabourg, ajo bleu ca ëmbëlsira në një kuti me portretin e Prustit, që francezët i quajnë “Les Madeleines de Proust”, (Madalenat e Prustit), meqë, siç shkruhet në një nga romanet e tij, Prusti i pëlqente shumë ato. Gjatë viteve, disa herë isha gjendur në vendet mitike që lidheshin me Prustin dhe jetën e tij, në një kthinë të “Hôtel Ritz”, ku i pëlqente të rrinte shkrimtarit, në “Chez-Maxim’s”, pra në katedrales Madaleine, në Rue Bellechase tek Anatol Frans apo në bulevardin Haussmann. Tashmë më duhej të rikthehesha si një guidë, t’i tregoja mikes dhe njëkohësisht kushërirës time të ardhur nga Kanadaja, ato shtëpi ku ai ishte rritur, ku kishte dashuruar, ku kishte shkruar rreshtat e para dhe më pas ishte mbyllur si një lloj murgu; ato vende e sallone letrare ku atij i pëlqente të takonte miq të e tij kur shkonte të merrte çajin. Çuditërisht ajo e kishte lexuar gjithë veprën e Prustit dhe unë nuk e kuptoja se nga vinte ky zell për t’u dhënë kaq shumë mbas Prustit, meqë sot, për të rinjtë, është disi e vështirë një letërsi e tillë, me fraza e përshkrime të gjata dhe ku tregohet për sallone mondane,

personazhe aristokratike dhe kohëra të largëta të para një shekulli. Në fakt do të duhej pak durim në fillimin e romaneve të tij, sa të hysh në temë, që të mund pastaj të rrëmbehesh pas personazhesh interesantë e analizash që zbërthejnë botra njerëzore. Ky është universi i Prustit, që ndryshe nga afresket me mijëra personazhe të Komedisë Njerëzore të Balzakut, ai e ndërtoi afreskun e vet me pak personazhe dhe pa problemet sociale, pra ndryshe nga mjediset dhe personazhet që përshkruante Balzakun. Edhe mua më pëlqen Prusti. Ndodh nganjëherë që në udhëtimet e gjata, të marr një nga librat e tij dhe të humbas në të, në kujtesën e tij, pasi tërë letërsia e tij është kujtesë, rikthim në kujtesë, rikthim në copëza jete të përjetuara më parë e që ai ngazëllehej t’i rijetonte sërish. Madje, një kujtesë që jo rrallë zgjohej nga parfumet e aromat. Të duket disi e çuditshme, por kjo është e vërtetë. Dhe aromat risjellin kohëra, vende, personazhe. Kjo më ndodh dhe mua. Sa herë ndjej pranë aromën e borzilokut, ajo më kujton gjyshen time, ulur në një minder të thjeshtë buzë dritares, duke vështruar përtej bulevardit rrjedhën njerëzore dhe duke i marrë erë borzilokut në gishtërinjtë e hollë dhe të bukur të saj. E pra, romanet e Prustit, apo gjithë vepra e tij e përmbledhur në titullin A la recherche du temps perdu (Në kërkim të kohës së humbur), risjell aroma, personazhe, copëza dialogësh, apo dashuri të munguara.

Letërsi në kohën e shkuar

Letërsia e Prustit nuk është letërsi e “kohës së tashme”, pra e ngjarjeve që ndodhin dhe që ai i reflekton menjëherë, ashtu siç janë në dorëshkrimet dhe veprat e tij. Jo, gjithçka është e ngjizur në kohën e shkuar. Janë kujtime të largëta, por të fiksuara

qartë, në detaje, në dialogë që shfaqen papritur, duke sjellë copëza jete të një kohe të kaluar, janë ngjarje të salloneve letrare, shëtitjet në Champs Elysées dhe Bois de Boulogne, janë portretet e të dashurave të tij që adhuronte nga larg, është Albertina e tij e ëndërruar, është Jeanne Pouquet e fejuara e Gaston de Caillard, të cilën ai do ta mishëronte në personazhin e Gilberte Swann. Kur shkruante romanin Një dashuri e Suanit, ai shkonte sa në një hotel në tjetrin për të pyetur hotelxhinjtë rreth personazheve të dikurshëm, për të parë mjediset ku do të përshkruante jetën e tyre. Pyeste njerëzit, hotelxhinjtë, patronët e shtëpive publike, karrocierët, të njohurit e personazheve reale dhe bënte një punë të vërtetë detektivi për të rikthyer kohën ashtu siç kishte qenë.

Rruga Fontaine

Rue Fontaine në Auteil, atëherë ishte në periferi të Parisit, por tashmë pas një shekulli, Auteil është kthyer në një lagje parisienne. Qyteti është zgjeruar, duke e pështjellur atë brenda vetes. Rruga Fontaine është një rrugë e qetë. Një dritë e bardhë diellore binte mbi rrugën pa njerëz. Pikërisht këtu, në shtëpinë e gjyshit të tij, në numrin 96, më 10 korrik 1871 kishte lindur Marsel Prusti (Valentin Louis Georges Eugène Marcel Proust). Që i vogël ai kishte shëndet të dobët, çka do ta ndjekë gjithë jetën, edhe pse babai i tij ishte mjek dhe profesor i Fakultetit të Mjekësisë dhe nuk do ta ndihmonte dot. Madje, kur ishte 9 vjeç, në shëtitje me familjen në pyllin e Bulonjës (Bois de Boulogne), ai mbeti pa frymë dhe i ati mendoi se fëmija po vdiste. Por, një shkundje e fuqishme bëri që fryma t’i rivinte. Që atëherë, ai do të vuante gjithnjë nga astma. Në vitin 1874, familja e tij u vendos në qendër të Parisit, në Bulevardin

Malesherbes, nr. 9, jo larg Katedrales së Madalenës dhe Operas Garnier. Ajo shtëpi ishte shtëpia e kujtimeve: oborri, hyrja në fund të tij, salloni i madh ku mblidheshin miqtë e që vite më vonë ata do të gjenin vetveten në romanet e djaloshit Marsel. Atje ai njohu “Madame en Rose”; atje ai dëgjoji violinistin që ra në dashuri me “zotin Charlus”, i cili bënte elozhe për Sadom e Gomorra te zonja Verdurin. Pikërisht në këtë periudhë të rinisë së tij, ai filloi dhe eksperiencat e para seksuale: masturbimin, për çka tregon dhe në një letër dërguar në moshën 17 vjeçare gjyshit të tij, ku i kërkonte t’i dërgonte me urgjencë 13 franga: “Ja përse: unë kisha nevojë aq shumë për një femër, që të mund të ndaloja praktikën e keqe të masturbimit, saqë im atë më dha 10 franga që të shkoja në një bordello, por nga emocioni theva një vazo që kushtonte tre franga. Për më tepër, nga emocionet nuk arrita të mbaroja punë...” Në këtë kohë ai filloi të merrej dhe me botimet e para si Les Plaisirs et les jours (Kënaqësitë dhe ditët) dhe meqë nënën e kishte me origjinë çifute, në kohën e “Procesit Drejfus”, ai u bë një nga mbrojtësit më të flaktë të Drejfusit, madje me petition në dorë, ai shkonte në sallonet letrare që intelektualë në modë ta nënshkruanin në mbrojtje të kapitenit Drejfus, duke marrë kështu dhe firmën e Anatol Fransit.

Nëna

Prusti e adhuronte nënën e tij që në fëmijëri. Ai ishte e kundërta e Balzakut, që meqë kishte një nënë të ftohtë dhe autoritare, një ditë prej ditësh kishte thënë: “Unë nuk kam nënë!” Jeta e nënës së Prustit u lidh ngushtë me të birin, pasi ajo kujdesej në mënyrë të veçantë për Marselin e sëmurë. Vite me radhë Prusti do të jetonte me atë dëshirë të madhe

HEJZA

që ishte puthja e nënës së tij para se të flinte. Ajo e puthte gjithnjë dhe më vonë kjo puthje do t’i mungonte. Pas vdekjes së babait të tij, në vitin 1903, ata u vendosën në 45, rue de Courcelles dhe jetuan bashkë. Ajo e ndihmonte në korrigjimin e përkthimeve të tij dhe merrej me letrat dhe korrespondencën e të birit. Nëna e Prustit, Jeanne Wiel, vdiq në vitin 1905, pra dy vjet pas babait të tij. Në fakt ajo nuk e kishte duruar vdekjen e të shoqit edhepse nuk e bënte veten para dy djemve të saj. Kjo vdekje, Prustin e tronditi tmerrësisht. “Jeta ime tashmë e humbi qëllimin e jetës dhe ëmbëlsinë e saj”, - do të shkruante ai. Madje, vdekja e nënës së tij i sugjeroi edhe një ese mbi idenë se çdo fëmijë, në një farë mënyre, “vret” gradualisht prindërit e tij... sigurisht, nga dhimbja, shqetësimi, ndarja e paralajmëruar. Një ditë, shumë vjet pasi ajo kishte vdekur, kur ai dhe guvernantja e tij, Celeste, po kujtonin prindërit e tyre të vdekur, ai i kishte thënë: “Po ta dija se do ta gjeja nënën në botën tjetër, unë do të doja të vdisja që tani”. Një tjetër mbrëmje, ai i kishte thënë: “Kur ajo vdiq, ajo e mori me vete dhe Marselin”.

Të dashurat e Prustit

Cila vallë kishte qenë e dashura e Prustit, siç kishte qenë Drue për Hygonë, Hanska për Balzakun, Lu për Apolinerin, Gala për Elyar? Në kujtimet e guvernantes së tij Celeste, apo në personazhet e romaneve të tij, gjejmë disa syresh, por më së shumti janë vajza të adhuruara, të cilat i dashuronte dhe pak dihet se cila nga ato e ka dashur vërtet Marsel Prustin dhe sa ka zgjatur kjo dashuri. Disa ditë, disa muaj? Apo vite, në botën e tij imagjinare? Në kujtimet e saj, Celeste kujtonte se në sirtaret e tij, Prusti ruante shumë fotografi vajzash, që kishin qenë të preferuarat e tij, me leshrat e derdhura mbi supe, duke pozuar si princesha, por ato ishin idilike, vajza që i kishte piktakuar në sallonet letrare të Madame Madaleine le Maire, tek Madame Strauss, vejusha e kompozitorit Bizet apo në sallonin e zonjës Arman de Cavaillet në avenynë Hoche. Ai nuk fliste shumë për polaken De Banardaky, edhe pse thoshte se kishte qenë i dashuruar, kur kishte qenë 15 vjeçar. “Isha i çmendur pas saj”, - i kishte thënë një ditë ai Celestes. Megjithatë, ai i fliste asaj dhe për Louisa de Mornand, Laure Hayman, princeshën Souzot.

Prusti i pëlqente personazhet e dyzuar, ku burrat kishin diçka nga gratë dhe gratë diçka nga burrat. I tillë ishte dhe personazhi i Albertine-s në romanin e tij, Albertina e humbur, (Albertine disparue), një personazh, që dashuron narratorin apo rrëfyesin (që është vetë shkrimtari); që për hir të dashurisë për të pranon dhe burgun, që nxit xhelozinë e tij me prirjet e saj lezbienne, që më pas e braktis e më së fundi vdes nga rrëzimi i një kali, ashtu siç kishte vdekur duke u rrëzuar nga avioni dhe Agostinelli i bukur, i dashuri i tij, Albertine me fëmijërinë e saj të rikujton zonjushën De Banardaky, e vitet më pas, ky personazh ka ngjyrat e mikut të tij Albert Le Cuziat dhe më pas fatin e Agostinelli-it.

Dashuria për djemtë

Që në adoleshencë, e ëma e tij dyshonte për prirjet e tij homoseksuale. Dhe në fakt, Prusti i donte djemtë që në adoleshencën e rininë e tij. Ajo e vëzhgonte se me kë rrinte dhe ku shkonte. Kur u rrit ca, ajo e nxiste të linte shoqërinë e djemve dhe të shkonte me vajza që të merrej me to. Ai e adhuronte autorin anglez Ruskin, i cili në atë kohë ishte po aq i famshëm sa dhe filozofi gjerman Niçe, dhe në rininë e tij filloi të përkthente dy nga librat e njohur të këtij autori, Bibla e Amiens dhe Sésame et les lys. Ruskin ishte homoseksual, por puna me përkthimin i dha Prustit mundësi të futet në botën e refleksionit dhe të letërsisë. Një nga dashuritë e njohura të Prustit pas Alfred le Couzet, ishte ajo me Alfred Agostinelin, me origjinë italiane, nga Monaco, një djalosh simpatik, të cilin në fillim e angazhoi si shofer dhe pastaj si sekretar të tij. Madje, në ato kohë ai donte ta fshihte këtë fakt, sepse “nuk donte që të tjerët të shihnin në këtë lloj shoqërie diçka homoseksuale”, siç i shkruante ai



mikut të tij Albert Nahmias. “Njerëzit janë aq budallenj sa mund të shohin në këtë shoqëri diçka pederastike”.

Prusti e mori Agostinelin në shtëpi, në 102, boulevardi Haussmann. Ata qëndronin gjithnjë bashkë. Atje dhe flinte. Bashkë shkonin në kafenetë dhe restorantet dhe po bashkë bridhnin nëpër Francë apo shkonin në Normandi, veçanërisht në Cabourg. Ishte pikërisht ai që i shtypte tashmë dorëshkrimet e tij. Por, mjerisht, Alfredi shpejt u mërzit nga kjo lloj shoqërie dhe zuri një dashnore, çka ndolli xhelozinë e Prustit. Midis tij dhe Agostinelit tashmë ishte Anna, por gjendja sa vinte e rëndohej gjersa një ditë Alfredi u zhduk nga shtëpia dhe nuk u kthye më. Drama për Prustin ishte e madhe. Me miqtë e tij ai kërkoi të gjente gjurmët e Agostinelit dhe më së fundi ishte Nahmias që e njoftoi se ai kishte zbritur në jug të Francës, në Antibe, te prindërit e tij. Nahmias do të nisej me mision gjer atje për ta bindur Agostinelin që të kthehej tashmë si sekretar me një rrogë më të mirë. Madje më vonë, Prusti i bleu dhe një avion të vogël, të cilin ai e pagëzoi “Swann”, por që mjerisht një ditë prej ditësh, ai do të pësonte aksident me të dhe do të vdiste duke rënë në det. Ishte 30 maji i vitit 1914. Kjo ngjarje e dhimbshme do ta vriste shumë shpirtin e Prustit, në një kohë që ata të dy ishin pajtuar tashmë. Prindërit e Agostinelit i kërkuan para për të gjetur trupin e tij në det dhe pas një jave më së fundi, Agostinelin e kishin gjetur. Sigurisht, Prusti i ndihmoi shumë, por tashmë mikun e tij nuk do ta shkonte më. Biografë të tij tregojnë se ndonjëherë, gjatë luftës, Prusti humbte në shtëpi publike për meshkuj, të cilat i njihte mirë dhe madje i kishte ndihmuar me mobiljet e prindërve të tij. Ishte kurioz të zbulonte këtë botë të ndaluar, “puset e Sodomës”, siç thoshte ai. Për më tepër, pas lufte ai nisi të shkruante romanin e tij Sodome et Gomorrhe, që i bënte jehonë orgjive të kohës biblike.

Bulevardi Haussmann

Itinerari prustian është pasionant. Nga rue Fontaine në boulevardin Malesherbes, më vonë në Rue Courcelles e më pas në boulevardin Haussmann në vitin 1906. Duke ndjekur jetën dhe itineraret e shkrimtarit të madh të duket sikur përjeton jo vetëm jetën e tij, por dhe një copëz të historisë së vet Francës, “Epokën e Bukur”apo “La Belle Epoque”, siç quhej ajo periudhë e fillimit të shekullit XX. Shkrimtari nuk ka lëvizur shumë nëpër Paris. Kafenetë, hotelet dhe restorantet nuk janë të shumta, siç ishin ato për një Bodler apo Verlen. Në muzeun “Carnavalet” është “ruajtur” apo rikrijuar dhoma e Prustit, ndërsa që të vizitosh apartamentin e tij në Bulevardin Haussmann, ku sot janë zyrat e bankës së dikurshme, duhet të shkosh në një orar të

caktuar.

Me kushërirën time ne u gjetëm atë ditë nën dritaret e dikurshme të Prustit, të cilat ai i mbante gjithnjë mbyllur. Ajo vështronte pllakën e ngulitur në hyrjen e ndërtesës ku shkruhej se aty kishte banuar Prusti. Pikërisht nga ajo dhomë, nga ku përtej dritareve Prusti shihte rrjedhën njerëzore, pikërisht atje ishte ngjizur vepra monumentale e këtij shkrimtari, atje, në gjysmë-errësirë, ku përmes kujtimeve të fëmijërisë dhe të adoleshencës, autori ishte vënë në kërkim të “kohës së humbur”. Por, a kishte humbur vërtet ajo, përderisa ai na e la atë kohë të pikturuar në një afresk të madh? A e fiksoi ai kohën? Kohën e palëvizshme, siç e konceptonte ai, apo siç e cilësonte dhe filozofi Jean-François Revel, “piktor i palëvizshmërisë”? Koha... “Dihet, - thoshte Prusti, - që teorikisht toka rrotullohet, por në fakt ne nuk e ndjejmë atë, pasi edhe pse lëvizim mbi të, ne nuk e ndjejmë këtë lëvizje. Kështu ndodh në jetë dhe me Kohën...” Një ditë, duke lexuar përkthimin në shqip të Edmond Tupes Kur dashuronte Suani, ndalova në një pasazh të këndshëm që më bëri të reflektoj mbi njeriun dhe kohën. Ja ç’shkruante Prust për Suanin: “Në vend të shprehjeve abstrakte “koha kur isha i lumtur”, “koha kur më dashuronin” që i kishte shqiptuar deri atëherë pa vuajtur shumë, sepse zgjuarsia e tij kishte mbyllur atje, nga e kaluara, vetëm ca të ashtuquajtura copëza që s’kishin asgjë prej saj, ai gjeti sérish gjithçka, që, nga ajo lumturi e humbur, e kishte ngulitur përgjithmonë thelbin e saj të veçantë e avullues: çdo gjë i doli përsëri para syve, petalet borë të bardha e të përdredhura të lulevjeshtës që ajo i kishte hedhur në karrocë e që ai e kishte prekur me buzë - adresa me germa reliev e “Shtëpisë së praruar” në letrën ku ai kishte lexuar fjalinë: “Dora po më dridhet kaq shumë tek ju shkruaj” - vetullat e saj që ishin afruar kur ajo i kishte thënë me pamje të përgjëruar: “Nuk do të rrimi shumë kohë pa u bërë i gjallë?”...Në atë moment, ai po shuante një kërshtëri epshndjellëse, duke përjetuar kënaqësinë e njerëzve që jetojnë falë dashurisë...”

Dhoma e Prustit, e ruajtur me fanatizëm, mbart vërtet shenjën e kohës: jo vetëm mobiljet, parketi, dritaret, por dhe atë lloj arome që i përket një kohe të shkuar. Duke kujtuar dhomën e Prustit, që ishte njëkohësisht dhe kabineti i punës, miku i tij, shkrimtari Lucien Daudet, shkruante: “Pikërisht në Bulevardin Haussmann, ai filloi të jetojë si një bletë në kosheren e vet dhe ku fjala e zakonshme “të bësh mjalt”, pra “të krijosh një vepër”, i shkonte për shtat atij më shumë se kujtdo tjetër. Nga blea ai kishte syrin e ëmbël pa pikën e shndritshme, syrin me vështtrimin e thellë dhe të shumanshëm (ai vështronte nga të gjitha anët, jashtë dhe brenda); nga blea kishte vigjilencën, palodhshmërinë në të punuar pa e vënë këtë në dukje (asnjëherë

nuk e dëgjuam se e shqetësonim në punë); si blea ai shkonte të kërkonte polenin tek bimët e tjera të helmatisura (por blea ka antidotat e saj të fshehta); dhoma e tij, ajo e pesëmbëdhjetë vjetëve të fundit të jetës, me ngrohtësinë e shijes së tij, me gjysmë errësirën dhe aromën e dyllit të shkrirë, ajo dhomë e çrregullt për dikë, por e rregullt për sytë e bletës, ishte vërtetë një hoje ku sipas një kimie të panjohur, përpunohej ajo prodhimtari e shumëllojtë që kthehej në një lloj lëngu të kthjellët dhe ku shija e një peme apo e një luleje mbetej e gjallë...”

Duke rrëmuar mbi jetën e Prustit, diçka më kishte befasuar. Ajo qenie aq e sjellshme, delikate, e tërhequr, ajo qenie që jetonte aq shumë me një botë të largët, me një të kaluar nostalgjike dhe aroma të çuditshme, kishte arritur një ditë të bënte një duel. Të duket e pabesueshme,por është reale. Kjo gjë i kishte ndodhur me shkrimtarin Jean Lorrain për shkak të një artikulli fyes që ai kishte shkruar. - “A e mori vesh nëna juaj?” - e kishte pyetur një ditë shërbëtorja Celeste. - “Po! E shkreta nënë. Nuk donte të më linte të shkoja. Por isha unë ai që e kisha kërkuar këtë duel. Ne i qëlluam njëri-tjetrit me revole në pyllin e Meudon-it”.Lumturisht plumbat kishin fluturuar në ajër. Pas duelit, nga dhimbja, ai kishte qarë. Kishte mbetur gjallë. Ndryshe, Në kërkim të kohës së humbur nuk do të ishte shkruar...

Deri në moshën 38 vjeçare, as botuesit dhe as shkrimtarët e tjerë nuk e kuptonin Prustin. Ai ndjehej i vetmuar, por megjithatë kishte besim e kurajo. Kur romanin e tij Mbi Suanët e dorëzoi në Shtëpinë botuese franceze NRF (Nouvelle Revue Française), i nxitur nga André Gide, i cili nuk e donte Prustin, botuesi e refuzoi botimin e tij disa herë. Por kur Shtëpia botuese Grasset e botoi më 1913 dhe romani u prit me sukses, Gallimard nxitoi ta fitonte këtë shkrimtar premtes, të cilin padrejtësisht e kishte shpërfillur. Më së fundi rruga për Prustin ishte hapur dhe tashmë të shkruarit ishte kthyer si i vetmi pasion i tij. Por kur shkruante, në fletët e tij ai zakonisht vizatonte anash dhe personazhet e tij, siç e vë në dukje dhe shkrimtari Philippe Sollers (Filip Solers) në librin e tij Syri i Prustit. Në disa botime mbi Prustin isha habitur me këtë pasion të këtij shkrimtari-vizatues, ku në qindra “croquis” ai kishte vizatuar mjedise, skena e personazhe, siç ishin portretet e Gilberte-s, të zonjës De Villeparisis, zonjës Swann apo dukeshës de Guermantes, që siç shkruante anash fletores me stilografin e tij, ajo është “një zonjë bionde me hundë të madhe, me dy sy zhbirues blu, me një kravatë të fryrë mëndafshi në ngjyrë mavi...”. Ai vizatonte katedralen, të cilën pastaj e përshkruante, ashtu si dhe plot skena të tjera romani, si të ishte një regjisor filmi, i cili vizatonte skenat para se ato t’i xhironte.

Celeste

Shkrimtarët e mëdhenj kanë pasur gjithnjë një personazh të preferuar që kanë dashur gjithnjë ta kenë pranë tyre. Disa kishin gratë e tyre, të tjerë të dashura apo miq të vjetër, disa të tjerë, shërbyesit e tyre. I tillë ishte Prusti, i cili një pjesë të mirë të jetës së tij e lidhi me guvernanten Celeste, e cila do ta ndiqte gjer në vdekjen e tij. Celeste ishte nga Lozere dhe kishte qenë gruaja e një shoferi të rastit tek Prusti, i cili herë pas here e çonte në hotelet dhe restorantet parisiene. Në fillim, ai e angazhoi atë për të shpërndarë librat e tij nëpër Paris, te miqtë e tij. Atëherë, ai sapo kishte botuar Du coté de chez Swann, (Andej nga Suanët), dhe librat me një dedikim të veçantë i shpërndante përmes Celestes. Më pas, e tërhequr nga kjo grua e pafjalë, ai e ngarkoi të merrej me kuzhinën dhe me problemet e shtëpisë, gjer te përkujdesjet më të vogla për të. Për tetë vjet rresht, Celeste Albaret do të ishte dëshmitarja e vetme e botës së atij njeriu që jetonte vetëm për artin e të shkruarit. Ai bënte një jetë murgu dhe Celeste ishte “konfidentja” e tij, ajo që i njihte të gjitha fshehtësitë e shkrimtarit. “Në thellësi, - do të shkruajë në kujtimet e saj Celeste, - ne ishim si dy jetimë. Ai me prindërit e vdekur, ndërsa unë me burrin në luftë dhe po me prindër të vdekur. Ai më zgjonte

HEJZA

me zilen e tij, edhe nëse sapo kisha rënë të flija. Me nxitim, me flokët e lëshuara, shkoja drejt tij. - Ah, ja Xhakonda! - thoshte ai. - E shtrenjta Celeste. Ti s’ke pushuar, por meqë pate mirësinë të vish...”. Vite me radhë, pasi Prusti vdiq, atëherë kur të gjithë gazetarët dhe biografët u turrën drejt Celeste që të merrnin kujtimet dhe përshtypjet e saj, ajo nuk foli. Kishte dhimbje për Marselin e “gJORë”. Më së fundi, në moshën 82 vjeçare, ajo pranoi të flasë dhe që kujtimet e saj të botoheshin. Dhe kështu ajo solli të vërtetën “unike” midis shumë legjendave që ishin shkruar për shkrimtarin enigmatik që dilte vetëm mbrëmjeve të vona. Disa vite pasi Celeste kishte punuar në shtëpinë e Marselit, në 102, Bulevardi Haussman, një ditë Prusti i kishte thënë: “Atëherë Celeste, kur do ta fillosh ditarin tënd? - Ju bëni shaka Monsieur! - ia kishte kthyer ajo. - Jo, e kam seriozisht. Kush më njuh më mirë se sa ju? Pas vdekjes time, libri juaj do të shitet më shtrenjtë sesa veprat e mia”.

Ishte ajo që i bënte kafenë, ishte po ajo që kujdesej për ushqimin e tij, për ilaçet dhe sëmundjen e tij. Prusti e donte kafenë e freskët dhe gjithnjë me aromë. Ai ishte i vështirë në shijet e tij. Siç kujton në kujtimet e saj Celeste, Prusti hante pak, sa pickonte diçka në pjatën ku ajo i shërbente dhe gjërat shpesh i linte. I pëlqente qumështi dhe pinte një litër në ditë. Po kështu levreku apo barbunjët e Marsejës; nga frutat, rrushi dhe dardhat dhe në mbrëmje kishte qejf një akullore, ndërsa vonë, shumë vonë, një birrë të ftohtë që e merrte në hotel “Ritz”. Por, edhe pse nuk i deklaronte Celestes mirënjohjen e tij, ai e ndjente se njeriu më i afërt i tij, pas vdekjes së prindërve, ishte pikërisht ajo, ajo grua e vetmuar që përgjonte çdo dhimbje dhe shqetësim të tij, madje dhe frymëmarrjen e tij. Ndodhte që Prusti nuk lëvizte edhe dy ditë të tëra nga dhoma e tij, duke e mbajtur derën mbyllur. Por, ai e dinte se Celeste duhej të ishte atje, pas derës, diku pranë tij.

“Vallë është gjallë?” - pyeste veten ajo, duke pritur një shenjë të tij. Në fundin e jetës së tij, kur për kohë të tëra ai lëngonte në shtrat dhe në errësirën e dhomës, Celeste ishte kthyer si një sekretare e tij. Ajo i merrte letrat dhe i hapte, po kështu dhe librat që i dërgonin Prustit, gazetat, etj. Madje, vitet e fundit i lexonte ato para tij dhe jepte mendimet e saj. Ishte po ajo që kopjonte në “të pastër” faqet e korrigjuara të Prustit dhe korrigjimet e tij ishin të panumërta, frazat të gjata pambarim, aq sa, në romanin e fundit La Prisonière (E burgosura), në tridhjetë faqe të romanit (dorëshkrimit) nuk kishte asnjë shenjë pikësimi. Por, megjithatë nuk ishte e vështirë të lexohej: thjesht kjo kërkonte një mënyrë tjetër të lexuari, disi recitative.... Celeste ishte aq e zënë me Prustin, saqë tashmë detyrohej të mos shkonte më të dielave në meshën e kishës. Celeste ishte gjithçka për të. Prusti asnjëherë nuk mbante çelës me vete. Kurdo kur të vinte, dhe në orën 3 të mëngjesit, Celeste e priste syzgjuar. Ajo ia hapte derën dhe me një shikim Celeste e kuptonte nëse Zotëria, “Monsieur”, siç e thërriste ajo, ishte në formë apo jo, nëse mbrëmja që kishte kaluar i kishte pëlqyer apo ishte mërzitur nga personazhet që kishte takuar. Dhe kur ishte në qejf, atëherë ai fillonte t’i tregonte Celestes për histori të personazheve që kishte takuar. Dhe kjo zgjaste me orë. Celeste kujtonte gjithashtu se nga frika se mos ftohej, Prusti, i cili vishej me shumë triko e mbulohej me batanije, së fundi nuk lahej më. Ajo i sillte ujin e ngrohtë dhe me një leckë të lagur ai fërkohej.

Një herë ajo e kishte pyetur se përse nuk ishte martuar. - “Si mund të martohesha? - i ishte përgjigjur ai. - Do më duhej të bridhja pas gruas nëpër dyqane, të shkoja tek rrobaqepësit e andej-këndej. Jo, unë jam martuar me veprën time. Kjo është gjithçka për mua”. Gjatë javës, për ditë të tëra, bashkëbiseduesi i vetëm për të ishte Celeste. Madje gjëra që kishte ndërmend t’i shkruante apo që sapo i kishte shkruar, ai ia tregonte Celestes, duke pritur reagimin e parë, sikur testi i parë i tij me publikun të ishte Celeste. Pastaj ai e pyeste për jetën e saj, historinë e prindërve, fëmijërinë, e pyeste për detaje të holla dhe në fillim

ajo habitej se përse i interesonin atij ato vogëlsira që ishin diçka e kaluar dhe personale. Por në detajet e saj, Prusti gjente gjëra që zhvilloheshin në imagjinatën e tij. Prusti ishte një njeri tepër i ndjeshëm, dhe jo vetëm një mizantrop apo një “dandy mondan”, siç konsiderohej Oskar Wilde në Paris disa vite më parë. Ndoshta sëmundja dhe kjo jetë e mbyllur e kishte bërë të tillë. Një ditë, kujtonte Celeste, kur dikush erdhi në Bulevardin Haussmann për t’i thënë asaj se duhej të nisej në jug, sepse nëna e saj ishte shumë e sëmurë, Prusti kishte lexuar pusullën për të dhe pa menduar se do ta lëndonte, menjëherë i kishte thënë: “E mjera Celeste! Të ka vdekur nëna!”... – dhe ishte mbytur në lot, sikur të kishte vdekur nëna e tij. Pastaj menjëherë organizoi nisjen e saj sa më parë që të mund ta shihte për herë të fundit nënën e saj edhepse të vdekur.

Vitet e lavdisë

Vitet e Luftës së Parë Botërore ishin të rënda për Prustin. Ai nuk e donte luftën. Në stacionin e trenave në “Gare de l’Est”, ai kishte përcjellë të vëllain e tij mjek, që shkonte në spitalin e Verdunit heroik, ku ishte bërë kërdia dhe ku gjermanë e francezë do të vriteshin më shumë se 700 mijë ushtarë. Një ditë, të vëllain e kishin sjellë të plagosur në Paris. Por, një tmerr të vërtetë ai provoi kur dhe atë e kërkuan që të shkonte në front. E si mund të shkonte në front i sëmurë siç ishte, kur astma e mbërthente gjithnjë e më shpesh në grykë dhe e linte pa frymë. Ai paraqiti raport pas raporti, por në kohë betejash të mëdha, ku luhet me fatin e kombit, askush nuk pyeste për sëmundjet e tij. Fatmirësisht, një kolonel që kishte qejf letërsinë, kur ai i dhuroi librat e tij me një dedikim joshës, më së fundi u bë i dhimbshëm dhe Prusti i shpëtoi frontit. Shkrimtari mund të vazhdonte të shkruante dhe kur avionët gjermanë i shfaqeshin gjer në qiellin e Parisit.

Ai e dinte se shpejt do të largohej nga kjo botë, prandaj dhe i duhej të nxitonte që të mbaronte gjithë veprën e tij, ta korrigjonte dhe të mbaronte ato që s’kishte përfunduar ende. Pasi dorëzoi për shtyp Andej nga gurmantët, (Côté des Gurmantes), Shtëpia botuese Gallimard i propozoi të botonteA l’ombre de jeunnes filles en fleurs. Por, a do mundej ta korrigjonte dorëshkrimin e tij? Një lodhje e madhe fizike dhe nervore e kishte pushtuar. I mbyllur në dhomën e errët, me muret e mbuluar me një rrobë që të mos ndiheshin zhurmat e bulevardit nga jashtë, Prusti, që flinte gjatë ditës, natën ndizte qirinjtë e tij për të shkruar gjer në orët e vona. Tashmë nuk ishte më ai borgjezi që kishte para. Kohët ishin të vështira dhe duhej jetuar. Por, Prusti ishte mësuar me kafenetë luksoze si në “Hôtel Ritz”dhe të hante në restorantin “Laure”, në cep të Place de Madeleine, apo në “Chez Maxim’s”, në cep të sheshit të Concorde-s. “Jam rrënuar dhe kam humbur gjithçka, - i kishte thënë ai një gazetari suedez, që kishte pranuar ta intervistonte në shtëpinë e tij – Më duhet të shkruaj diçka për të jetuar”... Megjithatë, ai ishte i lumtur. Tashmë vepra e tij kishte bërë udhë. Të gjithë i lexonin esetë e tij mbi artin, librat. “Çmimi Gouncourt” në dhjetor të vitit 1919, për romanin e tij të sapobotuar Rrotull vajzave të njoma (A l’ombre des jeunes filles en fleurs), i kurorëzoi së fundi shpresat dhe punën e tij shumëvjeçare. Një vit më vonë ai u nderua me “Legjionin e Nderit” dhe po atë vit u botua Andej nga gurmantët.

Rruga Hamelin

Prusti nuk donte ta linte apartamentin e tij në Bulevardin Haussmann, me të cilin ishte mësuar, por pronarja, kushëriira e tij, në atë kohë lufte u detyrua t’ia shiste një banke. Tashmë ai duhej të largohej. Përpak kohë ai u vendos në një apartament provizor jo larg ndërtesës së vjetër, por shumë shpejt gjeti një apartament në afërsi të Trocadero-së. Ai mendonte se apartamenti i tij në katin e pestë të Rue Hamelin, midis Trocadero dhe Harkut të Triumfit do të ishte provizore dhe se më pas mund të vendosej në një apartament më të qetë. Prusti nxitonte për

të përfunduar korrigjimet e botimeve të reja dhe përfundimisht të gjithë korpusit letrar të veprës së tij Në kërkim të kohës së humbur. Shtëpia botuese Gallimard priste çdo ditë dorëshkrimin e tij. Një nga fotografitë e pakta të Prustit, e fundit në të gjallë të tij, është dhe ajo kur në maj të vitit 1921, ai shkoi për të parë ekspozitën e mjeshtërve të mëdhenj flamandë e mbi të gjitha Pamje nga Delf të piktorit hollandez Wermer, në muzeun “Jeu de Paume”, në cep të sheshit të Concorde-s. Prusti i donte shumë flamandët, veçanërisht Memling, Weyden, Rubens dhe Rembrandt. Ishte fotografia e tij e fundit, me flokë të shkurtëra, mustaqet e përhershme, kapelen në dorë dhe me shkopin e tij të zakonshëm. Ishte veçse 50 vjeçar. Një javë më parë, ai ishte takuar në Ritz për herë të parë me Xhejms Xhoisin (Joyce), i cili rrethohej atë ditë nga Stravinsky, Diagilev dhe Picasso. Në pranverë të vitit 1922, një mbrëmje të vonët, së fundi ai shkroi fjalën fund. Ishte hera e parë që kishte shkruar në fund të dorëshkrimeve të tij këtë fjalë, “Fin”. E megjithatë një nga veprat e tij, Jean Seteuil, me historinë e një djaloshi që iu kushtua letërsisë, kishte mbetur e pa përfunduar.

Ai tashmë ishte bërë mjaft i njohur. Për të flitej në New York, në Romë, Madrid... Rreth tij ishte grumbulluar një gjeneratë e re shkrimtarësh, si François Mauriac, Paul Morand, Jean Giraudoux, Jean Cocteau... E dinte se shumë shpejt do të vdiste. Një mbrëmje, ai i tha Celestes se “tani mund të vdiste”. “Akoma e dëgjoj zërin e tij që mbarte shpërthimin e një gëzimi të madh”, - do të kujtonte më vonë Celeste. – Atëherë nuk dilte më nga shtëpia. Kohët e fundit ai ishte abonuar në “theatrephone”, një lidhje telefonike ku transmetoheshin koncertet muzikoredhe operat drejtpërdrejt nga teatrot. Vetëm kjo gjë e përhumhte në magjinë e muzikës. E pëlqente shumë dhe mbi të gjithë Debussy.”

Një grua në të zeza...

Në nëntor të atij viti gjendja e tij u përkeqësua shumë nga bronkiti. Herë pas here i jepnin oksigjen se nuk mbushej me frymë. E megjithatë, e vetmja gjë që kërkonte ishte një birrë e ftohtë nga Hôtel Ritz. Shoferi nisej me të shpejtë dhe e sillte birrën edhe po të ishte ora 2 e mëngjesit. Ditë e natë Celeste përgjonte zotërinë e saj me frikë në zemër. Për ta ngrohur, i jepte qumësht të ngrohtë. Meqë e folura e lodhte së tepërmi, tani ai komunikonte me të me pusulla, ku jepte porositë e tij. Kur ishte mirë, merrte dorëshkrimin e romanit Albertine disparue për të parë korrigjimet e bëra. Një ditë ai i kishte thënë: “Dua që duart e tua të më mbyllin qepallat”. Madje disa ditë para se të vdiste, ai i ishte lutur t’u dërgonte lule miqve të tij, të cilët kishin shkruar disa artikuj për veprën e tij kohët e fundit. Ishte njëlloj përshëndetje e tij. Celesten e kishte porositur të shkonte të takonte dhe abatin Mugnier, të cilin ai e njihte dhe t’i fliste atij për vdekjen e afërt dhe përshtirtjen që donte t’i bënte. Më 17 nëntor, ai i bëri shenjë Celeste-s, e cila iu afrua dhe dëgjo i zërin e dobët të tij që i thoshte: “Nëse e hedh dhe këtë natë, kjo do të thotë se jam më i fortë se sa mjekët. Por, duhet t’ia dal mbanë. Si thua ti, a do t’ia arrij?”... Në datën 18 nëntor, pasi kërkoi të pinte një kafe dhe mbeti një çast vetëm, ai i bëri përsëri shenjë Celeste-s t’ia frohej: “Në dhomë është një grua e shëndoshë, - i pëshpëriti ai me sytë e shqyer... - Një grua e tmerrshme në të zeza”. Ishte në delir. Pasi i dhanë përsëri oksigjen, Celeste, që nuk linte askënd të hynte në dhomë, madje as mjekët, të cilët Prusti i kishte refuzuar, thirri Robertin, të vëllain e tij. Ishin momentet e fundit. “Prusti nuk po na i shqiste sytë. Ishte diçka e tmerrshme. Pas pak Roberti iu afrua dhe i mbylli qepallat, ndërkohëqë ai ende vështronte nga ne.

- Ka vdekur? - e pyeta.

- Po Celeste. Ai ka mbaruar!...

Ishte ora gjashtë e pasdites. Të nesërmen, gazeta Le Figaro do të njoftonte vdekjen e shkrimtarit të madh Marsel Prust, edhepse dy të tretat e veprës së tij, të kësaj katedrale gjigande, siç do ta krahasonin kritikët, ende nuk ishte botuar. Fotografi

Man Ray që erdhi me të shpejtë, fiksoi fotografinë e tij post-mortum. Ishte portreti i qetë i shkrimtarit me mjekrën e zezë që i mbulonte pjesën më të madhe të fytyrës.

Një ditë më vonë, trupi i tij u preh në varrezat e Père Lachaise. Gjatë dy ditëve me kushërirën time, ne brodhëm nëpër rrugët e Parisit në kërkim të Marcel Prustit. Sigurisht, që dikush ta bëjë këtë “udhëtim” në vendet e përjetuara të Prustit, duhet të ketë lexuar diçka nga vepra e tij, në mënyrë që të ngjizë në një autorin dhe veprën, dhimbjet dhe dehjet e tij, dashuritë e tij të munguara, adhurimin për nënën dhe guvernanten besnike, personazhe të një kohe që u bënë heronjtë e romaneve të tij. Është e habitshme sesi për disa dekada pas vdekjes së tij, Prusti nuk u vlerësua nga bashkëkohësit dhe kolegët e vet letrarë. E habitshme, sepse për të nuk thotë asnjë fjalë Bretoni, i cili e urrente, ose Aragoni, Malroja, madje as Sartri apo Kamyja. Vonë, duke filluar me Bartsin, siç kujton dhe shkrimtari Filip Solers, vepra e Prustit filloi të marrë vlerën e vet të vërtetë. Në një anketë të botuar me rastin e 100 vjetorit të lindjes së tij, në disa nga organet e shtypit letrar evropian, si revista Lire, gazetat El Pais, The Times, Die Zeit, apo La Stampa, krijimtaria e Prustit preferohej pas Shekspirit, Gëtes, Servantesit, Dantes dhe Kafkës, duke lënë mbrapa shumë autorë të njohur dhe nobelistë. Madje, si francez, ai ishte vendosur para Molierit, Volterit, Balzakut, etj.

Aimez-vous Proust?

Një ditë, aktorin dhe regjisorin Eric Chartier-in e takova në takimin poetik në Entrepot të Montparnasit. Ishte një pianist fjalësh, pasi që kur e kuptoi thellë veprën e Prustit dhe botën e tij, ai nuk iu nda veprës së shkrimtarit dhe me të udhëtoi nëpër skenat e botës, fillimthi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe pastaj në Francë e gjetkë në Europë. Dhe nuk u nda më nga ai. Jetonte dhe ishte me të, dubluar në morinë dhe magjinë e fjalëve prustiane. Si të thuash, atë mbrëmje spektakli ai ishte Prusti mbi tastiera, me intonacione të habitshme që të rrëmbenin dhe të çonin diku gjetkë. Ah, ç’vështirësi të luaje mbi atë pentagram të vështirë e të pambarimtë. Kush tha se Prusti shkruante gjatë dhe ishte vështirë të ndiqte udhëtimin e lodhshëm të tij? Eric Chartier na e dëshmoi dhe demonstroi këtë me artin e tij, edhe pse skena e asaj nate nuk ishte një skenë e mirëfilltë teatri, nuk kishte dekorin e tij dhe kostumi i tij ishte ai i përditshëm dhe jo ai i skenës. Por ç’rëndësi kishin këto. Prusti ishte brenda tij në ato intonacione që shoqëronin imazhe që vetë Prusti i kish imagjinuar, përjetuar, shkruar. Por, ai i kishte harruar gjithë këto detaje, duke kujtuar se ishte në një skenë të vërtetë dhe se ishte një mesazher i vetë Prustit, madje Prusti vetë, ballë nesh, një grupi letrarësh e artistësh, ku për çudi ne pamë vërtetë hijen e Prustit dhe atë katedrale gjigande për të cilën shkruante që para tij Rimbaud, i cili e kishte treguar thjesht me një varg, “katedrale në qiell”. Kështu fjala nderej në lartësinë e asaj kubeje imagjinare ku Eric na fliste për vitrazhe dhe engjëj, për pelegrinë dhe besimtarë që kërkonin të pikëtakonin dikë nga Hyjnia apo vetë Hyjninë. Eric me zërin e tij luante piano, ishte kthyer në një Prust muzikal. Ishte fryma e tij që e drejtonte në peizazhin e fjalëve edhe pse ati i tij, Marcel Proust kishte gati një shekull që kishte vdekur.

- Aimez- vous Proust? (A ju pëlqen Prusti?)

– më tha Eric kur u ul pranë meje.

- Padyshim... kam shkruar për të, - iu përgjigja, - por tani dëgjova dhe muzikën e tij... nga “moderato cantabile” në “bemolet” dhe “vibracionet” e tij që ende s’më janë shuar...

Unë ngrita sytë dhe shikoja ende kubenë e asaj katedrale imagjinare ku në mes, në vend të shenjtit, pashë fytyrën e zbehtë të Prustit, me mjekrën e tij të zezë, ashtu të ngrirë në shtratin e tij të vdekjes, ashtu siç e kishte fotografuar fotografi amerikan, i madhi Man Ray!

Qasje

STRUKTURALIZMI

Strukturalizmi prandaj është një teori e shenjave (semiologji, semiotikë) që studion shenjat gjuhësore si shenja në bashkëveprim me kuptimin e tyre (semantikë)



Arne MELBERG

Strukturalizmi ka qenë një komponent i rëndësishëm i teorisë moderne letrare për një kohë të gjatë dhe në shumë mënyra. Një linjë e strukturalizmit letrar shkon nga formalizmi rus nëpërmjet Shkollës Çeke të Pragës deri te semiotika ruse, e përfaqësuar në vitet 1960 nga Yuri Lotman. Një linjë tjetër mund të nxirret nga teoritë e Saussure-it mbi gjuhën në fillim të shekullit të XX-të; ajo shkon deri te semantika dhe semiotika strukturore franceze dhe italiane e viteve 1960. Këtu duhet përmendur emra të tillë si Roland Barthes, Gérard Genette, Michel Foucault, A.J. Greimas, Tzvetan Todorov, Julia Kristeva dhe Umberto Eco.

Lista sugjeron që strukturalizmi nuk është aspak një aktivitet letrar i kufizuar, por më tepër një teori e përgjithshme e gjuhës dhe kulturës. Si teori dhe metodë letrare, ai duhet të rrjedhë nga ky kontekst më i gjerë. Në anën tjetër, vështirë se mund të imagjinohet ndonjë teori dhe metodologji letrare moderne pa të paktën elementë strukturalistë. Një filozof hermeneutik si Paul Ricoeur-i ka zhvilluar një teori të përgjithshme të interpretimit, e cila është pothuajse antistrukturaliste në tendencën e saj; ai këmbëngul po aq shumë në një metodologji strukturaliste si një komponent të domosdoshëm të procesit interpretues.

Një burim i rëndësishëm i strukturalizmit në të gjitha format e tij është gjuhësia, veçanërisht ashtu siç u zhvillua nga zvicerani Ferdinand de Saussure në fillim të shekullit XX. Ideja themelore në këtë kontekst është se Saussure e sheh gjuhën si një “sistem” të ndërtuar nga shenjat dhe lidhjet, ngjashmëritë dhe dallimet midis shenjave. Sistemi (la langue) është parakushti për gjuhën e gjallë (la parole). Kuptimi dhe rëndësia e sistemit janë të pavarura nga njeriu në atë mënyrë që fjalët tona janë vetëm zbatime të mundësive që përmban sistemi. Kuptimet e sistemit gjuhësor nuk varen nga ndonjë lidhje e drejtpërdrejtë midis shenjës gjuhësore dhe realitetit të cilit i referohet shenja. Përkundrazi, lidhja është e përkohshme, arbitrare dhe kuptimi i fjalëve lind kur ato vendosen në lidhje me njëra-tjetrën. Me këto pikëpamje, Saussure e çlirroi shkencën e gjuhës si nga historia e gjuhës, ashtu edhe nga

sociologjia dhe psikologjia, për ta bërë atë një semiologji: një studim i shenjave gjuhësore në lidhjet e tyre me njëra-tjetrën. Strukturalizmi prandaj është një teori e shenjave (semiologji, semiotikë) që studion shenjat gjuhësore si shenja në bashkëveprim me kuptimin e tyre (semantikë).

Sistemi gjuhësor i Saussure-it i qaset një përkufizimi të konceptit strukturë: një tërësi autonome në të cilën secili përbërës varet nga secili përbërës tjetër. Është e lehtë të imagjinohet se si një përcaktim i tillë i “strukturës” mund të koordinohet me një koncept modern të veprës letrare si një entitet autonom, në të cilin çdo element mbart një kuptim, i cili fiton kuptimin e tij të plotë vetëm në tërësinë e tij. Por, është gjithashtu e lehtë të imagjinohet vepra letrare si një element në struktura më të mëdha, për shembull, të një natyre sociale, historike ose psikologjike. Sidoqoftë, një numër teorish strukturaliste janë zhvilluar në këto fusha dhe në disa prej këtyre teorive letërsia luan një funksion të rëndësishëm. Disa shembuj të semiotikës së orientuar psikologjikisht gjenden te zvicerani Jean Piaget dhe francezi Jacques Lacan. Piageti zhvilloi një psikologji zhvillimore në të cilën çdo fazë e zhvillimit mund të lexohet si një strukturë e integruar. Psikoanalisti Lacan e konceptoi “të pavetëdijshmen” si një sistem gjuhësor të rregulluar dhe jo si një kaos impulsesh. Në veçanti teoria e tij e zhvillimit të fëmijës në fazën “simbolike”, e cila është faza e përcaktuar nga gjuha, ka pasur rëndësi të madhe për strukturalizmin letrar. Një shembull i kësaj është përpjekja e Julia Kristevas për të përcaktuar gjuhën poetike në një bashkëveprim midis niveleve «semiotike» dhe «simbolike».

Një shembull i semiotikës kulturore gjendet në traditën marksiste të francezëve Lucien Goldmann dhe Louis Althusser; semiotika antropologjike gjendet te francezi Claude Lévi-Strauss, ndërsa semiotika intelektuale dhe kulturo-historike gjenden te francezi Michel Foucault dhe italianii Umberto Eco. Goldmann-i konceptoi një “homologji” strukturore – një ngjashmëri strukturore - midis veprës letrare, sistemit letrar dhe epokës socio-historike dhe në këtë mënyrë krijoi mjete për të përshkruar ndërveprimin midis letërsisë dhe shoqërisë. Althusser-i e konceptoi

letërsinë si pjesë të prodhimit ideologjik, si një institucion shoqëror në shoqëri të pajisur me një “autonomi relative”; në këtë mënyrë ai krijoi mundësi për një lloj tensioni strukturore midis niveleve të përcaktuara shoqërisht, tenseione që sistemet që mendojnë ndryshe i shmangin. Lévi-Strauss-i i lexoi mitet “primitive” si sisteme gjuhësore koherente, kurse Foucault-i zhvilloi të menduarit institucional për të përfshirë epokat historike dhe natyrën e tyre specifike, në mënyrë që çdo epokë të mund të lexohej si një “sistem” ose një “strukturë”. Institucionet që ai studioi - çmendurinë, ndëshkimin, dashurinë - ishin si shenja në gjuhët tipike të kohës, dhe letërsia natyrisht kontribuonte gjithashtu në këto gjuhë. Eco zhvilloi një semiotikë kulturore dhe tregoi një interes të veçantë për fenomenet që përndryshe anashkaloheshin lehtë, që nga bibliotekat e manastireve deri te letërsia e kioskave. Në teoritë që rendita tani, letërsia shpesh zë një vend të rëndësishëm, megjithëse jo si qëllim në vetvete; ajo është pjesë e një konteksti më të gjerë ose përdoret për të dokumentuar ose provuar diçka përtej vetes. Rëndësi më të madhe letrare, ndërkaq, kanë teoritë që përpiqen ta shohin veprën letrare si një strukturë më vete. Edhe teoritë e tilla mund të burojnë nga gjuhësia: në teorinë letrare, mund të ndiqet një vijë nga formalizmi rus në vitet 1910 përmes Mukašovsky-it dhe Tynjanov-it të Shkollës së Pragës në vitet 1930 dhe 1940 deri në një lloj kulminacioni teorik me strukturalizmin francez në vitet 1960.

Ishte Roman Jakobsoni i cili para së gjithash bëri lidhmërinë e gjuhësisë dhe formalizmit në një strukturalizëm letrar. Krijimtaria e tij kolosale gjatë 50 viteve përfshinte, ndër të tjera, fonetikën, metrikën dhe semiotikën, Ai gjithmonë ruajti një interes jashtëzakonisht të gjallë për çështjen madhore të letërsisë, domethënë se çfarë është letërsia, dhe punoi drejt dhënies së përgjigjeve gjithnjë e më të avancuara. Në vështrimin e famshëm “Gjuhësia dhe poetika” të vitit 1960, ai përcaktoi një vend përfundimtar dhe strategjik për letërsinë në një sistem kompleks brenda të gjitha llojeve të komunikimit gjuhësor. Pikënisja e tij është funksioni poetik, por pavarësisht kësaj pikenisjeje, duhet thënë se ai i mbetet besnik pikënisjes tij të fillimit

të vitit 1910, domethënë “formalizmit”. Kontributet e tij janë parakushte për poetikën strukturore, që u zhvillua nga ruso-estonianii Yuri Lotman në vitet 1960 dhe 1970. Lotman-i e përcakton letërsinë si një “sistem formues modelesh dytësore”. Në këtë mënyrë, ai përpigjet - njësoj si bashkëkohësi i tij Althusser-i në Francë - t'i japë asaj një “autonomi relative”, e cila merr parasysh natyrën specifike të sistemit ose strukturës, si dhe varësinë dhe ndikimin e saj në sistemin më të madh, domethënë shoqërinë.

Traditat ruse dhe çeke ishin veçanërisht të vëmendshme ndaj vendit të devijuar të poezisë në gjuhë; strukturalizmi francez, i cili kulmoi në vitet 1960, ishte veçanërisht i interesuar në rrëfimin dhe të rrëfyerit. Roland Barthes-i, i cili më vonë zhvilloi një lloj post-strukturalizmi, shkroi një vepër strikte strukturaliste “Hyrje në analizën strukturore të teksteve narrative” (Barthes 1974). Bazuar në katalogimin e formalistit rus V. Propp të tregimeve aventureske popullore në vitet 1920, gjuhëtari A.J. Greimas-i zhvilloi një model për analizën e tekstit narrativ dhe në këtë mënyrë e bëri strukturalizmin një metodë të zbatueshme (Greimas 1966). Për një periudhë, ky model pati ndikim edhe në studimet letrare nordike. Në një formë të zhvilluar, ai përsëritet në sistemin e danezitet Peter Brask për të përshkruar rrëfimet në Tekst og tolkning (Brask 1974). Tzvetan Todorov shkroi “Një poetikë e prozës” dhe “Gramatikën e Dekameronit” (1969) me qëllimin e qartë për ta sistemuar vetë “gramatikën” e rrëfimit. Dhe Gérard Genette nisi “narratologjinë”, domethënë përpjekjen për të përcaktuar “logjikën” e rrëfimit në një model përshkruar. Pati një seri mbresëlënëse përpjekjesh për të gjetur strukturën e rrëfimit, dhe ato rezultuan të paktën në një zhvillim metodologjik të studimeve letrare. Dikush mund të thotë se ky zhvillim erdhi në kurriz të subjektit - Roland Barthes-i argumentoi për “vdekjen e autorit” dhe “narratologjia” e Genette-it hoqi të gjithë psikologjinë nga analiza letrare. Por në të njëjtën kohë, tendenca objektivizuese e strukturalizmit ishte shumë e rëndësishme për shndërrimin studimeve letrare në një shkencë.

Nga suedishtja: Qerim RAQI

Trashëgimi kulturore

AZIZE EMINI, KUJDESTARJA E TRADITËS SË MEDVEGJËS

E nisi rrugëtimin e saj që në moshën 19-vjeçare, kur për herë të parë mori në duar gjilpërën, perin dhe copat e qëndisura me motive të lashta



Lumturije LIMANI

Në Medvegjë, mes maleve dhe rrëfenjave të së kaluarës, jeton Azize Emini, një grua e moshuar me një histori të jashtëzakonshme përkushtimi dhe dashurie ndaj kulturës dhe traditës shqiptare. Prej më shumë se gjashtë dekadash, Azizeja i ka përkushtuar jetën e saj ruajtjes dhe promovimit të veshjeve tradicionale të Medvegjës – një pasuri e rrallë që rrezikon të harrohet në kohët

moderne.

E nisi rrugëtimin e saj që në moshën 19-vjeçare, kur për herë të parë mori në duar gjilpërën, perin dhe copat e qëndisura me motive të lashta. Që atëherë, ajo nuk e ka ndalur asnjëherë punën e saj me dorë, duke punuar me kujdes dhe pasion çdo detaj të veshjeve popullore. Kostumet që ajo krijon nuk janë thjesht rroba – ato janë dëshmi të historisë, krenarisë dhe shpirtit të Medvegjës shqiptare.

Puna e zonjës Azize nuk është vetëm



artizanale; ajo është edhe një akt rezistence kulturore. Në një kohë kur shumë elementë të kulturës shqiptare janë përballur me rrezikun e zhdukjes, Azizeja ka qenë një nga mbrojtëset më të përkushtuara të identitetit lokal. Ajo ka ditur të ruajë me përpikëri motivet e lashta, teknikat e qepjes dhe qëndisjes, si dhe përdorimin e ngjyrave e simboleve që flasin për jetën, zakonet dhe botëkuptimin

e komunitetit shqiptar të Medvegjës. Përmes veprës së saj, ajo ka frymëzuar edhe brezat e rinj, duke ndarë me ta njohuritë dhe dashurinë për këtë trashëgimi. Azize Emini nuk është vetëm një mjeshtrë e veshjeve tradicionale – ajo është një arkiv e gjallë e kulturës sonë, një nënë shpirtërore e artit popullor dhe një zë i qetë, por i fuqishëm, që na kujton se rrënjët nuk duhen harruar.

NUMRI I ARDHSHEM ME 15 SHTATOR

HEJZA

31 Gusht, 2025

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:
Drian Shala - Shalë

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000